

ZËRAT E NDRYSHIMIT: RRUGËTIMI I SHOQËRISË CIVILE NË ZHVILLIMIN DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË



1990 - 2022





© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat të rezervuara.
Tiranë, Shqipëri, 2023.

Kontakt:

www.partnersalbania.org

partners@partnersalbania.org



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Ky publikim u përgatit nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht opinionet e Ambasadës dhe Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

P ë r m b a j t j a

- 05 SHKURTIME
- 06 PARATHËNIE
- 08 MIRENJOHJE
- 11 HYRJE

13 I. SHOQËRIA CIVILE PËR DEMOKRACI DHE MIRËQEVERISJE

14 *1.1 Shteti i së drejtës dhe të drejtat e njeriut*

- 14 Kontributi i shoqërisë civile në mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- 17 Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe politikave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve
- 19 Promovimi i drejtësisë miqësore për fëmijët në kontakt dhe në konflikt me ligjin
- 21 Ligji për pakicat kombëtare
- 22 Kontributi i OShC-ve për hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të fushës së aftësisë së kufizuar
- 26 Kundërshtimi i "Paketës Anti-shpifje"
- 28 Ripërdorimi social i pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar
- 30 Kontributi i shoqërisë civile për hartimin dhe miratimin e ligjit për konsultimin publik

32 *1.2 Zgjedhjet e lira e të ndershme, lufta kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës*

- 32 Kontributi i shoqërisë civile në proceset zgjedhore
- 35 Ulja e korrupsionit dhe rritja e transparencës në sektorin privat – Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) të Biznesit
- 36 Nisma për vlerësimin e hapësirave për korrupsion në Legjislacionin Shqiptar
- 38 Reduktimi i korrupsionit përmes ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

40 *1.3 Pjesëmarrja në politikëbërje dhe procese vendimmarrëse*

- 40 Për një shoqëri civile më të zhvilluar, më aktive dhe të qendrueshme
- 43 Pjesëmarrja e qytetarëve dhe grupeve të interesit në reformën administrative-territoriale të vendit

- 45 Ndërtimi i kapaciteteve institucionale për angazhim dhe konsultim publik
- 46 Platforma multi-funksionale në mbështetje të demokracisë në nivel vendor
- 48 Kontributi i shoqërisë civile për demokracinë digjitale
- 49 Demokracia si procedurë: Peticionet

53 II. OFRIMI I SHËRBIMEVE PËR GRUPET NË NEVOJË DHE SHOQËRINË

- 54 Mbrojtja dhe ri-integrimi i viktimave të trafikimit
- 56 Ngritja dhe funksionimi i qendrave për mbrojtjen e fëmijëve
- 58 Reduktimi i dëmit tek përdoruesit e drogës dhe parandalimi i HIV/SIDA-s dhe SST-ve
- 60 Shërbime sociale të integruara për familjen
- 62 Shërbime cilësore dhe të arritshme për çdo person me aftësi të kufizuar dhe prindërit e tyre
- 71 Shërbime rezidenciale në ndihmë komunitetit LGBTI+
- 72 Zhvillimi i Vullnetarizmit në Shqipëri

77 III. KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILE PËR BARAZINË GJINORE

- 78 Të drejtat riprodhuese të vajzave dhe grave dhe ligji "Për ndërprerjen e shtatëzanisë"
- 79 Kontributi i organizatave të shoqërisë civile për Kodin e Familjes
- 81 Përmirësimi i kuadrit ligjor për dhunën në marrëdhënie familjare
- 83 Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje
- 85 Ofrimi i shërbimeve në ndihmë të grave e vajzave të mbijetuara nga dhuna

89 IV. MBROJTJA E MJEDISIT

- 90 Mushkëri të Gjelbra për Qytetet tona
- 91 Kontributi i shoqërisë civile në menaxhimin e mbetjeve
- 93 Nxitja e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore
- 96 Mbrojtja e faunës së egër dhe zonave me rëndësi natyrore
- 99 Mbrojtja e Lugjinës së Lumit Vjosa - Vjosa Park Kombëtar

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AOS	Shoqata Ornitologjike Shqiptare
BE	Bashkimi Evropian
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
FShDPAK	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
IDRA	Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
KVV	Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
NJMF	Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
PPNEA	Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri
PSh	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
QKL	Qendra Kombëtare e Licensimit të Biznesit
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit
REC	Shqipëri Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri
TAR	Reforma Administrative Territoriale
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin



Juliana Hoxha

Drejtore

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Parathënie

Jam shumë e nderuar të prezantoj këtë publikim mjaft të rëndësishëm të Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Partnerët Shqipëri), që ofron një panoramë të gjerë të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri nga viti 1990 deri në 2022. Ky publikim është një dëshmi e rrugëtimit transformues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në peizazhin post-komunist të Shqipërisë, duke theksuar rolin e tyre të rëndësishëm në nxitjen e pjesëmarrjes demokratike, advokimin për të drejtat e njeriut, luftën kundër korrupsionit, si dhe në adresimin e nevojave të ndryshme sociale. Me kalimin e Shqipërisë nga komunizmi në periudhën e tranzicionit, shoqëria civile shfaqet si një gur themeli në ngritjen dhe zhvillimin e institucioneve dhe proceseve demokratike. Publikimi përshkruan rolin dhe ndikimin e OSHC-ve në zhvillimin e legjisllacionit, politikave publike dhe reformave institucionale. Ai paraqet esencën e përpjekjeve të këtyre organizatave në promovimin e barazisë gjinore, mbrojtjen e mjedisit, dhe sigurimin e shërbimeve për grupet e marginalizuara, duke reflektuar kështu spektrin e ndryshëm të kontributeve të tyre.

Megjithatë, dokumenti gjithashtu njihet sfidat me të cilat përballlet sektori i shoqërisë civile në Shqipëri duke ofruar një pikëpamje të balancuar, mbi pengesat dhe kufizimet që kanë penguar efektivitetin dhe rritjen e sektorit. Përmes një procesi konsultues me përfshirjen e përfaqësuesve të ndryshëm të OSHC-ve, ky publikim jo vetëm që nxjerr në pah arritjet, por shërben edhe si një arkivë e nismave dhe praktikave më të mira që kanë shënuar rolin e sektorit në zhvillimin e vendit.

Për Partnerët Shqipëri, si organizatë autore, ky publikim nuk është vetëm një kronikë e ngjarjeve; është një reflektim i angazhimit tonë për transparencë, inovacion dhe gjithëpërfshirje. Ai shërben si një arkivë historike dhe një udhërrëfyes strategjik, duke përvijuar vizionin tonë për një kornizë të fortë, efektive dhe gjithëpërfshirëse të shoqërisë civile në Shqipëri. Ai gjithashtu vlen si një burim i çmuar informacioni për akademikët, politikëbërësit dhe të gjithë aktorët e interesuar në ndikimin dhe rolin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin e një Shqipërie moderne.

Në mbyllje, ftoj lexuesit të zhyten në narrativën e shoqërisë civile në Shqipëri, duke reflektuar mbi përvojat e mëparshme dhe duke parë përpara drejt së ardhmes. Nga ana jonë, mbetemi të përkushtuar për të nxitur ndryshime pozitive dhe zhvillim, besnikë ndaj misionit tonë, thellësisht të lidhur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe pjesëmarrjes demokratike.

Mirënjohje

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim shpreh falenderimet dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë ata që kontribuan në përgatitjen e këtij publikimi.

Falenderojmë të gjitha organizatat e shoqërisë civile, drejtuesit, aktivistët dhe ekspertët e tyre, që u bënë pjesë e iniciativës dhe morën pjesë në procesin e konsultimit mbi identifikimin e nismave dhe praktikave të mira të sektorit të shoqërisë civile ndër vite.

Falenderojmë Znj. Bleriana Bino, Studiuuese, Bashkëthemeluese dhe Drejtore Ekzekutive e Qendrës “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV), për asistencën në hartimin e këtij publikimi.

Falenderojmë gjithashtu Znj. Blerta Çani Drenofci, Drejtore Ekzekutive e Fondacionit të Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri (FShDPAK), Z. Mihallaq Qirjo, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Burimore të Mjedisit në Shqipëri REC, Znj. Mirela Arqimandriti, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), Znj. Delina Fico, Eksperte për Shoqërinë Civile, Znj. Ana Majko, Drejtore Ekzekutive e Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS, për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre në identifikimin dhe përgatitjen e nismave të suksesit, si dhe në lehtësimin e konsultimeve me organizata të shoqërisë civile, sipas grupeve nën-sektoriale.

Lista e përfaqësuesve dhe organizatave të shoqërisë civile, pjesëmarrës në procesin konsultues

Abdulla Omuri, Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë

Adelajda Alikaj, Qendra “Streha”

Afërdita Seiti, Shoqata “Ndihmoni Jetën”

Albana Izeti, Terre Des Hommes, Shqipëri

Aldo Merkoci, Lëvizja MJAF

Alketa Lamani, Qendra Rinore Vlorë

Ana Majko, Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS

Ana Mullanji, Përtej Barrierave

Andi Rabiaj, Rrjeti i Organizatave “Zëri i të Rinjve”

Anduela Valle, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ)

Ardita Keraj, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën, (SHKEJ)

Ardita Kolmarku, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ardmir Doda, Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë, Fushë-Arrëz (QSNNN)

Arian Çala, Tjetër Vizion

Armela Pengjili, Qendra Act for Society

Aurela Bozo, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Besjana Sevo, Shoqata Ornitologjike Shqiptare (AOS)

Bledi Taho, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

Bleriana Bino, Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV)

Blerina Celoalij, Save the Children, Shqipëri

Blerta Çani Drenofci, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK)

Blerta Kalavace, Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA)

Borjana Dine, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)

Cveta Trajçe, Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)

Danjel Hyseni, Roma Active Albania

Delina Fico, Eksperte për Shoqërinë Civile

Denada Shpuza, Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”

Diana Kanaj, World Vision Shqipëri

Dikensa Gjokutaj, Kongresi Rinor Kombëtar

Drini Nushi, Instituti i Kërkimeve Urbane

Edlira Bylo, Dimension Human

Ejnxh PEPA, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Elisabeta Shkurti, Shoqata për Gratë dhe Fëmijët Kombinuar (SHPGF)

Elona Gjebrea, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)

Ema Kasapi, Save the Children, Shqipëri

Emanuela Zaimi, Down Syndrome Albania

Endrita Shehu, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Enkelejda Kallçiu, Terre Des Hommes, Shqipëri

Enron Seiti, Shoqata “Ndihmoni Jetën”

Era Kraja, Instituti i Kërkimeve Urbane

Erion Prendi, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën, (SHKEJ)

Esmeralda Xhelilaj, Qendra “Streha”

Fabrizio Nocchi, Opera della Divina Provvidenza Madonnina del Grappa

Fatos Koçi, Voice of Roma in Albania

Fiona Imami, Co-PLAN, Instituti Për Zhvillimin e Habitatit

Florian Rojba, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD)

Florida Kalemi, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK)

Genci Muçollari, Aksion Plus

Genti Kromidha, Instituti Për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

Gerta Meta, Shoqata për Kulturë Demokratike (SHKD)

Gertjana Hasalla, Qendra për të Drejtat në Punë

Ines Leskaj, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)

Iris Luarasi, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Kristina Voko, Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri, Birn Albania

Kujtime Nurja, Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"

Lavdosha Ferruni, Shoqata e Bujqësisë Organike

Lira Hakani, Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)

Lora Arbana, Në dobi të Gruas Shqiptare

Manjola Doko Stefani, Qendra për Zhvillim Komunitar

Margarita Buxhaku, Qendra Shqiptare për Qeverisje Mjedisore (ACEG)

Mariana Meshi, Të Ndryshëm dhe të Barabartë

Marsela Allmuca, Strehëza "Edlira Haxhiymeri"

Marsela Isaku, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

Mihallaq Qirjo, Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC)

Milaim Demnushaj, Të Ndryshëm dhe të Barabartë

Mirela Arqimandriti, Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC)

Ndrek Ismajli, Shoqata e Individëve Para e Tetra Plegjikë

Nevila Jahaj, Qendra Epoka e Re

Olda Ceta, Instituti për Kontratën Shoqërore

Olsi Nika, EcoAlbania

Oreada Kita, Qendra Jonathan

Roberta Profka, Shoqata Internacionale për Solidaritetin (SHIS)

Rudina Pasholli, Co-PLAN, Instituti Për Zhvillimin e Habitatit

Sabina Carcani, Save the Children, Shqipëri

Saimir Bakalli, Fondacioni Joscelyn

Sajmir Neziri, Fondacioni OAZ/Qendra Shpresa e Re

Sevim Arbana, Në dobi të Gruas Shqiptare

Shpresa Spahiu, Ndihmë për Fëmijët (NPF)

Sinan Tafaj, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë

Valbona Mazreku, Milieukontakt Albania

Xhemal Mato, Qendra e Grupimit Ekolëvizja

Xhensila Murati, Qendra Psiko-Sociale "Vatra"

Xhesika Korra, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

Zela Koka, Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (MEDPAK)

HYRJE

Shoqëria civile në Shqipëri

Shoqëria civile në Shqipëri ka pasur një histori të shkurtër por intensive në zhvillimin e saj që nga vitet '90. Organizatat e të drejtave të njeriut ishin ndër të parat që u themeluan, me organizatën e parë formale themeluar në dhjetor 1990 - Forumi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili më vonë u emërtua "Komiteti Shqiptar i Helsinkit".

Grupi tjetër i madh i organizatave joqeveritare dhe grupet e interesit që u zhvilluan ishin organizatat e të drejtave të grave. Përveç organizatave dhe shoqatave të të drejtave të njeriut dhe të grave, periudha e tranzicionit post-komunist pa zhvillimin e formave të reja të organizatave të njohura si "think tank". Fusha të tjera që morën vëmendje ishin shërbimet, rinia, mjedisi, zhvillimi ekonomik dhe media.

Në fillim të viteve '90, me kontributin e shoqërisë civile, u hartua Kushtetuta e re e Shqipërisë, e cila u bë një mjet i rëndësishëm për promovimin e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut. Në të njëjtën kohë, shoqëria civile ndihmoi në ndërtimin e institucioneve të reja demokratike në vend dhe në përmirësimin e sistemeve e proceseve demokratike. Kriza e 1997-ës dhe lufta në Kosovë si edhe strehimi i një milion refugjatëve nga Kosova në Shqipëri në 1999, shënojnë dy periudha të tjera të rëndësishme për vendin, ku roli dhe kontributi i shoqërisë civile ka qenë shumë i rëndësishëm dhe mbështetës në përballimin me gjendjet e jashtëzakonshme dhe të emergjencës civile në vend.

Në fillim të viteve 2000, shumë organizata të reja u themeluan në fusha të ndryshme. Ndërkohë që organizatat tradicionale të shoqërisë civile si ato të fushës së të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së mjedisit ishin vazhdimisht aktive, u krijuan edhe organizata të reja që fokusoheshin në fusha si inovacioni shoqëror dhe teknologjik.

Vitet e fundit, shoqëria civile ka ndihmuar në përballimin e krizave të njëpasnjëshme si tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë kombëtar, duke mobilizuar burimet e tyre për të ofruar mbështetje në periudhën e emergjencës. Ato shërbyen si pika ndërlidhëse informimi mes familjeve të prekura dhe atyre që ofronin ushqime dhe materiale të tjera të nevojshme.

Në 30 vite të zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri, sektori ka bërë një zhvillim të ndjeshëm. Organizatat e shoqërisë civile janë kthyer në faktor ndikues në jetën sociale, ekonomike, kulturore dhe politike të vendit. Sot, shoqëria civile në Shqipëri është e larmishme dhe përfshin organizata të ndryshme që fokusohen dhe japin kontributin e tyre në përballjen e sfidave shoqërore, ekonomike, mjedisore, kulturore, teknologjike dhe politike të vendit.



I.

*SHOQËRIA CIVILE
PËR DEMOKRACI DHE
MIRËQEVERISJE*

1.1 Shteti i së drejtës dhe të drejtat e njeriut

KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILE NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Shoqëria civile luan një rol kritik në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duke ofruar një zë, për ata që ndryshe mund të mos dëgjohen. Ajo monitoron dhe raporton shkeljet e të drejtave të njeriut, ushtron presion tek qeveritë dhe institucionet për të ndërmarrë masa korrigjuese dhe ndihmon në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut rreth të drejtave të njeriut. Përmes këtyre veprimeve, organizatat e shoqërisë civile kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të ndërgjegjshme.

Praktikat e mira të Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Që prej themelimit në 16 dhjetor 1990, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka luajtur një rol udhëheqës në edukimin e shoqërisë shqiptare lidhur me kuadrin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Aktiviteti i KShH-së jashtë vendit është i njohur si rrjedhojë e reagimeve publike, deklaratave të hapura si dhe kontributit të dhënë në Komisionin e Venecias për çështje të rëndësishme si: shtyrja e mandatit të organeve të vetingut; rastet e humbjes së jetës së shtetasve të privuar nga liria nën mbikqyrjen dhe autoritetin e institucioneve publike; masat qeveritare kufizuese të ndërmarra me natyrë tkurrëse ndaj hapësirës së shoqërisë civile në vend dhe në rajon etj.

Vitet e fundit për shkak të zhvillimit të reformave të rëndësishme në vend, si dhe pasojave të gjeneruara nga faktorë të jashtëm në kontekstin politik e social në Shqipëri, KShH ka kontribuar proaktivisht në realizimin e Reformës në Drejtësi, ngritjen dhe mirë-funksionimin e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë; luftën kundër korrupsionit e përfshirjen e të rinjve dhe publikut të gjerë si aktorë kyç në nxitjen e llogaridhënies, transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve shtetërore; parandalimin dhe luftimin e terrorizmit e ekstremizmit të dhunshëm, me fokus të veçantë qarqet hot-spot në vendin tonë, si dhe institucionet e vuajtjes së dënimit; monitorimin e nivelit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nëpërmjet vizitave verifikuese e monitoruese në terren e në institucionet përgjegjëse; luftimin

e kontrabandimit të paligjshëm/trafikimit të qenieve njerëzore dhe monitorimin e garantimit të të drejtave procedurale ndaj migrantëve e azilërkuesve; si dhe ofrimin e asistencës juridike e tekniko-legjislativ ndaj qytetarëve, grupeve informale të qytetarëve si dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, për të adresuar kauza të ndryshme sociale ose çështje që prekin interesat e tyre, nëpërmjet peticioneve, nismave ligjvënëse pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ose investimin e Gjykatës Kushtetuese për elementë të vlerësuar si cënues të dispozitave parimore kushtetuese e konventore.

Dënimi me vdekje dhe diskutimi mbi të, u shndërruan në çështje të rëndësishme pas hyrjes së Shqipërisë në Këshillin e Evropës më 1995. Më 10 nëntor 1999, Komiteti Shqiptar i Helsinkit mori iniciativën e organizimit të një tryeze debat për dënimin me vdekje, me pjesëmarrjen e vyer të juristëve, njerëzve të drejtësisë e psikologëve. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e kish përjashtuar këtë veprim dhe ndalonte zbatimin e tij në kohë paqe. Nga Këshilli i Evropës, Shqipërisë iu kërkua heqja e dënitimit me vdekje. Si pjesë e tryezës së organizuar, u evidentuan dhe statistika ndërkombëtare e botërore. Komiteti Shqiptar i Helsinkit i kërkoi Presidentit që dënimi me vdekje të zëvendësohej me burgimin e përjetshëm. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimit të periudhës dhjetor 1999, mori në konsideratë çështjet e ngritura nga ana e KShH-së duke i dhënë zgjidhje përfundimtare, heqjes së dënitimit me vdekje në vendin tonë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në mbrojtje të interesave të larta të publikut të gjerë ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për 9 akte ligjore e nënligjore, dispozitat e të cilave në këndvështrimin e KShH-së bien ndesh me Kushtetutën ose me aktet konventore të ratifikuara nga ana e Republikës së Shqipërisë. Në 7 raste, Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën e KShH-së e këto raste i korrespondojnë çështjeve të rëndësishme për interesin e publikut ose komuniteteve të prekura, si: përdorimi i makinës së të vërtetës (poligrafit) ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës; përgjimi dhe gjurmimi i autorëve të veprave penale nga Policia e Shtetit, pa një miratim paraprak nga ana e Prokurorisë; inkriminimi i autorëve të dyshuar për përhapje me dashje të sëmundjeve infektive nga pakujdesia, ose në rastet kur nga kryerja e veprës penale janë shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin etj. Pas vënies në lëvizje nga ana e KShH-së, Gjykata Kushtetuese me iniciativën e saj, vendosi që të shfuqizojë disa prej dispozitave të Kodit Penal që parashikojnë dënime fikse si dhe për shfuqizimin e institutit të uljes së dënitimit ose caktimin e një lloji dënimi më të butë pasi për veprat penale që parashikojnë deri në 3 vjet burgim, përgjithësisht minimumi i parashikuar

është 5 ditë burgim dhe rezultonte më herët i parashikuar si lloj dënimi edhe gjoba.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka ofruar asistencë ligjore falas ndaj shtetasve në pamundësi financiare dhe në kushte të vështira socio-ekonomike, për t'u përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur. Përfaqësimi ligjor i interesave të qytetarëve është ofruar pranë Gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare, përfshirë Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Gjatë ekzistencës rreth 32 vjeçare në vendin tonë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka monitoruar në mënyrë sistematike sistemin e burgjeve dhe institucionet e mbyllura (përfshirë komisaritet e ambientet e qëndrimit të azilkërkuesve/refugjatëve). Qëllimi i këtyre misionëve ka qenë dhe mbetet verifikimi i situatës dhe nivelit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, nga ana e entiteteve publike dhe atyre private. Pas apeleve të vazhdueshme, bazuar në gjetjet shqetësuese dhe trajtimin çnjerëzor të konstatuar në mjediset e burgut të Zaharisë, në të cilin prej dekadash kanë qëndruar të izoluar shtetasit ndaj të cilëve Gjykata kish vendosur "masë mjekësore", u kërkua me ngulm marrja e masave nga ana e Qeverisë Shqiptare për ta mbyllur këtë institucion. Pas heshtjes institucionale disa vjeçare, KShH ka përfaqësuar pranë institucioneve gjyqësore vendase dhe atyre ndërkombëtare, interesat e ligjshme të shtetasve pjesë e këtij komuniteti vulnerabël të shoqërisë. Pas mbylljes së burgut të Zaharisë, në nëntor të vitit 2021, e në mungesë të ngritjes së një institucioni të posaçëm, dhe transferimit të shtetasve pranë dy godinave të burgut Lezhë, KShH ka bërë thirrje për marrjen e masave për zbatimin rigoroz nga ana e autoriteteve të vendimmarrjes së Gjykatës së Strasburgut. KShH ka mbajtur qëndrim publik për vlerësimin e këtij transferimi si një zgjidhje e përkohshme, si dhe marrjen e masave për përshpejtimin e hapave për garantimin e trajtimit dinjitoz e sipas kriterëve e standardeve ligjore ndaj kësaj kategorie të pacientëve.

Rezultati

Organizatrat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe forcimin e demokracisë në vend. Përfaqësimi dhe mbrojtja e shtetasve shqiptarë pranë gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare, ofrimi i asistencës ligjore falas për qindra qytetarë, ndryshimet dhe përmirësimet e kuadrit ligjor dhe politikave, janë disa nga rezultatet kryesore të veprimtarisë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit ndër vite.

ZHVILLIMI I KUADRIT LIGJOR DHE POLITIKAVE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE

Pas ratifikimit të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës në vitin 1992, në Shqipëri u miratua Strategjia për Fëmijët dhe Plani i Veprimit për periudhën 2001-2005 në mbështetje të Kushtetutës dhe Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, si pasojë e përpjekjeve të organizatave të shoqërisë civile për përmirësimin e kuadrit ligjor për garantimin e të drejtave të fëmijëve. Strategjia e parë për fëmijët solli dhe ngritjen e strukturave të para të mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror dhe vendor.

Me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe në bashkëpunim me sekretariatën për mbrojtjen e fëmijëve në nivel Ministrie, në vitin 2008, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) zhvilloi ligjin kuadër “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”. Ligji, i miratuar në vitin 2010, përcaktonte të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, autoritetet e ngarkuara me zbatimin e këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën. Ky ligj mundësoi njohjen zyrtare të NJMF të bazuar në pilotimin e mëparshëm dhe në krijimin e grupeve multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë/komunës. Këto struktura të reja të mbështetura plotësisht nga organizatat e shoqërisë civile për ngritjen, pajisjen dhe protokollat e punës dhe zhvillimin e kapaciteteve, sollën një zhvillim në ngritjen e mekanizmit të mbrojtjes së fëmijëve me struktura dhe persona të dedikuar për ofrimin e këtij shërbimi. Ky ligj mbështeti fuqizimin e ngritjes së një mekanizmi të plotë dhe funksional për mbrojtjen e fëmijëve dhe garantimin e të drejtave.

Në vijim të përmirësimit dhe përforcimit të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve, u propozua një Ligj i ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Organizatat lokale dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile si Terre des hommes, World Vision, Save the Children, UNICEF, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ), Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, Partnerë për Fëmijët, etj. ishin shumë proaktive në këtë proces. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” në Republikën e Shqipërisë u miratua më datë 23.2.2017 dhe hyri në fuqi më datë 9.6.2017. Ligji përcaktoi të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Nga organizatat e shoqërisë civile u bënë përpjekje për legjitimin e këtij protokolli dhe jo vetëm në kuadër të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve por edhe të

angazhimit të Ministrive kryesore përgjegjëse për çështjen e mbrojtjes së fëmijëve. Për këtë qëllim, me përpjekjen dhe mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile u miratua një urdhër ndërmintor i nënshkruar mes të katër ministrive kryesore përgjegjëse për çështjen e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë. Ky urdhër, kërkonte për të gjithë profesionistët e Mbrojtjes së Fëmijëve, përfshirë edhe anëtarët e Ekipeve multidisciplinore / ndërsektoriale, nga sektorë si shëndetësia, arsimi dhe zbatimi i ligjit, të aplikojnë dhe respektojnë “Protokollin e Punës për Mbrojtjen e Fëmijëve”.

Një kontribut tjetër ka qenë edhe hartimi i planit të parë Kombëtar të Veprimit për identifikimin, ndërhyrjen e menjëhershme dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri. Ky proces kontribuoi në hartimin e udhëzuesit të parë për skuadrat e terrenit për identifikimin, ndërhyrjen e menjëhershme dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge, si dhe në VKM nr. 129, datë 13.3.2019 “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”, iniciuar dhe mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE).

Përgjatë pandemisë globale të Covid-19, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me mbështetjen e Terre des hommes dhe Save the Children, hartoi dhe miratoi aktin nënligjor nr. 253 dt.10.04.2020 “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid 19”.

Ligji i ri përforcoi mekanizmin e mbrojtjes së fëmijëve duke përfshirë ndërmarrjen e masave të mbrojtjes dhe të emergjencës për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë procedura, struktura dhe punonjës të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve.

Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” kontribuoi në miratimin e një sërë aktesh nënligjore për përforcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. 236 punonjës së mbrojtjes së fëmijëve janë punësuar pranë Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë Shqipërinë, çka përbën gati 52% të punonjësve që nevojiten dhe janë kërkuar për të përballuar nevojat për mbrojtje të fëmijëve dhe garantimin e të drejtave të tyre. Sipas raportit të monitorimit 4 vjeçar të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, nga 236 punonjës, vetëm 45 punojnë me kohë të plotë në këtë pozicion pranë Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Organizatave të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së fëmijëve kanë ndërmarrë nismën e hartimit të Planeve Lokale të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel bashkie, fillimisht si plane më vete dhe më pas si plane të integruara në planet lokale sociale. Save the Children ka asistuar

Bashkitë Gjirokastër, Shkodër, Burrel në hartimin e planeve të mbrojtjes së fëmijëve të cilat janë miratuar me vendim të këshillit bashkiak.

Një nismë gjithashtu e rëndësishme në kuadër të garantimit të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre si rrjedhojë e një angazhimi shumëvjeçar të organizatave si Save the Children, Shërbimet Sociale Bethany, UNICEF, Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe fshatrave SOS në Shqipëri, ishte hartimi i Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, me vendim nr. 706 datë 09.09.2020. Ky plan erdhi si një përpjekje e masave për transformimin e shërbimeve rezidenciale të përkujdesit shoqëror në shërbime komunitare me bazë familjen.

Rezultati

Organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen e fëmijëve në koalicion, kanë kontribuar në advokimin për të patur një ligj të dedikuar për fëmijët për të njohur strukturat dhe mekanizmat e ngritura për mbrojtjen e fëmijëve. Miratimi i ligjit për fëmijët ka sjellë disa arritje: 1) Përfshirja në legjislacionin vendas të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) si një detyrim ligjor si vend nënshkrues dhe ratifikues; 2) Njohja dhe institucionalizimi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) si struktura bazë për mbrojtjen e fëmijëve; 3) Krijimi i mekanizmave lokalë dhe qendrore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Edhe pas miratimit të ligjit të parë për mbrojtjen e fëmijëve, organizatat e shoqërisë civile kanë punuar fort për përmirësimin dhe rishikimin mbi bazën e sfidave të identifikuara gjatë zbatimit.

PROMOVIMI I DREJTËSISË MIQËSORE PËR FËMIJËT NË KONTAKT DHE NË KONFLIKT ME LIGJIN

Organizatat e shoqërisë civile kanë punuar së bashku duke zhvilluar një partneritet të fortë në fushën e drejtësisë për të mitur, në mënyrë të veçantë në ngritjen e mekanizmave të drejtësisë për të mitur, ofrimin e një drejtësie miqësore për fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin, veçanërisht duke synuar grupet vulnerabel si dhe modelimin e shërbimeve përkatëse në drejtim të parandalimit, trajtimit dhe ri - integritit të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin. Kjo ndërhyrje shërbeu si një bazë për punën e madhe advokuese të realizuar nga ana e shoqërisë civile për të ligjësuar qasjen e drejtësisë miqësore për të mitur dhe për të hartuar një Kod të veçantë për Drejtësinë për të Mitur.

Praktika të mira të shoqërisë civile për qendrat për mbrojtjen e fëmijëve

Save the Children (SC) në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar të Zgjidhjes së Konflikeve (AFCR) dhe Qendrën e Praktikave dhe Shërbimeve të Integruara Ligjore (CILPS), kanë ofruar një set ndërhyrjesh në fushën e drejtësisë për të mitur duke synuar promovimin dhe krijimin e shërbimeve dhe mundësive miqësore për fëmijët në kontakt me ligjin.

Këto ndërhyrje kanë përfshirë ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të sistemit të drejtësisë mbi: qasjen e drejtësisë miqësore për të miturit dhe aplikimin e saj në sistemin e drejtësisë në vendin tonë, dënimet alternative dhe drejtësia restauruese; ndërmjetësimin dhe menaxhimin e konflikteve etj, si dhe zhvillimin e manualeve dhe protokolleve të punës për profesionistët e sistemit të drejtësisë (policë, prokurorë, gjyqtarë, përmbarues) si dhe profesionistëve të shërbimeve sociale (punonjës socialë dhe psikologë) për ofrimin e shërbimeve miqësore për fëmijët në konflikt dhe kontakt me ligjin si dhe aplikimin e drejtësisë restauruese. Një tjetër ndërhyrje me vlerë ishte krijimi i hapësirave miqësore për fëmijët në konflikt me ligjin brenda Drejtorive Rajonale të Policisë dhe rehabilitimi i strukturave ekzistuese.

Ndërhyrjet e sektorit të shoqërisë civile me fokus fëmijët, nga Save the Children, Terre des hommes, UNICEF etj., kanë mbështetur krijimin e një mekanizmi të integruar referimi për fëmijët në kontakt me ligjin nën moshën minimale të përgjegjësisë penale i zbatuar me protokolle të nënshkruara ndërmjet aktorëve kryesorë të përfshirë (gjyqtarët, prokurorët, policia, shërbimet sociale, zyra e provës) për të garantuar një qasje të koordinuar bazuar në vlerësimet e duhura të nevojave dhe të fokusuara në interesin më të lartë të fëmijës.

Rezultati

Drejtësia miqësore për fëmijët në kontakt dhe në konflikt me ligjin është zhvilluar në dekadën e fundit falë ndërhyrjeve të organizatave të shoqërisë civile të cilat ndër vite kanë arritur të ngrenë dhe forcojnë një sistem të drejtësisë gjithëpërfshirës për të miturit falë advokimit për hartimin e politikave në drejtim të parandalimit të krimit të të miturve për fëmijët në rrezik dhe në kontakt me ligjin, me një vëmendje të veçantë kushtuar fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë. Gjithashtu është arritur prezantimi dhe vënia në zbatim e mekanizmave alternativë të dënimit të fëmijëve që synojnë të largojnë fëmijët nga proceset ligjore formale për të reduktuar përdorimin e paraburgimit për të miturit në kontakt me ligjin, nëpërmjet forcimit të aksesit ndaj masave alternative, të monitoruara në mënyrë adekuate për të garantuar efektivitetin e tyre.

LIGJI PËR PAKICAT KOMBËTARE

Shoqëria civile ka një rol thelbësor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare, duke siguruar se interesat dhe shqetësimet e tyre janë pjesë e dialogut publik dhe të agjendave politike. Ajo ndihmon në zbulimin dhe luftimin e diskriminimeve, në mbështetjen e kulturave dhe gjuhëve të pakicave, në nxitjen e përfaqësimit të tyre të barabartë në strukturat qeverisëse etj. Organizatat e shoqërisë civile punojnë pa ndërprerje për të ndërgjegjësuar shoqërinë dhe qeverinë mbi rëndësinë e respektimit dhe mbështetjes së të drejtave të këtyre komuniteteve.

OSHC-të në mbrojtje të pakicave Rome dhe ligji i ri i pakicave kombëtare

“Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri”, në partneritet me “Roma Active Albania”, “Voice of Roma” dhe USHTEN, si pjesë e Rrjetit të Organizatave të Shoqërisë Civile Rome – NACRIA (National Advocacy Coalition for Roma in Albania) dhe në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, ka marrë pjesë në mënyrë aktive në proceset konsultative për plotësimin e kuadrit normativ mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare në vend. Për këtë qëllim, në vitin 2017, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) koordinoi mbledhjen e komenteve dhe rekomandimeve nga shoqëria civile rome, mbi projektligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Po ashtu, në vitin 2018 u dërgua një analizë e plotë mbi 12 projektvendimet e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen e pakicave. Ndonëse 9 prej këtyre projektvendimeve janë miratuar, ende vijon procesi i konsultimit për 3 projektvendimet e fundit.

Pas miratimit të ligjit, organizatat e shoqërisë civile rome në Shqipëri, janë konsultuar edhe me përfaqësuesit dhe aktivistët e pakicave kombëtare në Shqipëri, dhe duke marrë në konsideratë gjithashtu rekomandimet e rezolutës mbi raportin e katërt që Shqipëria ka paraqitur për zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, kanë paraqitur rekomandimet e tyre për tre projektvendimet ende në proces për tu miratuar.

Rezultati

Deri në vitin 2017 nuk ekzistonte ndonjë kornizë ligjore specifike për mbrojtjen e pakicave. Të drejtat e minoriteteve ishin të përcaktuara në ligje të ndryshme të sistemit ligjor të vendit, duke lejuar një sërë mangësish në njohjen e pakicave si dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Të drejtat e garantuara nga Ligji përfshijnë të drejtën për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj.

Për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar ky ligj përfshin një përkufizim i cili përjashton mospërputhjet në kriteret ligjore të kërkuara për njohjen e statusit të pakicave. Sipas përkufizimit, legjislati shqiptar njih zyrarisht nëntë pakica, grekët, maqedonasit, arumunët, romët, serbët, malazezët, të njohur si pakica edhe më parë por pa asnjë bazë ligjore, si dhe boshnjakët, bullgarët dhe egjiptianët të cilët u njohën si pakica kombëtare për herë të parë me miratimin e ligjit të ri. Gjithashtu, ligji eliminon ndarjen midis kategorive të "pakicave kombëtare" (një status i gëzuar më parë nga pakicat greke, maqedonase, malazeze dhe serbe) dhe të "pakicave gjuhësore" (një status i gëzuar më parë nga pakicat rome dhe arumune). Ligji i ri përfshin të gjitha grupet minoritare në një kategori, të asaj të pakicave kombëtare, duke përjashtuar çdo diskriminim në bazë të statusit të tyre.

KONTRIBUTI I OSHC-VE PËR HARTIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR TË FUSHËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Shoqëria civile është një aktor kyç në mbrojtjen dhe advokimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke u përpjekur për një përfshirje më të mirë dhe të barabartë të tyre në shoqëri. Ajo kontribuon në sensibilizimin e publikut dhe të qeverisë, mbi çështjet me të cilat përballlet ky segment i popullsisë, dhe promovon krijimin e mjediseve të përshtatshme dhe të arritshme për të gjithë. Përmes veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile, theksohet rëndësia e një trajtimi të barabartë dhe garantimi i të drejtave të plota për personat me aftësi të kufizuara, duke ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të ndërgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse.

Organizatave joqeveritare të fushës së aftësisë së kufizuar kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në ndryshimet dhe përmirësimet e kuadrit ligjor dhe politikat në Shqipëri. Sa më sipër, ndryshoi vizionin e trajtimit të aftësisë së kufizuar, duke e trajtuar atë si një çështje të të drejtave të njeriut dhe duke e orientuar qasjen e vlerësimit të trajtimit drejt modelit bio psiko social të aftësisë së kufizuar, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndër vite, organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar kanë ndikuar fort për të mundësuar gjithëpërfshirjen e çështjeve të aftësisë së kufizuar në ligje dhe politika të hartuara për të gjithë qytetarët shqiptarë.

Ndikimi i organizatave të fushës së aftësisë së kufizuar, mundësoi përfshirjen në kuadrin ligjor të disa prej shërbimeve më të rëndësishme të zinxhirit të shërbimeve të nevojshme, në përputhje me moshën, për personat me aftësi të kufizuara dhe ndryshuan qasjen në lidhje me përfshirjen e barabartë në arsim, punësim dhe formim profesional, përmes realizimit të aksesueshmërisë dhe përshtatjes së arsyeshme për çdo fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara. Këto ndryshime ishin shumë të rëndësishme dhe e trajtuan aftësinë e kufizuar si një përgjegjësi të shumë sektorëve dhe institucioneve në Shqipëri.

Që prej vitit 2006, organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar janë përfshirë periodikisht në procesin e monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor e politik në vend, por edhe në përgatitjen e raporteve hije me fokus zbatimin e dokumenteve dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Disa nga nismat dhe kontributet e organizatave të fushës së aftësisë së kufizuar në Shqipëri, të cilat kanë luajtur një rol thelbësor në hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të fushës së aftësisë së kufizuar, kryesore paraqiten më poshtë.

Hartimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor

Organizatave të fushës së aftësisë së kufizuar si Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Shoqata "Ndhmoni Jetën", Save the Children, World Vision, Shoqata Mbrotjtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK), Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), Down Syndrome Albania, Qendra Jonathan, Shoqata për Gratë dhe Fëmijët, Shoqata e Individëve Para e Tetra Plegjikë, etj. nxitën hartimin e ligjeve specifike të grupimeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar në vitet e para të procesit të tranzicionit në Shqipëri (1994-2000). Më pas, në periudhën 2002-2022, u përfshinë në një proces

advokimi, bashkëpunimi, konsultimi e partneriteti me qeverinë në hartimin e dokumenteve politikë e ligjeve, përmes të cilave aftësi të kufizuara trajtohej si një çështje shumësektoriale dhe shumë dimensionale. OJF-ve të fushës së aftësisë së kufizuar u takon marrja e nismave për të mundësuar përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në ligje e strategji të lidhura me punësimin, shërbimet, infrastrukturën, arsimin dhe proceset elektorale. Më shumë se 25 akte ligjore e nënligjore si edhe dokumenta politikë që lidhen kryesisht me të drejtat e aftësisë së kufizuar janë përmirësuar për shkak të përpjekjeve të lobimit dhe advokimit të OSHC-ve të fushës. Ndërhyrjet janë fokusuar në të gjitha fushat, përfshirë fushën e shërbimeve shoqërore.

Disa nga propozimet kryesore ligjore kanë synuar dhe adresuar hartimin dhe ndryshimin e kuadrit ligjor dhe politik si më poshtë:

- Ratifikimi i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Qeveria Shqiptare (Ligji nr. 108/2012).
- Sigurimi i aksesueshmërisë, si parakusht për të garantuar aksesin në shërbime, duke u bërë pjesë e procesit të hartimit, si dhe aprovimi i dokumentave dhe ligjeve që garantojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Advokasia dhe ekspertiza ligjore mundësuan hartimin dhe aprovimin e: (i) Paketës së Normave Urbanistike dhe Arkitektonike (miratuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit në dhjetor 2003); (ii) Rregullores së Urbanistikës, e cila përfshin dhe Paketën e Normave Urbanistike dhe Arkitektonike, miratuar nga Këshilli i Ministrave në qershor 2004; (iii) Ligjit “Për Planifikimin e Territorit”, i miratuar në vitin 2009; (iv) VKM Nr. 1503 “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, miratuar në nëntor 2009.
- Ekspertizë në ndryshimet ligjore që lidhen me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ndryshime në Ligjin për nxitjen e punësimit, Kodin e Punës dhe legjislacionin dytësor.
- Arsimi: Në fillim të viteve 2000, OSHC-të filluan të promovojnë arsimin gjithëpërfshirës në Shqipëri. Në 2002, Ministria e Arsimit dhe Sportit miratoi për herë të parë “Dispozitat Normative të Arsimit Parashkollor”, e cila përfshinte konceptin e arsimit gjithëpërfshirës. Ligji Nr. 69/2012 “Mbi Arsimin Parauniversitar”, përfshiu gjerësisht konceptet e përfshirjes në

arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përsëri falë përpjekjeve ndikuese dhe ekspertizës së ofruar prej organizatave të shoqërisë civile.

- Mbrojtja Sociale: Nga viti 1994, organizatat e personave me aftësi të kufizuara kanë ndihmuar në përmirësimin e ligjeve të mbrojtjes sociale, si Ligji “Për statusin e invalidit”, ligji “Për statusin e të verbrit”, “Për statusin e individëve para e tetra plegjikë”, Ligji “Për njohjen e gjuhës së shenjave”, si dhe hartimi i “Standardeve të shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror”.
- Të drejtat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara: OSHC-të kanë promovuar barazinë gjinore, duke fuqizuar vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara dhe duke i ndihmuar ato të marrin një rol udhëheqës në çështje të rëndësishme publike. Çështjet e dhunës ndaj vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara janë përfshirë në Ligjin Nr. 47/2018, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, si edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit, 2016-2020.
- Strategjitë Kombëtare dhe Planet e Veprimit: Organizatat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin dhe miratimin e strategjive kombëtare për personat me aftësi të kufizuara si Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 -2020 dhe 2021-2025 si dhe për ndryshime pozitive në Ligjin nr. 93/2014, datë 24.7.2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë për Personat me Aftësi të Kufizuara”, por edhe në hartimin dhe aprovimin e dokumenteve politikë e kuadrit ligjor, përfshirë Reformën Kushtetuese, Dokumentin Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020, Ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”.
- Advokasi dhe ekspertizë për hartimin e planeve vendore: Organizatat e shoqërisë civile kanë ndihmuar në hartimin e planeve vendore për personat me aftësi të kufizuara, me fokus në garantimin e shërbimeve sociale.

Rezultati

Organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Duke i fokusuar ndërhyrjet e tyre në advokimin për hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, OSHC-të kanë kontribuar në miratimin e mbi 25 akteve ligjore dhe dokumenteve politike që mbrojnë dhe garantojnë të drejtat e kësaj kategorie të shoqërisë. Këtu, përfshihen çështje si aksesueshmëria në mjedise, informacion e komunikim, arsimi gjithëpërfshirës, punësimi e formimi profesional, mbrojtja sociale dhe të drejtat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara, barazia përpara ligjit dhe aksesit në drejtësi, etj.

Ndikimi i tyre për të nxitur e mundur gjithëpërfshirjen e çështjeve të aftësisë së kufizuar në ligje dhe politika për të gjithë, duke ndryshuar vizionin e trajtimit të aftësisë së kufizuar dhe duke e trajtuar si një çështje të të drejtave të njeriut, janë disa nga arritjet konkrete të nismave të ndërmarra nga organizatat e shoqërisë civile të fushës së aftësisë së kufizuar.

Rezultatet janë evidente në rritjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare.

KUNDËRSHTIMI I “PAKETËS ANTI-SHIPFJE”

Shoqëria civile luan një rol thelbësor në mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së medias, një kolonë e rëndësishme e demokracisë së një shteti. Ajo vë në vëmendje, denoncon dhe kundërshton çdo tentativë për censurë, ndërhyrje në pavarësinë e gazetarëve ose kufizime të të drejtave të shprehjes. Organizatat e shoqërisë civile mbështesin gazetarët në situata të vështira, kërkojnë llogari nga autoritetet për sulmet ndaj medias dhe ndihmojnë në edukimin e publikut mbi rëndësinë e medias të lirë dhe të pavarur. Përmes monitorimit, raportimit dhe advokimit, shoqëria civile kontribuon në krijimin e një mjedisi ku media mund të funksionojë pa frikë dhe ku liria e shprehjes mbetet një prioritet.

Roli i shoqërisë civile në kundërshtimin e “Paketës Anti-Shpifje”

Në dhjetor 2018, qeveria shqiptare bëri një sërë ndryshimesh në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive” si pjesë e të ashtuquajturës “Paketa anti-shpifje”. Sipas relacionit që shoqëroi

projektligjin, qëllimi i kësaj nisme ligjore ishte disiplinimi i medias në përgjithësi dhe medias online në veçanti, për shkak të rritjes së ndikimit të tyre në aspekte të ndryshme të jetës publike të vendit.

I menjëhershëm ishte reagimi i organizatave të shoqërisë civile si BIRN Albania, Civil Rights Defenders, Citizen Channel, Qendra Faktore, Instituti Shqiptar i Medias, Instituti Shqiptar i Shkencave, Këshilli Shqiptar i Medias, Qendra Res Publica, Qendra Shqiptare MediaLook, Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore, Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë, Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë etj., të cilat u bënë bashkë për të kundërshtuar paketën anti-shpifje.

Për më shumë se një vit, projektligji u bë objekt debati mes qeverisë, organizatave të shoqërisë civile dhe parlamentit. Pavarësisht amendimeve të paraqitura në draftet e ndryshme nga ekspertë të angazhuar nga organizma ndërkombëtare, qëllimi thelbësor i projektligjit për rregullimin e medias online nëpërmjet një enti administrativ, nuk u ndryshua.

Sipas organizatave vendase dhe ndërkombëtare të lirisë së medias, rregullimi i mediave online përmes një subjekti administrativ – anëtarët e të cilit zgjidhen nga partitë politike – ishte kundër praktikave më të mira ndërkombëtare, të cilat theksojnë se vetërregullimi është mënyra më efikase për të luftuar dezinformimin, propagandën dhe lajmet e rreme.

Deri në votimin në parlament, organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e njeriut dhe lirinë e medias reagon disa herë ndaj të ashtuquajturës paketë 'antishpifje', duke kërkuar refuzimin e drafteve. Megjithatë parlamenti zhvilloi konsultime me përfaqësues të medias, shoqërisë civile dhe akademikë të gazetarisë para votimit në dhjetor 2019, organizatat e shoqërisë civile e konsideruan procesin jotransparent dhe theksuan mungesën e aksesit në draftet e ndryshme të projektligjeve. Si rezultat, votimi i projektligjit në parlament më 18 dhjetor 2019, është bërë në një mjedis mosbesimi, teksa gazetarë dhe aktivistë të shoqërisë civile po protestonin jashtë parlamentit.

Kundërshtitë dhe protestat e vazhdueshme të aktorëve të shoqërisë civile sollën për rrjedhojë mos dekretimin e ligjit nga Presidenti i Republikës në 11 janar 2020, si dhe marrjen nën shqyrtim të ndryshimeve të propozuara nga Komisioni i Venecias. Opinioni i këtij të fundit i publikuar në 19 qershor 2020, konfirmoi dhe një herë rëndësinë e shqetësimeve të ngritura nga organizatat e shoqërisë civile dhe pasojat negative që ky ligj do të shkaktonte për lirinë e medias në rast se miratohej në formatin e propozuar, rekomandim ky që u përfshi dhe nga Komisioni Evropian në kushtet e vendosura Shqipërisë në procesin e integritetit Evropian të vendit.

Rezultati

Të gjithë hapat e ndërmarrë e bënë të qartë se rezistenca dhe mbikëqyrja e një akti të tillë ishin të fuqishme dhe të vendosura. Si pasojë, projektligji, i cili do të kishte pasur ndikime të rëndësishme nëse do të kishte kaluar, nuk arriti asnjëherë të fitonte mbështetjen e nevojshme për të kaluar në parlament. Ky dështim e bëri të qartë nevojën për mekanizma dhe nisma vetërregulluese, të cilat do të respektonin më mirë interesat dhe shqetësimet e përfshira. Ndërsa parlamenti ka të drejtën për të propozuar dhe shqyrtuar ligje, kjo ndërhyrje nga aktorët e ndryshëm tregoi fuqinë e demokracisë pjesëmarrëse dhe rëndësinë e dialogut dhe konsensusit.

RIPËRDORIMI SOCIAL I PASURIVE TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR

Progresi në zbatimin e Reformës në Drejtësi dhe ngritja e institucioneve të saj rriti fokusin në ndjekjen e të ardhurave nga krimi nëpërmjet rikuperimit të pasurive. Në këtë drejtim, u shfaq një potencial në rritje për ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar, si një mundësi e qartë për të treguar se ekonomia e ligjshme mund të jetë më efikase se ajo e paligjshme, duke bashkuar interesin publik dhe qëndrueshmërinë ekonomike.

C.A.U.S.E. – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale

Në vitin 2016 Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në bashkëpunim me Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara filloi zbatimin e C.A.U.S.E. – Përdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale, financuar nga Bashkimi Evropian. Iniciativa e parë e këtij lloji në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor, C.A.U.S.E., prezantoi një model të ripërdorimit social të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar, nga organizatat e shoqërisë civile në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si një mjet i vlefshëm për të riafirmuar vlerën e ligjshmërisë dhe veprimeve të qytetarëve kundër krimit të organizuar.

Duke aplikuar një qasje novatore, të fokusuar në promovimin dhe zhvillimin e kulturës së sipërmarrjes sociale dhe luftës kundër krimit të organizuar, C.A.U.S.E ofroi njohuri, aftësi dhe mbështetje financiare për OSHC-të për krijimin e ndërmarrjeve sociale në prona të konfiskuara nga krimi i organizuar.

Tre sipërmarrjet e para sociale, të ngritura në prona të konfiskuara ishin:

KeBuono, një pastiçeri sociale që ofron një shumëllojshmëri produktesh pastiçerie, si dhe aktivitete integruese me fëmijët dhe prindërit, adoleshentët, studentët dhe gratë, duke synuar të ndërtojë një kulturë të ligjshmërisë dhe kundra dhunës në komunitet.

KinFolk Librari Kafe, një nismë sociale që transformoi një pasuri të konfiskuar në një mjedis miqësor për të rinjtë.

Garazhi Social i Artizanatit, një mjedis ku gratë dhe vajzat - viktime ose të rrezikuara nga krimi i organizuar dhe dhuna në familje, bëjnë punime artizanale duke përdorur gurë natyralë nga plazhi (gurë shumëngjyrësh, një ngjyrë, xhami, etj.).

Rezultati

CAUSE arriti të transformojë tre pasuri të konfiskuara nga krimi i organizuar në tre qytete të ndryshme të Shqipërisë në mjedise që ofrojnë:

- Mundësi arsimimi, punësimi dhe integrimi për grupet e marginalizuara, të prekur ose në rrezik për t'u prekur nga krimi i organizuar;
- Produkte dhe shërbime për qytetarët;
- Aktivitete sociale, kulturore dhe ndërgjegjësuere për komunitetin.

KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILEPËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E LIGJIT PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Para vitit 2014, procesi i konsultimit publik në Shqipëri nuk ishte i formalizuar dhe i orientuar kah qytetarëve dhe shoqërisë civile. Ndonëse ka pasur përpjekje për të angazhuar publikun dhe shoqërinë civile në vendimmarrje, ky proces ka qenë sporadik dhe formal. Megjithëse ka patur raste kur qeveritë e ndryshme kanë zhvilluar takime konsultuese për disa çështje specifike, mungesa e një kuadri të qartë ligjor dhe rregullator e bënte këtë proces të paparashikueshëm dhe pa një strukturë të qartë. Megjithëse shumë OJF dhe grupime të shoqërisë civile ishin aktive dhe tentonin të ndikonin në politikë-bërje, ato hasnin vështirësi në përfshirjen e tyre të vazhdueshme dhe të strukturuar në procesin e konsultimeve. Pas vitit 2014, me ndihmën e organizmave ndërkombëtarë dhe presionin e shoqërisë civile, Shqipëria ka ndërmarrë reforma të rëndësishme për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të ecur drejt një qeverisje më gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

Miratimi i ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Shqipëria, më 30 tetor të vitit 2014, miratoi ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, nr. 146/2014, një akt ky kushtuar tërësisht procedurave që duhen ndjekur për një proces konsultimi publik sa më efektiv. Ky ligj hyri në fuqi në maj të 2015-ës. Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik erdhi si pjesë e paketës së propozuar nga shoqëria civile për të përmbushur nevojën për një qeverisje më transparente dhe ndërmarrjen e politikave dhe nismave ligjore duke përfshirë edhe qytetarët e interesuar, OJF-të etj. Qendra Respublica, Fondacioni për Shoqërinë e Hapur për Shqipërinë dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile nxitën miratimin e këtij ligji dhe kontribuan gjatë hartimit dhe konsultimit të tij.

Ligji u miratua tri vjet pas angazhimit të qeverisë shqiptare në Partneritetin për Qeverisje të Hapur (OGP) me një rol aktiv të organizatave të shoqërisë civile (BalkanInsight, 2014). Progresi i shënuar në atë kohë me kontributin e shoqërisë civile vihet re edhe në raportin 2014-2016 të OGP, si edhe në Dokumentin Strategjik Indikativ për Shqipërinë “Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II) 2014-2020. Gjithashtu dhe renditja e Shqipërisë në Raportin “Kombet në Tranzicion 2015” u përmirësua pak edhe si pasojë e këtyre ndryshimeve ligjore (Freedom House, 2015). OJF-të kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në hartimin e ligjit dhe në lobimin për miratimin e tij. Më pas disa organizata si Fondacioni Shoqëria e Hapur për

Shqipërinë, Qendra ResPublica, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim etj. kanë monitoruar vazhdimësinë e zbatimit të ligjit duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin e tij.

Rezultati

Shoqëria civile ka luajtur një rol të rëndësishëm në proceset e konsultimit publik në Shqipëri, duke u bërë zëri i qytetarëve dhe duke u përpjekur që vendimmarrja të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe të reflektojë interesat e të gjithëve. Për të gjitha ndryshimet kritike legjislative dhe politikat e ndryshme që janë miratuar ose janë në shqyrtim, organizatat e shoqërisë civile kanë ndihmuar në organizimin e takimeve, debatit publik dhe sesioneve informuese për të kuptuar shqetësimet e qytetarëve dhe marrë opinionet e tyre.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve, shoqëria civile ka theksuar rëndësinë e transparencës, pjesëmarrjes dhe informimit të qytetarëve. Kjo ka ndihmuar në krijimin e një kulture të re të vendimmarrjes, ku qeveria dhe institucionet e tjera janë më të ndjeshme ndaj nevojave dhe kërkesave të publikut. Megjithatë, procesi i konsultimit publik has ende shumë sfida që të mos jetë thjesht një proces formal, por një instrument kyç për të garantuar që vendimmarrja është e balancuar dhe e drejtë. Ndërveprimi mes shoqërisë civile dhe institucioneve gjithashtu nuk është ende në pritshmëritë e një qeverisje demokratike e transparente edhe ka ende shumë për të bërë në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

I.2 Zgjedhjet e lira e të ndershme, lufta kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës

KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILE NË PROCESET ZGJEDHORE

Në çdo demokraci, procesi zgjedhor është një moment kyç për përcaktimin e qeverisjes së vendit. Në Shqipëri, shoqëria civile ka luajtur një rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor nëpërmjet monitorimit dhe raportimit të procesit, si dhe inkurajimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në zgjedhje. Shoqëria civile shqiptare ka një histori të gjatë dhe të pasur të pjesëmarrjes së saj në proceset zgjedhore, duke e ndjekur nga afër procesin dhe duke raportuar rregullisht mbi mënyrën si janë mbajtur zgjedhjet dhe duke denoncuar raste të ndryshme të korrupsionit zgjedhor.

Praktikat e mira të Shoqatës për Kulturë Demokratike

Një prej organizatave joqeveritare që ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim është Shoqata për Kulturë Demokratike (SHKD), e cila ka monitoruar të gjitha proceset zgjedhore prej 1992 [përfshirë 9 zgjedhje parlamentare (1992, 1996, 1997, 2001, 2005, 2009, 2013, 2017, 2021), 8 zgjedhje lokale (1996, 1998, 2000, 2003, 2007, 2011, 2015, 2019) dhe 2 referendume (1994, 1998)] dhe ka angazhuar rreth 1000-1500 vëzhgues të pavarur në të gjithë vendin në çdo proces zgjedhor.

Në fushatën zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare të Maj-it 1996, SHKD realizoi për herë të parë në Shqipëri procesin e monitorimit të Medias elektronike për periudhën 1996-2001.

SHKD është një nga organizatat e para joqeveritare në vend, që ka ndjekur punën e Komisionit të Reformës Zgjedhore, gjatë gjithë kohës e në vijim dhe ka kontribuar me rekomandime konkrete për të ndihmuar në finalizimin e një dokumenti përfundimtar, i cili do përmbante të gjitha pikat e përbashkëta të përcaktuara nga forcat politike me konsensus midis tyre.

Në periudhën 2005-2017, SHKD së bashku me KRIIK - Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara; Institutin Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve; Shoqatën për Gratë dhe Fëmijët, Qendra Kombinuar; etj. iniciuan dhe drejtuan për më shumë se

një dekadë Koalicionin e Vëzhguesve Vendore (KVV), duke sjellë një risi në fuqizimin e zërit të shoqërisë civile dhe duke u bërë një faktor i rëndësishëm në kontributin konkret për të rikthyer besimin e qytetarëve tek procesi zgjedhor, rëndësia e votës së tyre dhe tek institucionet që mirëadministrojnë votën e tyre.

SHKD ka krijuar një eksperiencë pozitive duke implementuar aktivitete në lidhje me Qeverisjen Vendore, duke rritur presionin e qytetarëve për të rritur transparencën e pushtetit vendor, si dhe për t'i ndërgjegjësuar qytetarët që të kërkojnë dhe të përdorin mekanizmat alternativë të demokracisë direkte në komunitetet e tyre, nëpërmjet peticioneve dhe referendumeve lokale.

Në vitin 1999, SHKD arriti një sukses të rëndësishëm me depozitimin e 66,668 firmave të qytetarëve të mbledhura në dy javë, për Ratifikimin e Kartës së Autonomisë Lokale. Kjo ishte një fitore e rëndësishme për shoqërinë civile, e cila vërtetoi fuqinë dhe ndikimin e saj në proceset demokratike të vendit. Me konsolidimin dhe standartizimin e proceseve zgjedhore, koncepti i korrupsionit zgjedhor është plotësuar akoma më shumë.

Praktikat e mira të Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Prej vitit 1996 dhe në vazhdim, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka monitoruar periodikisht proceset zgjedhore në vendin tonë, qofshin ato parlamentare apo për organet e qeverisjes vendore. Rekomandimet e adresuara nga ana e KShH-së ndaj subjekteve politike, administratës zgjedhore, organeve të sistemit të drejtësisë dhe atyre ligjzbatuese, si dhe pushtetit legjislativ e atij ekzekutiv, janë cituar edhe në vetë raportet e OSBE/ODIHR, si dhe në opinionet e lëshuara nga ana e Komisionit të Venecias. Këto rekomandime i kanë shërbyer realizimit të proceseve të drejta, meritokratike dhe të lira. Një kontribut të rëndësishëm në procesin e monitorimit të zgjedhjeve, kanë ofruar 8 korrespondentët e angazhuar në 8 qarqe të ndryshme të vendit, si: Fier, Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Kukës.

Praktikat e mira të OShC-ve që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar

Që prej vitit 2003, OShC-të e fushës së aftësisë së kufizuar janë përfshirë në mënyrë konstante në rekomandime për ndryshime e për rrjedhojë ndryshime të qënësishme në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ndryshime këto të lidhura me sigurimin e aksesit në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara.

FSHDPAK, përmes një procesi të gjatë advokimi, mundësoi për herë të parë në vitin 2003, përfshirjen në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë të së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për të votuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, të fshehtë dhe të barabartë, përmes informimit e komunikimit të aksesueshëm përpara zgjedhjeve, krijimit të kushteve të aksesueshmërisë në mjedise brenda e jashtë qendrës së votimit, si edhe në ofrimin e materialeve zgjedhore të aksesueshme në përputhje me kategorinë e aftësisë së kufizuar. FSHDPAK ka monitoruar në vijimësi proceset zgjedhore nën këndvështrimin e përfshirjes në to të personave me aftësi të kufizuara, duke përgatitur raporte monitorimi, të cilat kanë shërbyer si evidencë për ndryshime e rishikime të ligjit dhe praktikave operacionale.

Rezultati

Organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e të gjitha proceseve zgjedhore në vend pas vitit 1990, përfshirë zgjedhjet lokale, parlamentare si dhe dy referendume që janë mbajtur, duke angazhuar me mijëra vëzhgues të pavarur në gjithë vendin. Në kuadër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë është koordinuar dhe implementuar aksioni me i madh i monitorimit në Shqipëri, duke angazhuar e trajnuar mbi 3000 vëzhgues të pavarur.

Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu kanë qenë pjesë aktive e konsultimit dhe diskutimit publik dhe me institucionet e partitë politike, në lidhje me domosdoshmërinë për kryerjen e reformës zgjedhore. Disa ndër rekomandime që kanë gjetur zbatim ndër vite janë: ndryshimi i Kodit Zgjedhor në lidhje me votën e shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit shqiptar; përdorimi i teknologjisë në nivel kombëtar; vendosja e listave të hapura për kandidatët në të gjitha proceset zgjedhore; vendosja e mekanizmave dhe përmiresimi i formularëve të deklarimit e shpenzimeve të partive politike në fushatën zgjedhore për të rritur transparencën e financimit të partive politike në zgjedhje; legjitimimi i aktorëve të shoqërisë civile në procesin e ankimimit në strukturat e reja të KQZ-së dhe në Gjykatën Kushtetuese, etj.

ULJA E KORRUPSIONIT DHE RRIJTJA E TRANSPARENCËS NË SEKTORIN PRIVAT – KRIJIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR) DHE QENDRËS KOMBËTARE TË LICENSIMIT (QKL) TË BIZNESIT

Në vitin 2006, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nisi një nismë transformuese të njohur si Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit. Kjo iniciativë kishte për qëllim zvogëlimin e korrupsionit dhe përmirësimin e transparencës dhe performancës në tre fusha kyçe të administratës publike: 1) Administrata tatimore 2) Prokurimi publik 3) Regjistrimi i biznesit. Nisma adresoi mungesën e transparencës dhe përfshirjes së publikut në procesin e monitorimit, në një qasje të dyfishtë që përfshin reformën e procesit përmes përmirësimeve ligjore dhe zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit, si dhe një fushatë të gjerë ndërgjegjësuere për publikun në shkallë kombëtare për të promovuar rolin e shoqërisë civile në procesin e monitorimit dhe kontrollit të qeverisë.

Krijimi i QKR dhe QKL

Përgjatë viteve 2006-2008, u krijuan disa sisteme novatore të e-qeverisjes, duke përfshirë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një pikë e vetme e regjistrimit të biznesit; një sistem e-prokurimi efikas; si dhe shërbime të lehtësuara tatimore përmes e-shërbime. Duke ndërtuar mbi këtë përparim, vazhdoi puna e nisur në disa drejtime në lidhje me:

Administrimin e Taksave: U realizua rristurimi dhe modernizimi i administratës tatimore me synimin për të përhapur shërbimet si e-taksa, kryerjen e auditimit tatimor bazuar në analizën e risqeve, fuqizimin e koleksionimit, procesimit, si dhe funksionet hetimore të brendshme anti-kriminale dhe anti-korrupsion, si dhe u krijuan strukturat e Avokatit të Tatimpaguesve dhe Këshillit Konsultativ për Taksat.

Licensimin e Biznesve: Në vazhdim të modelit të suksesshëm të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, u krijua dhe mbështet veprimtaria e Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) në Tiranë dhe qytetet e tjera, duke ofruar shërbime në one-stop-shop.

Planifikimi i Territorit: Bazuar në Ligjin “Për Planifikimin e Territorit” të prillit 2009, u themelua një Regjistër i Planifikimit të Territorit me qëllim rritjen e transparencës dhe zvogëlimin e mundësive për korrupsion në planifikim dhe proceset e dhënies së lejeve përmes aplikimit të aplikacioneve IT, të cilat u pilotuan gjithashtu në bashkitë Tiranë, Shkodër, Fier, Vlorë, dhe Pogradec.

Angazhimi i sektorit privat dhe shoqërisë civile: Përmes asistencës që synoi rritjen e kapaciteteve, u mbështet angazhimi dhe kontributi i organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e reformave të mbështetura nga programi, në dhënien e rekomandimeve të tyre për ndryshimin e politikave, dhe në advokimin për përmirësimin e masave antikorruption.

Rezultati

Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA) ka luajtur një rol të rëndësishëm në projektimin dhe zbatimin e një sistemi të qëndrueshëm të Monitorimit dhe Vlerësimit si shtyllë kryesore në matjen e progresit dhe përmbushjes së objektivave të projektit Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit. Për më tepër, përfshirja e Institutit, përfshiu dhe realizimin e anketave të gjera me biznesin, të cilat luajtën një rol kyç në matjen e efikasitetit të ndërhyrjeve të projektit. Këto anketa jo vetëm që ofruan pikat kryesore të progresit, por gjithashtu shërbyen si një mekanizëm i rëndësishëm për të përfshirë në strategjinë e projektit qasjen e qytetarëve dhe bizneseve me të dhëna të përditësuara.

Dedikimi i IDRA ishte i dukshëm edhe në zhvillimin dhe realizimin e një programi interaktiv për trajnimin e stafit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ky program punoi për ngritjen e kapaciteteve të stafit të QKR duke i pajisur me aftësitë e nevojshme për të orientuar sistemet dhe teknologjitë e reja të vendosura.

NISMA PËR VLERËSIMIN E HAPËSIRAVE PËR KORRUPSION NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Vlerësimi i hapësirave për korrupsion, është analizimi dhe shqyrtimi i draft ligjeve dhe akteve nënligjore, duke evidentuar hapësirat dhe risqet potenciale që mund të sjellin korrupsion, pavarësisht nëse këto risqe kanë qenë të qëllimshme ose jo. Vlerësimi i hapësirave është i rëndësishëm për përmirësimin e procesit të hartimit të legjislacionit, nga njëra anë duke krijuar një formë presioni nga publiku dhe nga ana tjetër duke i shërbyer Parlamentit si burim referimi gjatë diskutimeve të projektligjeve.

Nisma për vlerësimin e hapësirave për korrupsion

Vlerësimi i Hapësirave për Korrupsion në Legjislacionin Shqiptar, është një nismë e Institutit për Zhvillim, Kërkim dhe Alternativa (IDRA) në kuadër të Programit Matra të Ambasadës Hollandeze. Qëllimi i përgjithshëm i nismës ishte prezantimi dhe implementimi i një sistemi për vlerësimin e hapësirave për korrupsion në legjislacionin shqiptar, për të gjithë projektligjet dhe aktet përpara miratimit të tyre në Parlament. Sistemi i vlerësimit të hapësirave për korrupsion analizoi draft ligjet dhe aktet normative, duke vendosur në dukje hapësirat dhe risqet potenciale që sjellin korrupsion, pavarësisht nëse këto risqe kanë qenë të qëllimshme ose jo. Teknika e vlerësimit të korrupsionit kishte për qëllim kryesisht mbylljen e hapësirave për korrupsion në legjislacionin e propozuar, duke u fokusuar në parandalimin e veprimeve korruptive të cilat mund të ishin rezultat i hartimit të keq të legjislacionit.

Praktika e vlerësimit të hapësirave për korrupsion synoi gjithashtu përmirësimin e procesit të hartimit të legjislacionit duke përjashtuar risqet si: zgjerimin e pushteteve diskrecionale prej dispozitave deleguese; parashikimin paralel të detyrave; vështirësitë në kuptimin dhe zbatimin e ligjeve të shpërndara; keqinterpretimin e dispozitave referuese të paqarta; pasigurinë e krijuar nga boshllëku legjislativ; lirinë e tepruar të veprimit tek zyrtarët për shkak të mungesës së paqartësisë në rregullat procedurale administrative; mungesën dhe pamjaftueshmërinë e mekanizmave mbikqyrës dhe atyre ku ushtrohet e drejta e ankimit kundër vendimeve dhe veprimeve të autoriteve publike, etj.

Rezultati

Në kuadër të nismës u vlerësuan nga ekipi i ekspertëve ligjorë 64 akte ligjore, ndër të cilat 27 (njëzet e shtatë) ishin projektligje dhe projektvendime, ku 7 prej tyre u miratuan në parlament deri në momentin e gjurmimit të akteve, në shtator 2017. Pjesa tjetër ishte në proces shqyrtimi dhe miratimi. Instituti për Zhvillim, Kërkim dhe Alternativa (IDRA) për të matur ndikimin e projektit të evidentimit të korrupsionit në legjislacionin shqiptar ka gjurmuar me kujdes miratimin e akteve. Ky gjurmim konsistoi në vlerësimin nëse rekomandimet e dhëna nga ekspertët u morrën ose jo në konsideratë. Nga vlerësimi rezultoi se për rekomandimet e sugjeruara nga ekspertët për shtatë akte, nga 23 rekomandime në total, për këto akte ligjore, 18 janë marrë në konsideratë dhe janë pranuar ndërsa 5 nuk janë pranuar.

REDUKTIMI I KORRUPSIONIT PËRMES LIGJIT “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”

Miratimi i nismës ligjvënëse “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” erdhi në kuadër të zhvillimit të legjislacionit në vend lidhur me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat. Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” ka për qëllim parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat, nxitjen e sinjalizimit të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit si dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë këto praktika.

Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregullator

Në vijim të aprovimit të ligjit në 2016, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të Programit Matra të Ambasadës Hollandeze, punoi për të zhvilluar kuadrin nënligjor në mbështetje të zbatimit të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, kuadrin rregullator për zbatimin e ligjit, fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij si dhe për të zhvilluar një fushatë të gjerë për informimin e publikut.

Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me ekspertë vendas e ndërkombëtarë, lehtësoi procesin për hartimin e akteve nënligjore dhe rregullatore, përmes një procesi të gjerë konsultimi publik, si rezultat i të cilit u mblodhën mendime nga të gjithë aktorët dhe grupet e interesit për përmirësimin e mekanizmave ligjorë e masave politike-bërëse në zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit, si dhe fuqizimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtyre mekanizmave.

Rreth 2000 institucione publike në nivel qendror, agjenci qeveritare, bashki, biznese, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, donatorë dhe agjenci zhvillimi ndërkombëtare në Shqipëri u bënë pjesë e procesit të konsultimit. PSH organizoi takime konsultuese rajonale në qytetet kryesore të vendit si Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Fier, me pjesëmarrjen e rreth 250 përfaqësuesve të sektorit publik dhe privat, shoqërisë civile dhe medias.

Informimi i institucioneve dhe mbarë publikut

Në vijim të zhvillimit të kuadrit ligjor, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi këtë legjislacion të ri, Partnerët Shqipëri zhvilloi një fushatë të gjerë të informimit publik nëpërmjet medias vizive, të shkruar, si dhe mediave sociale, e shoqëruar me elementë vizualë në qytet. Kjo fushatë mediatike ndërgjegjëse u konsiderua shumë e rëndësishme për një informim sa më të gjerë të publikut mbi mënyrën e raportimit dhe mbrojtjes që kuadri ligjor sjell për sinjalizuesit.

Rritja e kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e ligjit

Partnerët Shqipëri me ekspertët dhe institucionet partnere, punoi për ngritjen e kapaciteteve të stafit të ILDKPKI, si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit, si dhe asistoi ILDKPKI në përgatitjen e formateve të raportimit të sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm, regjistrave të sinjalizimit, formateve të raportimit etj. Një komponent tjetër i rëndësishëm i kësaj iniciative përfshirja e modulit të trajnimit mbi ligjin “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” në kurrikulën e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Në bashkëpunim me ASPA u trajnuan përfaqësuesit e njësive përgjegjëse për sinjalizimin në institucionet e administratës publike me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre në zbatimin e këtij ligji.

Rezultati

Miratimi i ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” përbën një zhvillim të rëndësishëm në legjislacionin shqiptar për parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat. Ligji parashikon një sërë garancish që mbrojnë individët që sinjalizojnë veprimet apo praktikën e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës, si dhe detyrimet e autoriteteve publike e të subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Miratimi i mekanizmit të sinjalizimit është vlerësuar dhe mirëpritur nga Komisioni Evropian dhe institucione të tjera ndërkombëtare si një çështje kyçe në legjislacionin kundër korrupsionit në përmbushje dhe të rekomandimeve të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Deri më 2021, raportohen 889 njësi përgjegjëse të ngritura për zbatimin e ligjit në mbarë vendin nga ku 362 në institucionet publike dhe 527 në sektorin privat. Numri i raportimeve të sinjalizimeve edhe pse ende në nivele të ulta vazhdon të jetë prezent çdo vit.

1.3 Pjesëmarrja në politikëbërje dhe procese vendimmarrëse

PËR NJË SHOQËRI CIVILE MË TË ZHVILLUAR, MË AKTIVE DHE TË QËNDRUESHME

Krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile është një nga parakushtet për zhvillimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Për të pasur një shoqëri të fortë dhe të qëndrueshme, është e rëndësishme që të mbështetet dhe të zhvillohet mjedisi në të cilin vepron shoqëria civile. Kjo do të krijonte kushtet e nevojshme për angazhim qytetar dhe për të adresuar sfidat në zhvillimin politik, social, ekonomik të vendit.

Krijimi i një mjedisi mundësues për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë civile

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, ka luajtur një rol kyç në nxitjen e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile në Shqipëri. Që prej themelimit në 2001, Partnerët Shqipëri ka shërbyer si qendër burimore për sektorin e shoqërisë civile, e fokusuar vazhdimisht në ofrimin e mbështetjes për organizatat e shoqërisë civile dhe nxitjen e bashkëpunimit brenda sektorit për krijimin e një mjedisi më mundësues.

Roli dhe kontributi kryesor i PSh në këtë drejtim ka qenë: (I) Zhvillimi i një mjedisi mundësues për avancimin e sektorit të shoqërisë civile, përmes kërkimit, monitorimit, udhëheqjes dhe lehtësimit të debatit në sektor dhe dialogut ndërsektorial, për zhvillimin e politikave në mbështetje të sektorit bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare; (II) Prezantimi i praktikave novatore që ndikojnë në zhvillimin e sektorit, rrisin qëndrueshmërinë e tij dhe rolin në sjelljen e ndryshimeve sociale në dobi të publikut/grupeve në nevojë; (III) Forcimi i OSHC-ve në zhvillimin e standardeve të performancës dhe rritjen e besueshmërisë, transparencës dhe imazhit publik të sektorit, në forcimin e demokracisë, zhvillimin e vendit dhe integrimin e tij në BE; (IV) Forcimi i lidershit të OSHC-ve dhe komuniteteve lokale (grupe lokale dhe individë), drejt një shoqërie civile më aktive dhe të qëndrueshme, me ndikim të rëndësishëm në forcimin e demokracisë.

Nga viti 2019, Partnerët Shqipëri po luan rolin e saj mbështetës për sektorin në mënyrë më të strukturuar dhe të organizuar, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri - një platformë informacioni dhe ofrimi shërbimesh që kontribuon në forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për të qenë aktorë më efektivë, transparentë, të përgjegjshëm

dhe të pavarur dhe në krijimin e një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile, demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimi Europian.

Partnerët Shqipëri ndër vite ka qenë ofuesi më i madh i trajnimit dhe asistencës teknike për sektorin jofitimprurës. Që nga viti 2001, janë ofruar mbi 5,000 ditë trajnime për mbi 26,000 përfitues, vendas dhe ndërkombëtarë. Programet e ngritjes së kapaciteteve, veçanërisht në pesë vitet e fundit, janë kanalizuar përmes Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile. PSh ka lehtësuar gjithashtu procese të ndryshme konsultimi për organizatat ndërkombëtare, duke kontribuar në reforma të rëndësishme dhe dokumente strategjike për Shqipërinë.

Si një organizatë nismëtare dhe lehtësuese e nismave advokuese në sektor, PSh ka kontribuar ndjeshëm në dialogun midis sektorit jofitimprurës dhe institucioneve qeveritare. Kjo përfshin influencën e iniciativave ligjore dhe dokumenteve strategjike vendimtare për sektorin e shoqërisë civile, si ligjet e ndryshme për organizatat jofitimprurëse, rimbursimin e TVSH-së për organizatat jofitimprurëse, prokurimet publike, vullnetarizmin etj. PSh ka luajtur gjithashtu një rol kyç në hartimin e kuadrit ligjor për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).

Për më shumë se një vit, përgjatë 2020 - 2021, PSh inicioi dhe lehtësoi përpjekjen advokuese të sektorit për përmirësimin e draft ligjit "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". Kjo nismë e qeverisë erdhi si një përpjekje për të adresuar një nga rekomandimet e MONEYVAL. Procesi i kësaj nisme ligjore u shoqërua me një debat të ashpër mes sektorit jofitimprurës nga njëra anë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Parlamentit nga ana tjetër. Kritikën nga sektori jofitimprurës kanë qenë të dyfishta. Së pari, lidhur me procesin e konsultimit dhe transparencës së tij, veçanërisht nga qeveria, dhe së dyti lidhur me përmbajtjen e këtij ligji. Si rezultat i mobilizimit të gjerë të sektorit jofitimprurës të drejtuar nga Partnerët Shqipëri dhe analizave ligjore dhe propozimeve të paraqitura, 32 nene të projektligjit u ndryshuan, me ndryshimin kryesor në ushtrimin e të drejtës së shoqatave pa detyrimin për të qenë të regjistruara.

Që prej vitit 2020, Partnerët Shqipëri ka ndërmarrë një seri iniciativash në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit për OJF-të, duke fuqizuar OSHC-të që të angazhohen në mënyrë proaktive në një mjedis ligjor të favorshëm në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit. Nismat kanë konsistuar në hartimin dhe analizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në vend për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, si dhe hartimin e një fushate edukative dhe sensibilizuese për sektorin për këtë çështje. Për më tepër, si pjesë e këtyre nismave janë organizuar tryeza të ndryshme kombëtare dhe rajonale, me aktorë kryesorë

relevantë, duke advokuar për një mjedis ligjor të përshtatshëm për veprimtarinë e OSHC-ve në vend. Në vitin 2022, Partnerët Shqipëri publikoi Metodologjinë e parë të Vlerësimit të Rrezikut të Financimit të Terrorizmit për Sektorin e OJF-ve në Shqipëri. Raporti, i përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përputhet ngushtë me kërkesat dhe udhëzimet e FATF dhe siç rekomandon udhëzimi i FATF, ai përgatitet përmes një qasjeje bashkëpunuese që përfshin OSHC-të, institucionet shtetërore dhe ligjzbatuese, sektorin financiar, dhe komunitetet fetare, duke njohur interesin e përbashkët për të luftuar rrezikun e financimit të terrorizmit (FT), nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në Organin Mbikëqyrës të Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve.

Me iniciativën e Partnerëve Shqipëri, pas një procesi aktiv gati dy vjeçar konsultimi dhe bashkëpunimi midis organizatave të shoqërisë civile në të gjithë vendin, në vitin 2021 u lançua Kodi i Standardeve të OJF-ve në Shqipëri. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, që luan dhe rolin e sekretariatit të Kodit, promovon Kodin e Standardeve dhe lehtëson zbatimin e tij në Shqipëri. Kodi prezanton një mekanizëm vetërregullues për sektorin, duke synuar vendosjen e një standardi të përbashkët të dakorduar për veprimtarinë e sektorit, përtej detyrimeve ligjore, për të udhëhequr OSHC-të drejt përmirësimit të transparencës dhe efektivitetit të punës së tyre, si dhe rritjes së besimit publik.

Rezultati

Nëpërmjet iniciativave të advokimit dhe përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve, Partnerët Shqipëri ka kontribuar në rritjen e organizatave të shoqërisë civile, ka promovuar angazhimin demokratik dhe ka lehtësuar bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe institucioneve qeverisëse. Puna e saj në advokimin e politikave, mobilizimin e burimeve dhe forcimin e kuadrit ligjor ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë pjesëmarrëse, duke fuqizuar kështu shoqërinë civile për të trajtuar në mënyrë efektive sfidat shoqërore dhe për të promovuar ndryshime pozitive në Shqipëri.

Nëpërmjet kërkimit, analizës së politikave dhe nismave avokuese, Partnerët Shqipëri ka punuar për të përmirësuar mjedisin ligjor duke propozuar reforma që përmirësojnë trajtimin fiskal të OJF-ve, thjeshtojnë procedurat e regjistrimit, reduktojnë pengesat burokratike, dhe sigurojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të OSHC-ve; garantojnë dhe lehtësojnë përfshirjen e shoqërisë civile në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse etj.

PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE GRUPEVE TË INTERESIT NË REFORMËN ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE TË VENDIT

Viti 2014 shënoi lançimin e një prej reformave më të rëndësishme në vend, Reformës Administrative Territoriale (TAR). Qëllimi kryesor ishte rritja e efikasitetit të njësive vendore, në kosto më të ulëta, më të afta për të ofruar shërbime më të mira dhe për t'u dhënë qytetarëve dhe komuniteteve më shumë akses në këto shërbime. TAR synonte demokratizimin dhe forcimin e mëtejshëm të qeverisjes në territor dhe nxitjen e efikasitetit ekonomik nëpërmjet një planifikimi të integruar në një territor më të konsoliduar. Në këtë kuadër qeveria shqiptare me ndihmën e donatorëve, inicioi një proces të gjerë konsultimi për të krijuar një platformë të strukturuar për mbledhjen e opinionit të qytetarëve në lidhje me reformën territoriale të propozuar.

Konsultimi publik për Reformën Administrative Territoriale (TAR)

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) dhe Instituti i Politikave Publike dhe Private, në kuadër të projektit për Mbështetjen e Reformës Administrative Territoriale – STAR, mbështetur nga komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë në Shqipëri (Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Programi i Zhvillimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) si dhe nga donatorët dhe organizatat si Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Këshilli i Evropës (CoE), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)), organizuan një proces të gjerë konsultimi në gjithë territorin e vendit me qëllim mbledhjen e opinioneve dhe rekomandimeve mbi ndarjen e re administrative-territoriale.

Në 12 qarqet e vendit u organizuan 36 takime konsultuese me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe përfaqësuesve të grupeve të interesit në Fier, Sarandë, Lushnjë, Vlorë, Ballsh, Himarë, Berat, Kuçovë, Skrapar, Tepelenë, Gjirokastrë, Përmet, Shkodër, Kukës, Lezhë, Korçë, Elbasan, Tiranë, Durrës, Dibër etj.

Rreth 2000 përfaqësues të organizatave lokale, bizneseve, universiteteve, shkollave profesionale, medias lokale, të rinj e qytetarë aktivë, u bënë pjesë e procesit konsultues paraprak dhe dhanë

opinionet e tyre mbi reformën dhe modelet e propozuara. Opinionet dhe rekomandimet e mbledhura në përfundim të procesit, iu përcollën qeverisë dhe institucioneve ndërkombëtare të përfshirë në proces.

Zëri i Qytetarëve për Reformën Administrative Territoriale

Një tjetër nismë në kuadër të TAR inicuar nga qeveria shqiptare me mbështetjen financiare të Projektit STAR dhe zbatuar nga IDRA ishte “Anketa e Zërit të Qytetarëve”. Me qëllim përfshirjen e zërit të qytetarëve si dhe në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, nëpërmjet një pyetësori të strukturuar u mor mendimi i rreth 16.000 qytetarëve në moshë madhore (18 vjeç e sipër) të ndarë sipas kampioneve të zonave funksionale nga variantet e propozuara, nëse ishin mbështetës të hartës territoriale me 39, 47 bashki apo 61 Bashki. Raporti me gjetjet kryesore iu prezantua Kuvendit të Shqipërisë përpara miratimit të reformës territoriale.

Në prezantimin e raportit përpara Kuvendit të Shqipërisë dhe në mbledhjen e shqyrtimit të Reformës Territoriale, në Komisionin e Reformës Territoriale, u prezantuan para komisionit gjetjet e raportit për secilin prej versioneve të propozuara dhe u rekomandua përfshirja e shoqërisë civile dhe mekanizmave të saj lidhur me ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për reformën territoriale.

Rezultati

Zbatimi i TAR solli një riorganizim të njësive administrative vendore duke e çuar numrin e tyre në 61 bashki. Si rezultat i një procesi të gjerë konsultimi në të gjithë vendin, qytetarët dhe grupet e interesit patën mundësi të përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në proces dhe të shprehin opinionet lidhur me reformën.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR ANGAZHIM DHE KONSULTIM PUBLIK

Konsultimi dhe angazhimi efektiv publik, përveçse detyrim ligjor i Njësive të Qeverisjes Vendore, është një proces i rëndësishëm që kontribuon në një qeverisje vendore të mirë dhe të qëndrueshme.

Konsultimi publik në strukturat e vetëqeverisjes vendore

Përgjatë 2014 – 2017, legjislacioni mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar në vendimmarrjen e strukturave të vetëqeverisjes vendore pësoi ndryshime pozitive duke e bërë të detyrueshme për institucionet qeverisëse, pjesëmarrjen qytetare në konsultimin publik. Pavarësisht kësaj, zbatimi i legjislacionit rezultoi i vështirë dhe konfuz për administratën e institucioneve vendore. Legjislacioni i miratuar kishte nevojë për akte nënligjore shtesë të cilat të mund të saktësonin më tej aspekte si procedurat për zbatimin e ligjit, sanksionet në rast të moszbatimit rigoroz të tij, përcaktimin e institucioneve monitoruese dhe kontrolluese, etj. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi që Ligji duhet të vendoste Standardet minimale kombëtare të detyrueshme në lidhje me Konsultimin Publik.

Partnerët Shqipëri, në kuadër të projektit STAR2, gjatë vitit 2018 punuan për të vlerësuar situatën në vend në lidhje me pjesëmarrjen dhe konsultimin me publikun në nivel vendor, kuadrin ligjor dhe rregullator dhe praktikën në këtë drejtim. Sipas vlerësimit, struktura e koordinatorit për konsultimin publik mungonte në pjesën më të madhe të Bashkive. Po ashtu mungonin rregullore dhe praktika institucionale të zhvillimit të procesve konsultuese me qytetarët.

Për të ndihmuar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJQV) në përmirësimin e këtij procesi qeverisës në bashkitë përkatëse, Partnerët Shqipëri zhvilloi takime informuese në të gjitha bashkitë e vendit, mbi nevojën dhe detyrimin ligjor për vendosjen e koordinatorëve të konsultimit publik si dhe hartoi Manualin Udhëzues për Angazhimin dhe Konsultimin Publik. Manuali ofron informacion të detajuar rreth planifikimit, standardeve dhe metodave për organizimin e konsultimeve publike. Partnerët Shqipëri zhvilloi 12 tryeza të rrumbullakëta konsultuese për të diskutuar manualin me 61 bashkitë e vendit si dhe zhvilloi trajnime të dedikuara për Koordinatorët e Njoftimit dhe Konsultimit Publik që u vendosën në vijim të takimeve në secilën bashki.

Gjithashtu, Partnerët Shqipëri hartoi një sistem vlerësimi për t'u ardhur në ndihmë të gjitha njësisve të vetëqeverisjes vendore në punën e tyre në drejtim të angazhimit dhe konsultimit publik. Sistemi bazohet në matjen e disa standardeve lidhur me proceset konsultuese, të cilat u prezantuan si pjesë e 16 programeve rajonale të trajnimit me përfaqësues të 61 bashkive.

Rezultati

Si rezultat i kësaj nisme, 541 përfaqësues të administratës publike u përfshinë dhe angazhuan në takimet konsultuese dhe programin për rritjen e kapaciteve në zbatimin e legjislacionit për konsultimin publik, bazuar në nevojat e identifikuara. Në çdo Bashki të vendit u vendosën dhe publikuan Koordinatorët për Konsultimin publik. Gjithashtu, u hartua dhe u vendos në dispozicion të organeve të vetëqeverisjes vendore Manuali Udhëzues për Angazhimin dhe Konsultimin Publik, duke standardizuar kështu praktikën e konsultimit në rang vendi. Në bashkëpunim me ASPA moduli i trajnimit mbi "Angazhimi dhe konsultimi publik dhe sistemi i matjes dhe vlerësimit të proceseve konsultuese", u bë pjesë e kurrikulës së ASPAs duke kontribuar kështu në rritjen e njohurive dhe aftësimin e administratës vendore për zhvillimin e proceseve konsultuese si dhe për të rritur aftësitë në matjen dhe vlerësimin e proceseve të tilla me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre.

PLATFORMA MULTI-FUNKSIONALE NË MBËSHTETJE TË DEMOKRACISË NË NIVEL VENDOR

Platformat multi-funksionale janë esenciale për forcimin e demokracisë në nivel vendor pasi promovojnë transparencën dhe lehtësojnë pjesëmarrjen qytetare. Duke ofruar qasje të hapur ndaj informacionit dhe duke mundësuar një ndërveprim të shpejtë dhe efikas me administratën, ato ndihmojnë në rritjen e besimit ndaj institucioneve vendore. Këto mjete teknologjike lejojnë konsultime publike, diskutime dhe ndërveprime të tjera që thellojnë ndjenjën e përfshirjes dhe pjesëmarrjes, ndërsa edhe rrisin efikasitetin administrativ. Më tej, bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm bëhet më i lehtë, duke krijuar një ambient ku demokracia lokale mund të përmirësohet nëpërmjet një ndërveprimi të vazhdueshëm dhe konstruktiv me qytetarët.

PortaVendore.al

Një nga kontributet e shoqërisë civile në Shqipëri për demokracinë vendore janë edhe nismat e platformave të ndryshme që ofrojnë informacion të kuptueshëm dhe të thjeshtëzuar për qytetarët. Një prej këtyre rasteve të suksesshme është PortaVendore.al, një platformë online që shërben si qendër burimore për informacion në lidhje me qeverisjen vendore.

Platforma është nismë e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Lëviz Albania (LA), e realizuar me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

PortaVendore.al paraqet përgjegjësitë që kanë bashkitë, bazuar në funksionet e tyre dhe shërbimet administrative në nivel vendor, duke krijuar edhe kartela digjitale për shërbimet kryesore. Për më tepër, platforma sjell të dhëna të hapura mbi mënyrën e qeverisjes nga organet vendore, duke e bërë të mundur që qytetarët të kenë akses të lehtë dhe të shpejtë në informacionin e tyre.

Platforma ka kontribuar në krijimin e një mjedisi mundësues për demokracinë vendore duke vendosur në qendër të saj gazetarinë dhe aktivizmin në nivel vendor si dy motorrë që bëjnë të mundur adresimin e problematikave dhe nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies nga njësitë e qeverisjes vendore. PortaVendore.al është shndërruar në një pikë reference për të dhëna dhe informacione për demokracinë vendore.

Rezultati

Platforma online PortaVendore.al ka shërbyer si një librari virtuale informacioni, lehtësisht e aksesueshme dhe e kuptueshme nga qytetarët dhe gazetarët, duke ofruar informacion mbi përgjegjësitë dhe detyrat e pushtetit vendor, si dhe mekanizmat që ekzistojnë për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje lokale. Ajo ka qenë një hapësirë e rëndësishme për zhvillimin e një gazetarie konstruktive, e bazuar në të dhëna dhe evidenca për çështje me interes vendor. Për më tepër, platforma ka shërbyer si mundësi promovimi e lëvizjeve qytetare komunitare në funksion të demokracisë vendore, duke sjellë modele suksesi dhe mësimet të nxjerra nga praktika e tyre. Si një amplifikues i zërave qytetarë, PortaVendore.al ka ndihmuar në advokimin për çështje me rëndësi jetike për qytetarët. Në të njëjtën kohë, platforma funksionon si një databazë online me projektet dhe studimet e realizuara në lidhje me vetëqeverisjen vendore në Shqipëri.

KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILE PËR DEMOKRACINË DIGJITALE

Shoqëria civile dhe demokracia digjitale janë dy koncepte që janë duke marrë një rëndësi të shtuar në Shqipëri, sikurse në shumë vende të tjera. Ndërsa shoqëria civile është një forcë e rëndësishme që mbikqyr dhe nxit qeverisjen demokratike, demokracia digjitale ofron mjete dhe platforma që mund të ndihmojnë në forcimin e këtij roli. Me rritjen e përdorimit të teknologjisë dhe internetit në Shqipëri, demokracia digjitale është duke u kthyer në një mjet kryesor për pjesëmarrjen e qytetarëve. Platformat online lejojnë konsultime publike, votime, diskutime dhe ndërveprime të tjera midis qytetarëve dhe institucioneve publike. Kjo ofron një mundësi për pjesëmarrje më të gjerë dhe më të thellë në procesin demokratik.

Nismat e OShC-ve për demokracinë digjitale

Që nga viti 2015, Lëviz Albania (LA) është fokusuar në fuqizimin e aktorëve shoqërorë në nivel vendor për të mbështetur demokracinë, duke u mundësuar organizatave të shoqërisë civile, grupeve informale dhe individëve që të angazhohen dhe të marrin pjesë në proceset demokratike vendore, duke rritur kërkesën për transparencë, llogaridhënie dhe shërbime publike efektive. LA ka krijuar një rrjet partnerësh lokalë, ka bërë ndërhyrje të ndryshme dhe plotësuese të njëra tjetrës dhe ka pasur një shtrirje të gjerë gjeografike, duke grumbulluar njohuri për mekanizmat që formësojnë efektivitetin e mbështetjes së demokracisë dhe angazhimit qytetar në nivel vendor.

Grantmarrësit e LA (organizata, individë dhe grupe informale) janë mbështetur për të përdorur instrumentet digjitale për të nxitur demokracinë vendore, kryesisht përmes përdorimit të digjitalizimit për monitorimin e premtimeve zgjedhore apo shërbimeve të bashkisë, për të rritur transparencën dhe forcuar llogaridhënien. Këto instrumente janë përdorur edhe për të ndërgjegjësuar dhe aftësuar qytetarët, apo grupe të caktuara si të rinjtë, grupet e disavantazuara, për të qenë më aktivë dhe më pjesëmarrës, për të monitoruar dhe për të ndërvepruar me qeverisjen vendore.

Krijimi i platformave online për monitorim, transparencë, llogaridhënie dhe për ti dhënë zë qytetarëve ka qenë forma kryesore e përdorur. Megjithatë, sfida kryesore mbeten: së pari qëndrueshmëria financiare e këtyre platformave; së dyti, ndërlidhja e tyre me platforma ekzistuese të qeverisjes vendore apo shoqërisë civile; së treti, përdorueshmëria e tyre në masë nga qytetarët edhe përtej kohëzgjatjes së projektit që i ka ndërtuar; së katërti, kalimi nga monitorimi tek veprimi dhe krijimi i komuniteteve për angazhim dhe mobilizim.

Rezultati

Si rezultat i nismave të Lëviz Albania dhe përkrahjes së saj për aktorët e shoqërisë civile në nivel vendor, demokracia digjitale ka marrë një impuls të rëndësishëm në Shqipëri. Organizatat dhe individët kanë shfrytëzuar me sukses instrumentet digjitale për të monitoruar dhe promovuar transparencën dhe llogaridhënien në qeverisjen vendore. Krijimi i platformave online ka lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe ka rritur ndërgjegjësimin, veçanërisht ndër grupe të caktuara si të rinjtë dhe komunitetet e vogla lokale. Megjithatë, ky është vetëm fillimi dhe ka ende hapësirë që praktikatat e demokracisë digjitale të konsolidohen dhe të vendosen si prioritet për të ardhmen.

DEMOKRACIA SI PROCEDURË: PETICIONET

Demokracia si procedurë e thekson rëndësinë e mënyrave dhe mjeteve përmes të cilave qytetarët mund të marrin pjesë dhe të ndikojnë në vendimmarrje. Një nga mjetet klasike të përfshirjes së qytetarëve janë petitionet, të cilat ofrojnë një formë të drejtpërdrejtë të shprehjes së vullnetit publik dhe të kërkesave ndaj autoriteteve. Shoqëria civile, nga ana tjetër, luan një rol thelbësor në këtë kontekst, pasi ndihmon në nxitjen, organizimin dhe mbështetjen e këtyre iniciativave. Ajo funksionon si një urë midis qytetarëve dhe strukturave të qeverisjes, duke siguruar që zëri i publikut të dëgjohet dhe të merret parasysh. Më poshtë paraqiten disa raste konkrete nga nismat e Qëndresës Qytetare.

Nisma për Peticionet

Qëndresa Qytetare ka mbështetur qytetarët dhe grupet shoqërore në plotësimin e kërkesave të tyre nga njësitë e qeverisjes vendore përmes peticioneve fizike dhe online duke sjellë ndryshime konkrete në buxhetimin dhe planin e punës së njësive bashkiake përkatëse. Duke ndërthurur edukimin qytetar dhe demokratik dhe elementë të demokracisë digjitale, Qëndresa Qytetare ka arritur rezultate konkrete duke kontribuar edhe në përmirësimin e demokracisë vendore.

Është krijuar aplikacioni Qytetari IN si një platformë që mundësoi për herë të parë nënshkrimin elektronik për peticione dhe iniciativa, të cilat vijnë të njihen, priten, trajtohen dhe shpesh herë zgjidhen nga disa bashki të vendit. Një platformë e cila nuk i shërben vetëm qytetarëve për të adresuar çështje, por i shërben organizatave dhe grupeve të kanalizojnë në Këshilla Bashkiakë kauzat, si edhe bashkive për të identifikuar problematikat nëpërmjet demokracisë së drejtpërdrejtë. Kjo praktikë mundëson balancimin e pushtetit, në mungesë të një demokracie të shëndetshme përfaqësuese, përmes fuqizimit të demokracisë pjesëmarrëse duke aktivizuar e mobilizuar drejtpërdrejtë qytetarët për pjesëmarrje efektive në vendimmarrje.

Rezultati

Qëndresa Qytetare ka kontribuar në nxitjen e angazhimit qytetar në qeverisjen vendore përmes mbështetjes së peticioneve fizike dhe online, duke ndikuar kështu në buxhetet dhe planet e punës së njësive bashkiake. Aplikacioni Qytetari IN ka ofruar një mjet novator për nënshkrimin elektronik të peticioneve, duke lehtësuar ndërveprimin mes qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe këshillave bashkiakë. Kjo ka ndihmuar në fuqizimin e demokracisë pjesëmarrëse, duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse lokale.



II.

*OFRIMI I SHËRBIMEVE
PËR GRUPET NË NEVOJË
DHE SHOQËRINË*

MBROJTJA DHE RI-INTEGRIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Trafikimi i qenieve njerëzore si fenomen në shoqërinë shqiptare ka lindur pas përmbyesjes së sistemit në vitin 90-të. Shndërrimet e mëdha të karakterit politik dhe ekonomik të vendit, sollën si pasojë të menjëhershme edhe përballjen me disa dukuri të panjohura më parë.

Me fillimin e hapjes së kufijve por dhe me përballjen e shtetit shqiptar me disa ndryshime të karakterit ekonomik, politik dhe gjeografik, fenomeni i trafikimit njohu një lulëzim të menjëhershëm dhe erdhi duke u përhapur në masë.

Organizatat e shoqërisë civile përmes nismave të ndërmarra, kanë luajtur një rol thelbësor në mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri, e cila është e përfshirë si një vend prejardhjeje, tranziti dhe destinacioni për trafikimin e qenieve njerëzore.

Kontributi i Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti-Trafik

Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti-Trafik (KKSAT), që prej krijimit të tij në vitin 2007, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e qendrave për viktimat e trafikimit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri. Koalicioni përbëhet nga 3 Organizata: "Të Ndryshëm & Të Barabartë", Qendra Psiko – Sociale "VATRA" dhe "Tjetër Vizion", që përfaqësojnë edhe 3 qendrat për viktimat e trafikimit, si dhe Qendra Kombëtare për Pritjen e Viktimave të Trafikimit (QKPVT), një qendër shtetërore kjo në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Koalicioni ka luajtur një rol të rëndësishëm në përkrahjen e viktimave të trafikimit dhe ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të mbarë opinionit publik lidhur me këtë fenomen.

KKSAT ndër vite ka ofruar këshillim, ndihmë juridike dhe psikologjike, trajnim dhe asistencë sociale për viktimat e trafikimit, duke siguruar një qasje të integruar dhe të ndërlidhur në trajtimin e tyre nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet relevante shtetërore dhe lokale. Koalicioni ka bërë thirrje për ngritjen e një sistemi të qartë dhe të konsoliduar për identifikimin, trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në vend.

Koalicioni është përfshirë gjithashtu në hartimin dhe zbatimin e Strategjive dhe Planeve të Veprimit Anti-Trafikim ndër vite, duke bërë një raportim të rregullt pranë Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafikim (ZKKAT).

Krijimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për mbrojtjen e viktimave të trafikimit në vitin 2005 është një tjetër kontribut i rëndësishëm i këtij koalicioni, së bashku me kontributin për hartimin dhe miratimin e “Standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi” në vitin 2017.

Koalicioni ka ndihmuar në përmirësimin e legjislacionit anti-trafikim në Shqipëri dhe në krijimin e Programit të Riintegritimit për Viktimat e Trafikimit në Shqipëri nëpërmjet një modeli inovativ me tre faza. Ai është përfshirë gjithashtu në iniciativa advokimi me qeverinë shqiptare për mbështetjen financiare të shërbimeve për viktimat e trafikimit dhe fëmijët e tyre, duke arritur sigurimin e një pjese të financimit. Në vitin 2013, koalicioni ngriti Njësitë Lëvizëse pjesë e tre qendrave, për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit. Koalicioni gjithashtu ka qenë nismëtar për hartimin e një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, nismë e cila si rezultat i përpjekjeve advokuese është përfshirë si aktivitet në Planin Kombëtar të Veprimit 2021-2023.

Rezultati

Organizatave e shoqërisë civile kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri. Kontributi i organizatave në këtë drejtim është shumë dimensional duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi rreziqet dhe pasojat e trafikimit të njerëzve; ofrimin e shërbimeve esenciale për viktimat e trafikimit, duke përfshirë strehimin, shërbimet shëndetësore, këshillimin psikologjik dhe ligjor; si dhe mbështetjen për viktimat e trafikimit për të ndërtuar aftësi të reja profesionale e për tu integruar në tregun e punës. Organizatat gjithashtu kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve të forcave të rendit dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse, për të identifikuar dhe mbrojtur viktimat e trafikimit.

Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti-Trafik (KKSAT) ka patur një rol thelbësor në ngritjen dhe funksionimin e strehëzave dhe ofrimin e shërbimeve ndër vite për viktimat e trafikimit, hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive anti-trafikim, si dhe ngritjen e ndërgjegjësimit publik mbi fenomenin e trafikimit. Koalicioni ka ofruar këshillim, ndihmë juridike dhe trajnim për viktimat e trafikimit në mbarë vendin. KKSAT ka ndihmuar gjithashtu në krijimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit.

NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I QENDRAVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Shoqëria civile ka luajtur një rol kyç në modelimin e shërbimeve të reja mbrojtëse, ku disa prej tyre kanë patur në fokus themelimin e qendrave për mbrojtjen e fëmijëve, shërbime të punës në komunitet dhe edukim e ndërgjegjësim. Shoqëria civile ka kontribuar drejtëpërdrejtë në ngritjen e qendrave duke ofruar paketa shërbimesh direkte riintegruese dhe rehabilituese. Këto shërbime ndihmojnë fëmijët të përballojnë traumat dhe sfidat që kanë përjetuar dhe t'i përgatisin për një jetë më të mirë dhe më të sigurt. Shoqëria civile gjithashtu ka ndihmuar në përmirësimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve përmes monitorimit dhe vlerësimit të rregullt të shërbimeve të ofruara. Kjo ndihmon në garantimin e një standardi të lartë të shërbimeve dhe në adresimin e mungesave dhe sfidave që mund të shfaqen.

Praktika të mira të shoqërisë civile për qendrat për mbrojtjen e fëmijëve

Në vitin 2003 organizatat e shoqërisë civile si Save the Children në Shqipëri (SCiA), Terre des hommes (Tdh), FBSH-DN, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ), Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, ngritën qendra ditore për fëmijët në situatë rruge si modele shërbimesh për të ofruar një paketë të plotë ndërhyrjesh për fëmijët në situatë rruge si dhe fëmijë në situatë rreziku të lartë dhe që vijnë nga komunitete vulnerabël. Nje tjetër Qendër Ditore për fëmijët në situatë rruge bazuar në modelin e qendrave të Tiranës, u ngrit dhe në Bashkinë Shkodër, si një bashkëpunim midis SCiA dhe Bashkisë Shkodër në vitin 2012. Krijimi i rrjetit të qendrave për fëmijët në situatë rruge u pasua nga ngritja e një databaze të unifikuar për regjistrimin e fëmijëve të identifikuar, e mundësuar nga SCiA në 2014-2015. Ky model shërbimi u pasua me ngritjen e qendrave komunitare në disa bashki, të cilat u zhvilluan në modele më të konsoliduara duke i shërbyer disa kategorive vulnerabël, duke u shoqëruar dhe me miratimin e standardeve të shërbimeve për qendrat komunitare shumëdisiplinore, si iniciativë e Tdh.

Në vitin 2009, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile Tdh Shqipëri dhe Kosovë dhe SCiA realizoi marrëveshjen për fëmijët e mitur të pashoqëruar të cilët shfrytëzohen në pikat kufitare dhe në shtetet fqinje "Mario-Protection of Children on the Move", si modeli i parë i shkëmbimit të përvojës mes shteteve Shqipëri dhe Kosovë për ngritjen e një mekanizmi referimi për çdo rast të identifikuar. Ky bashkëpunim solli gjithashtu miratimin e Protokollit Shtesë "Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe për Përmirësimin

e Identifikimit, Njoftimit, Referimit dhe Kthimit Vullnetar të Ndihmuar të Viktimave, si dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, në veçanti të fëmijëve, në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar” dhe miratimi i Protokollit Shtesë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Malit të Zi “ Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën Kundër Trafikimit të Personave dhe për Përmirësimin e Identifikimit, Njoftimit Referimit dhe Kthimit Vullnetar të Ndihmuar të Viktimave, si dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”.

Në vitin 2010, UNICEF në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë pilotuan shërbimin e parë të emergjencës në Shqipëri, për fëmijët në rrezik të lartë dhe viktimat të abuzimit, neglizhimit, trafikimit, shfrytëzimit, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijë në situatë rruge, etj. Ky shërbim ofron mbrojtje emergjente për fëmijët 24 orë në 7 ditë të javës nga 72 orë deri në 11 ditë, dhe vazhdon të jetë shërbimi i vetëm në nivel kombëtar që i përgjigjet sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Nga viti 2011 deri më sot janë asistuar rreth 1200 fëmijë në rrezik të lartë. Në vitin 2021, Bashkia Durrës në bashkëpunim me organizatën World Vision ka ngritur qendrën e emergjencës për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe nëna me fëmijë, si një partneritet i mbështetur nga fondi social dhe duke ju referuar standardeve të shërbimeve të emergjencës të hartuara në përputhje me modelin e shërbimit kombëtar të emergjencës së Nisma ARSIS. Qendra e shërbimit emergjent për fëmijët shqiptar të riatdhesuar në Shqipëri është ngritur në vitin 2022 nga Fshatrat SOS në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

Qëllimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët është të ofrojnë mbështetje komplekse për fëmijët në nevojë për mbrojtje ose të vlerësuar në nivel të mesëm dhe të lartë rreziku, viktimat apo në rrezik për jetën. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve janë ngritur fillimisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe pastaj janë zhvilluar për të ofruar shërbime të specializuara për kategori të ndryshme të fëmijëve si fëmijët e shfrytëzuar, viktimat trafikimi, abuzimi, dhune, fëmijë në situatë rruge, etj.

Vitet e fundit ka patur shumë zhvillime përsa i përket kuadrit ligjor, politik dhe institucional për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Të gjitha këto reforma janë të orientuara sipas parimeve kryesore të theksuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe ato drejt përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale, arsim, punësim dhe jetë të pavarur. Organizatat e shoqërisë civile kanë ndërmarrë nisma për ngritjen e shërbimeve komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Rezultati

Këto modele shërbimesh janë replikuar edhe në bashki të tjera dhe janë plotësuar edhe me standarde dhe protokolle të miratuara nga MSHMS. Llojet e mbështetjes për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe në rrezik të lartë/apo të menjëhershëm janë mbështetje mjekësore, psiko-sociale, akomodim afat shkurtër, trajtim i traumave, këshillim, informim, parandalim, referim, raportim, lehtësim për menaxhim rasti, shërbime direkte për plotësimin e nevojave parësore si strehim, transport, medikamente, shërbim ligjor, etj. Këto shërbime në nivel lokal dhe kombëtar kanë mbështetur sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe kanë ofruar shërbime të specializuara, të sigurta dhe të standardizuara.

REDUKTIMI I DËMIT TEK PËRDORUESIT E DROGËS DHE PARANDALIMI I HIV/SIDA-S DHE SST-VE

Në vitet 90-të, me ndryshimet shoqërore dhe rritjen e trafikut si rrjedhojë e pozicionit të favorshëm gjeografik të vendit tonë mes lindjes e perëndimit, droga dhe përdorimi i saj kryesisht nga të rinjtë u kthye në një fenomen serioz, me pasojat të rënda sociale dhe ekonomike për shoqërinë shqiptare. Sipas një vlerësimi të fundit, në Shqipëri në vitin 2019 ka patur rreth 7000–8000 përdorues problematikë të drogës, ndërsa numri total i përdoruesve të të gjitha drogave tashmë vlerësohet rreth 90.000 persona. Kjo është një shifër e përafërt, bazuar në opinionin e ekspertëve në vend. Statistika të sakta për numrin e përdoruesve, ende nuk janë të disponueshme. Ndër drogat më të përdorura janë opiatet (kryesisht heroina), kokaina që ka njohur një rritje të konsiderueshme vitet e fundit dhe kanabisi, por ka dhe përdorim të substancave të reja psikoaktive që paraqesin një rrezik të shtuar, sidomos për të rinjtë.

Kontributi për reduktimin e dëmit dhe parandalimin e HIV/SIDA-s dhe SST-ve

Organizata Aksion Plus, që prej themelimit të saj në 1992 ka luajtur një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e shoqërisë, veçanërisht të të rinjve, mbi parandalimin e HIV/SIDA-s, Sëmundjeve Seksualisht të Transmetueshme (SST) dhe drogave e pasojave të përdorimit të tyre. Në vitin 1992 u organizua konferenca e parë kombëtare “A do të harrojë AIDS të vijë në Shqipëri?” në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, që prezantoi mbarë opinionin publik me HIV/SIDA-n

dhe nxiti ndërgjegjësimin e nevojës për marrjen e masave për parandalimin dhe trajtimin e saj. Në vitin 2000 Aksion Plus ngriti qendrën e parë të Zvogëlimit të Dëmit, një filozofi pragmatiste për përdoruesit e drogave. Më tej, në 2005-ën Aksion Plus prezantoi dhe Terapinë Mbajtëse me Metadon (TMM), një terapi shumë e dobishme për përdoruesit e opiateve, që ka ndihmuar në trajtimin dhe rehabilitimin e tyre (licensuar nga Ministria e Shëndetësisë). Ofrimi i terapisë dhe shërbimeve për përdoruesit e drogës nga Aksion Plus vazhdon që prej vitit 2005 (prej vitit 2007 e në vazhdim me mbështetje nga Fondi Global, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale). Në këtë drejtim, Aksion Plus gjithashtu ka ofruar shërbime në burgje dhe komisariate, duke u bërë një ndërmjetësues mes shtetit dhe përdoruesve. Aksion Plus ka marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin e Provës për shërbime ndaj të dënuarve. Qendrat e Terapisë Mbajtëse me Metadon, përveç atyre në Tiranë, janë hapur edhe në rrethe të ndryshme të Shqipërisë si Durrës, Vlorë, Korçë dhe Elbasan etj., duke u shërbyer rreth 980 klientëve ditorë, si dhe 120 personave që vuajnë dënimin në burgje (Institucionet e Ekzekutimit të Vendimit Penal - IEVP). Ky është një kontribut i rëndësishëm për rehabilitimin e përdoruesve të drogës dhe ndihmon në reduktimin e dëmit në shoqëri.

Qendrat e metadonit ofrojnë një shërbim miqësor, me prag të ulët dhe komunitar, që krijojnë një mjedis të duhur për klientët e terapisë me metadon, por dhe për prindërit apo familjarë të tyre që kanë nevojë për mbështetje dhe udhëzim për të kapërcyer pasojat e rënda që rrjedhin nga përdorimi afatgjatë i drogës.

Një pjesë shumë e rëndësishme e veprimtarisë së Aksion Plus që prej krijimit të tij është aktiviteti informues dhe ndërgjegjëses. Kështu që prej viteve 90, organizata vijon ndërmarrjen e nismave dhe zhvillimin e programeve për informim dhe edukim të të rinjve në shkolla dhe universitete apo edhe e të rinjve që nuk janë pjesë e sistemit arsimor, për parandalimin dhe sensibilizimin e tyre në lidhje me përdorimin e drogave dhe HIV/SIDA.

Gjithashtu, Aksion Plus ka ndërmarrë zhvillimin e të tjera nismave të rëndësishme në këtë drejtim si: bashkëpunimi me Shërbimin e Provës, ku përdoruesit e drogës që kishin kryer shkelje ligjore kryenin shërbime komunitare pranë organizatës në vend të dënimeve të llojeve të tjera; nisma "Bota e Ndryshimit", për rritjen e ndërgjegjësimin të të rinjve dhe të opinionit publik për përdorimin e drogës, dhe mbështetjen në rehabilitimin e ish-përdoruesve të drogës, etj. Në bashkërendim me partnerë dhe rrjete ndërkombëtare, Aksion Plus ka advokuar për kuadrin ligjor për drogën, që të mos jetë thjesht ndëshkues, por të promovojë përkrahje dhe një shëndet më të mirë psiko-fizik të personave që përdorin substanca të ndryshme.

Rezultati

Rezultat i drejtpërdrejtë i punës ndër dekada të Aksion Plus dhe bashkëpunimeve me organizata partnere në vend, donatorë dhe institucione shtetërore, është ngritja dhe funksionimi i qendrave të specializuara si: Qendra e Parë e Zvogëlimit të Dëmit në 2000, dhe në vazhdimësi në 2005 qendrat e terapisë me metadon në tetë rrethe të vendit dhe në Tiranë, që ofrojnë shërbime të specializuara për përdoruesit e drogës (trajnime, fokus grupe, këshillime nga mjeku dhe psikologu, testime për HIV dhe infeksione të tjera që transmetohen nga gjaku apo marrëdhëniet seksuale të pambrojtura, referime të rasteve në institucione të tjera) dhe ndihmojnë në zvogëlimin e dëmit si pasojë e përdorimit të drogës. Ngritja e qendrave dhe ofrimi i shërbimeve kanë ndikuar në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së personave që vuajnë nga sëmundjet që lidhen me përdorimin e drogës, dhe kanë ndihmuar në sensibilizimin e opinionit publik dhe ndërgjegjësimin e nevojës për masat e parandalimit dhe trajtimit të këtyre problemeve.

Aksion Plus ka dhënë një kontribut të çmuar për parandalimin e HIV/AIDS/SST në shkollat e mesme të Tiranës si dhe në rrethe, si dhe ka prezantuar për herë të parë në vitin 2000 nismën “Psikologu dhe punonjësi social në shkollat e mesme”. Nisma u përqafua nga institucionet dhe prej vitesh tashmë punonjësi social dhe psikologu janë pjesë e ekipit të shërbimeve psiko-sociale të çdo shkolle në mbarë vendin.

SHËRBIME SOCIALE TË INTEGRUARA PËR FAMILJEN

Shërbimet e integruara për familjet në nevojë, përfshijnë shërbime për arsimin e fëmijëve, shërbime për zhvillimin social të familjes, shërbime për lehtësimin e formimit profesional, shërbime për lehtësimin e punësimit dhe vetëpunësimit dhe shërbime që kanë të bëjnë me zhvillimin e komunitetit në përgjithësi. Shërbimet që ofrohen synojnë të nxisin pjesëmarrjen dhe të ndihmojnë zhvillimin social të familjes.

Praktikat e mira të shoqërisë civile

Prej vitesh, Organizata “Ndihmë për Fëmijët (NPF)” ofron shërbime për familjet në nevojë, mbi

bazën e filozofisë së menaxhimit të integruar të rastit. Shërbimet kanë fillësën në identifikimin e familjes ose individit në nevojë dhe i shoqërojnë ato deri në fuqizimin dhe zgjidhjen e problemit. Një familje më e fortë, do të thotë një shoqëri më e fortë dhe e konsoliduar.

Punonjësi social në bashki është një pikë kyçe në procesin e menaxhimit të integruar të rastit. Bashkëpunimi mes bashkisë dhe Zyrës së Punës duhet të jetë një proces i vazhdueshëm.

Punonjësi social në bashki ka detyrë ta ndjekë ecurinë e përfituesit në nevojë, edhe kur e referon atë në punësim ose formim profesional, psh. kur ai është është duke marrë një kurs dy javor, 'Smart Start' në Zyrën e Punës. Po ashtu, bashkëpunimi është një kusht themelor në marrëdhënien e krijuar me institucionet vendore të shërbimeve sociale. Shërbimet e organizatës ofrohen pranë komuniteteve në nevojë. Organizata ka ngritur gjithashtu një rrjet bashkëpunimi në zonat ku ofron shërbime me organizata Egjiptiane e Rome, OJF që punojnë për gratë, komunitetin e biznesit, biznese që janë të licensuara për të ofruar kurse profesionale, kjo pasi jo në çdo bashki ka ofrues publikë të këtij shërbimi. Në vit, janë 350 familje të shërbyera dhe rreth 1000 individë, anëtarë të familjeve të shërbyera.

Disa nga cilësitë që e bëjnë shërbimin efektiv në mbështetje të grupeve në nevojë janë: (i) fokusi tek familja; (ii) krijimi i modeleve dhe institucionalizimi i tij; (iii) koordinimi e bashkërendimi i punës si me institucione të shërbimeve shoqërore, ashtu edhe me ato të punësimit e formimit profesional; (iv) mbështetje afatgjatë e shërbimit.

Organizata SHKEJ gjithashtu, ka një eksperiencë të pasur dhe të gjatë në ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë. Përfitues kryesorë të këtyre shërbimeve janë fëmijët e të rinjtë në rrezik, si edhe familjet e tyre; individë që dalin nga skema e ndihmës ekonomike, anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, persona me vështirësi psiko sociale, të rinjtë në konflikt me ligjin të cilët kanë përfunduar periudhën e dënimit etj.

Shërbimi komunitar, që ofrohet përmes dy Qendrave Komunitare, targeton familje vulnerabël dhe në vështirësi të thella ekonomike/sociale (kryesisht të komunitetit Rom/Egjiptian), fëmijë/rinj në situatë rruge, fëmijë në risk të braktisjes së shkollës ose që e kanë braktisur, fëmijë jashtë sistemit të mbrojtjes sociale, të rinj në risk të përdorimit të substancave narkotike dhe sjelljeve të rrezikshme/antisociale, vajza që përfshihen në martesë të hershme, të rinj të cilët duan të ngrenë kompetenca dhe aftësi si dhe të sjellin ndryshim në aspektin social dhe ekonomik në komunitet. Përveç shërbimeve në komunitet, pranë familjes dhe në qendrat komunitare, SHKEJ ofron shërbime të këshillimit e nxitjes së punësimit, vetëpunësimit dhe formimit profesional.

Shërbimet e ofruara konsistojnë në:

1. Shërbime komunitare në qendër për fëmijë të moshës 3-14 vjeç, që përfshijnë aktivitete edukative si klasa për analfabetë, mbështetje shkollore, aktivitete paraprake për shkrim dhe lexim, paisje me mjetet e nevojshme shkollore, kujdes psikologjik, shëndetësor dhe higjienik, vakte të shëndetshme ushqimore, si dhe orientim, referim dhe mbështetje për regjistrime në kopshte, çerdhe dhe shkollë
2. Shërbime komunitare në qendër për të rinjtë 15-21 vjeç, si: aktivitete të ndryshme sociale dhe edukative, trajnime, ndihmë me materiale didaktike shkollore, regjistrim në kurse profesionale, orientim për punësim, aktiviteteve argëtuese jashtë ambienteve të qendrës, ndihmë të drejtëpërdrejtë në raste të veçanta, aktivitete artistike sipas talenteve dhe aftësive
3. Shërbime për familjet, si: orientimi, referim, këshillim dhe shoqërimi për punësim, kujdes shëndetësor, mbështetje për çështje administrative dhe ligjore, trajnime/sesione informimi për prindërimin pozitiv, si dhe ndihmë direkte në raste emergjente si: pagesë qeraje për një periudhë të caktuar kohe, pagesë ilaçesh, veshmbathje, ushqime, produkte higjienike, pagesa të ndryshme administrative/ligjore, këshillim ekonomik, mbështetje për ngritjen e iniciativave ekonomike.

Eksperiencia e gjatë prej 17 vitesh e SHKEJ në njohjen e komuniteteve vulnerabël dhe orientimin e nevojave të tyre, si dhe në ofrimin e shërbimeve direkte për të adresuar këto nevoja, përbën një ndër avantazhet e shërbimit. Shumëllojshmëria e shërbimeve direkte të ofruara dhe lehtësia e marrjes së shërbimeve nga përfituesit, janë elementët që e bëjnë më efektiv këtë shërbim dhe me ndikim të menjëhershëm.

SHËRBIME CILËSORE DHE TË ARRITSHME PËR ÇDO PERSON ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE PRINDËRIT E TYRE

Personat me aftësi të kufizuara janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të varfërisë dhe vulnerabilitetit përgjatë ciklit të jetës: (i) fëmijët me aftësi të kufizuara, kanë më pak akses në edukim cilësor dhe shërbime riaftësuese për moshën e tyre dhe janë më të riskuar të vendosen në institucione rezidenciale e të përjetojnë dhunë krahasuar me fëmijët e tjerë; (ii) personat me aftësi të kufizuara në moshë pune, kanë më pak mundësi të punësohen dhe mbeten të varur nga përfitimet në para të aftësisë së kufizuar; (iii) prevalenca e aftësisë së kufizuar tek personat

e moshuar, rritet me kalimin e moshës, çka sjell që ata të mbeten të disavantazhuar dhe shpesh të harruar të përfshihen në sistemet e mbrojtjes sociale; (iv) personat me aftësi të kufizuara kanë nevoja e kërkesa specifike për shërbime për shkak të aftësisë së kufizuar; (v) personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për teknologji e mjete ndihmëse të tipologjive të ndryshme, të cilat luajnë një rol të pazëvendësueshëm në mundësimin e lëvizjes, komunikimit dhe aksesit në informacion, duke bërë të mundur rritjen e autonomisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të dhe familjarët e tij; (vi) mungesa e shërbimeve të aksesueshme shton kostot e jetesës për personat me aftësi të kufizuara, krahasuar me ato të personave të tjerë.

Me qëllim që të adresohen rreziqet, barrierat, dhe pabarazitë, personat me aftësi të kufizuara duhen të kenë akses në programe që përmirësojnë aksesin në shërbime përgjatë ciklit të jetës, shërbime të cilat duhet të marrin në konsideratë diversitetin e kësaj popullate në terma të nivelit të dëmtimit e funksionimit, por edhe faktorëve që lidhen me moshën, gjininë, vendbanimin e etninë.

Që në vitet e para të tranzicionit, organizatat e sferës së aftësisë së kufizuar iniciuan ofrimin e modeleve të rëndësishme të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Edhe sot, ato vazhdojnë të jenë ofruesit më potencialë të tipologjive të ndryshme të shërbimeve për fëmijë e të rritur me aftësi të kufizuara.

Më poshtë, listohen disa nga modelet e mira të shërbimeve, të ofruara nga organizata të shoqërisë civile në Shqipëri.

Shërbimi i mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuar

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK) ofron shërbimin e karrigeve me rrota që prej vitit 1996 për personat me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin. Karriget me rrota janë përshtatur në punishten “Mirësia” në përputhje me vlerësimin individual të stafit të specializuar për çdo person që i nevojitet ky shërbim, duke respektuar standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Trajnimi për përdoruesit e karrigeve me rrota dhe familjarët e tyre është pjesë e këtij shërbimi. Stafi teknik ofron trajnim teorik dhe praktik për përdorimin dhe mirëmbajtjen e karrigeve me rrota. Karriget me rrota të reja, standarde për zonat urbane dhe rurale, ofrojnë mundësi më të mira për përshtatjen në bazë të specifikave fizike dhe shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara. FShDPAK ofron trajnime në të gjitha rajonet e vendit për administratorët shoqërorë, në bashkëpunim me Zyrat Rajonale

të Shërbimit Social Shtetëror, duke synuar që shërbimi i karrigeve me rrota të jetë pjesë e sistemit të shërbimeve që ofrohen nga strukturat shtetërore në të gjithë vendin.

Shërbimi i ofrimit të karrigeve me rrota fillon me një proces vlerësimi të detajuar të nevojave fizike, shëndetësore dhe mjedisit ku personat me aftësi të kufizuara jetojnë, në përputhje me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Kjo siguron përshtatjen e karrigës me rrota në përputhje me nevojat e secilit individ. Specialistët e certifikuar kryejnë procesin e vlerësimit në bashkëpunim me personin me aftësi të kufizuara dhe ofrojnë karrigen me rrota e përshtatur sipas nevojave të tyre.

Shërbimi përmban ofrimin e karriges së duhur me rrota, pas procesit të vlerësimit, duke përfshirë porosinë, montimin dhe përshtatjen nëse është e nevojshme. Trajnimi i përdoruesve dhe kujdestarëve të tyre është pjesë e shërbimit, duke ofruar informacion të nevojshëm për përdorimin dhe mirëmbajtjen e karriges me rrota, si dhe mbështetje teknike dhe klinike të vazhdueshme. Nëse nevojitet, përdoruesit do të referohen në shërbime të tjera për mbështetje shtesë.

Shërbimi i punësimit me mbështetje për personat me aftësi të kufizuara

FSHDPAK ofron shërbimin e Punësimit me Mbështetje që prej vitit 2010, i cili fokusohet tek personat me aftësi të kufizuara me qëllim të ofrimit të mbështetjes së nevojshme për t'u punësuar. Shërbimi përfshin:

- (i) Informim dhe trajnim për aftësitë për tregun e punës;
- (ii) Profilizim profesional dhe hartim i planeve individuale për punësim;
- (iii) Ndërmjetësim për formim profesional, punësim dhe sigurimin e vendit të punës;
- (iv) Informim, këshillim dhe trajnim për punëdhënësit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë këshillim mbi ofrimin e përshtatjes së arsyeshme në të gjitha fazat e punësimit;
- (v) Ndihmë dhe ndjekje gjatë fazës së punësimit, duke përfshirë mbështetje në fazën e hyrjes/ vendosjes në një pozicion pune, për zhvillimin profesional dhe integrimin personal;
- (vi) Këshillim dhe mbikqyrje afatgjatë, duke përfshirë monitorim dhe asistencë në situata konflikti etj.

Qendra burimore për aftësinë e kufizuar

Prej vitit 1996, “Qendra burimore për aftësinë e kufizuar” e FShDPAK, ofron informacion, orientim, këshillim për persona me aftësi të kufizuara e familjarë të tyre, organizata të njerëzve me aftësi të kufizuara dhe ofrues të shërbimeve. Këshillimi dhe orientimi drejt shërbimeve shoqërore, shëndetësore, arsimore etj., realizohet në përputhje me nevojat e përfituesve. FSHDPAK, ndër vite, ka përgatitur dhe publikuar nja gamë të gjerë materialesh informative në fushën e aftësisë së kufizuar, mbi 170 publikime të ndryshme, që nga fletë të thjeshta informative, udhëzues, manuale, vlerësime e studime, shumica e tyre në formate alternative, për të mundësuar informacionin për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. 1000 persona me aftësi të kufizuara janë përfshirë në shërbim në bashkitë Tiranë, Elbasan, Vlorë, Shkodër; 300 prej tyre janë punësuar në tregun e hapur të punës apo internshipe; 200 kanë përfituar formim profesional; 200 biznese janë informuar e ndërgjegjësuar.

Platforma pak.al

Një platformë online, <https://platforma-pak.al/>, për herë të parë, prej vitit 2020, ofron informacion të aksesueshëm e në formate alternative për personat me aftësi të kufizuara. Platforma është e organizuar në formën e një moduli trajnimi (E-Trajnim) dhe ka për qëllim rritjen e njohurive dhe të kapaciteteve të stafëve të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara, si dhe shoqërisë në tërësi mbi çështje të aftësisë së kufizuar dhe barazisë.

Pjesë e kësaj platforme, është edhe një bibliotekë online, e cila shërben si qendër burimore për legjislacionin dhe politikën mbi personat me aftësi të kufizuara.

Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar

Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (MEDPAK) e krijuar në vitin 1993 nga një grup prindërisht në Qytetin e Librazhdit vazhdon të punojë për ngritjen e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar. MEDPAK ofron shërbime për të rriturit ku jepet kujdes ditor dhe terapi për fëmijët (logopedi, fizioterapi dhe këshillim psiko-social) në disa bashki të vendit. Për të ofruar një shërbim sa më cilësor dhe sa më afër vendbanimeve për personat me aftësi të kufizuara, MEDPAK punon vazhdimisht për fuqizimin e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar për tu organizuar në shoqatë me qëllim që të llobojnë dhe advokojnë në grup për dhënie shërbimesh sa më dinjitoze dhe bazuar në standardet e

miratuara nga qeveria shqiptare. Qendrat e ngritura i mbajnë prindërit të informuar për çdo ndryshim ligjor dhe bashkëpunojnë me degën e shoqatës MEDPAK në bashkitë respektive, për të dhënë shërbime sa më të mira për çdo person me aftësi të kufizuara.

Në këto Qendra sot jepen shërbime për rreth 200 persona me aftësi të kufizuara, shumica fëmijë. Punohet me fëmijët me qëllim aftësimin e tyre që në fëmijërinë e hershme dhe për të patur një arsim cilësor të tyre dhe punësim të tyre në të ardhmen.

Gjithashtu dhënia e shërbimeve ka ndihmuar prindërit dhe familjet e personave me aftësi të kufizuara për të bërë një jetë më aktive në shoqëri. Puna me prindërit ka konsistuar në informimin e tyre për të drejtat që kanë personat me aftësi të kufizuara si dhe fuqizimin e tyre në grup për të advokuar e lobuar në nivel lokal. Kështu, MEDPAK numëron tani 9 degë të saj në 9 bashki ku ka punuar me projekte të ndryshme.

Shërbime të ndërhyrjes së hershme & terapi zhvillimi për persona me aftësi të kufizuara me sindromën Down dhe çrregullime të spektrit të autizmit

Down Syndrome Albania (DSA) ofron shërbime të ndërhyrjes së hershme dhe terapi të zhvillimit për persona me aftësi të kufizuara me sindromën down dhe çrregullime të spektrit të autizmit që prej vitit 2014. Shërbime ofrohen në mënyrë të specializuar në qendër nëpërmjet terapive të ndryshme ose në mjediset e shtëpisë së përfituesit. Shërbimi i specializuar përfshin terapi si: fizioterapi/ psikomotricitet, terapi zhvillimi, terapi logopedike dhe terapi me metoden ABA. Ky shërbim është me bazë sesiioni terapeutik. Pranë qendrës së shërbimeve PRO PAK në Tiranë, funksionon një ekip multidisciplinar specialistësh, i cili ofron vlerësimin fillestar të rastit dhe hartimin e planit të ndërhyrjes së rastit për një periudhë të caktuar kohore (9 muaj ose 1 vjeçare). Gjithashtu, ekipi ofron edhe konsulta të herëpashershme me familjet e fëmijëve përfitues të shërbimit si dhe sesione këshillimi individual dhe/ ose në grup për prindërit.

Numri i përfituesve është rreth 100 në vit, ku përfshihen fëmijë me aftësi të kufizuara dhe prindër apo familjarë të tyre. Shërbimet e ndërhyrjes së hershme dhe ofrimit të terapive të ndryshme pranë DSA synojnë fuqizimin e familjes, me qëllim që familja në vijimësi të mbështesë fëmijën në kontekste të ndryshme, brenda rutinave familjare. Nëpërmjet ndërhyrjeve terapeutike stafi mbështet fëmijën për të arritur statet e zhvillimit dhe të gjithëpërfshihet në kontekste të ndryshme. Gjithashtu, në varësi edhe të nevojave të fëmijës dhe familjes qendra ofron mbështetje edhe në mjedise të tjera si: çerdhe, kopësht dhe shkollë.

Shërbime të ndërhyrjes së hershme për fëmijët dhe të jetesës së pavarur për persona me aftësi të kufizuara intelektuale

Shoqata “Ndihamoni Jetën” ofron shërbimin e ndërhyrjes së hershme, një shërbim i ngritur dhe zbatuar prej vitit 2000. Shoqata ofron mundësinë për mbështetje dhe trajtim për fëmijët që shfaqin vështirësi në zhvillim dhe çrregullime të spektrit të autizmit. Programet terapeutike të ndërhyrjes dhe trajtimit të vështirësive, që shfaqin fëmijët përgjatë viteve të para të fëmijërisë, i përgjigjen nevojave të fëmijës dhe janë të planifikuara për t’u implementuar në mjedise natyrore, aty ku fëmija rritet dhe zhvillohet, siç janë: familja, institucionet e edukimit të hershëm, apo shërbimi në qendër që realizohet nën kujdesin e specialistëve të ekipit multidisiplinar, duke patur në qendër fëmijën.

Rreth 145 fëmijë me aftësi të kufizuara marrin shërbime çdo vit. Shërbimet e ndërhyrjes së hershme që ofrohen në ambjentet e qendrës përfshijnë: (i) vlerësimin psikosocial të fëmijës; (ii) konsulta, terapi të specializuara në bazë të nevojave si: terapi zhvillimi sipas Modelit të Ndërhyrjes së Hershme të Denverit, terapi logopedike, terapi në dhomë sensoriale, terapi grupi, mbështetje për prindërit, terapi familjeje, program mbështetës për fëmijën në institucionet e edukimit të hershëm, program mbështetës në familje dhe trajnim i prindërve se si ata të punojnë me fëmijën në ambientin familjar.

Prej vitit 2000, shoqata ofron gjithashtu shërbimin e Jetesës së Pavarur, filozofia e të cilit orientohet në pjesëmarrjen dhe përfshirjen e të rinjve me aftësi të kufizuara, mbi moshën 21 vjeç dhe synon trajnimin, nxitjen e integritimit social dhe gjithëpërfshirjen e tyre në kontekste normale të jetës, duke bashkëvepruar me botën përreth. Ekipi i përkushtuar dhe profesional, ofron shërbime për jetesë të pavarur mbi bazën e metodës multidisiplinare të shërbimit, jetesë në apartamente për jetesë të pavarur me mbështetje, dhe në zbatim të standardeve të përkujdesit shoqëror të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Bazuar në modelin e jetesës së pavarur, organizohet puna për të zbatuar strukturën e shërbimit të jetesës së pavarur në apartamente, të cilat janë përshtatur për t’u ofruar mundësinë 15 të rinjve me aftësi të kufizuara të jetojnë një jetë të pavarur me/pa mbështetje.

Qendër Ditore Komunitare

Fondacioni OAZ, ka ngritur dhe operon përmes qendrës ditore komunitare “Shpresa e Re”, një qendër kjo që ofron shërbime të specializuara dhe terapi të ndryshme për fëmijë e të rinj

me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e standardeve të tyre të jetesës. Qendra është e vetmja që ofron shërbime të tilla për këtë target grup në zonën Mat e Klos. Qendra është e hapur çdo ditë për përfituesit nga ora 07.30 deri në orën 15.00. Disa përfitues që jetojnë në fshatra largohen pas konsumimit të drekës, ndërsa disa të tjerë vijnë në qendër në kohën e drekës, pasi mbarojnë shkollën. Duke marrë në konsideratë kushtet e vështira ekonomike në të cilat jetojnë familjet e këtyre fëmijëve dhe të rinjve, përveç shërbimit psiko-social, përfituesve u ofrohet dreka dhe transporti pa pagesë, dhe u dërgohen pajisje ndihmëse në shtëpi, si karrige me rrota, materiale të ndryshme, të cilat prindërit mund t'i përdorin gjatë kohës që fëmijët janë në shtëpi, si edhe lojra me qëllime terapeutike. Një vëmendje e veçantë i kushtohet punës me prindërit e përfituesve, të cilët vijnë shpesh pranë qendrës dhe shohin se si punohet me fëmijët për ta vazhduar programin edhe në shtëpi në të njëjtën linjë më atë që zhvillohet në qendër, me qëllim ruajtjen apo rritjen e mëtejshme të aftësive të nevojshme e të domosdoshme për fëmijët e tyre. Si rezultat i ofrimit të këtij shërbimi 40 persona me aftësi të kufizuara dhe prindër e familjarë, përfitojnë çdo vit.

Shërbimi i protezimit, ortezimit, rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuara

Qendra Drita e Shpresës funksionon në Bashkinë Pogradec që prej vitit 1994. Qendra prodhon proteza për gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme, orteza për deformimin e këmbëve dhe shtyllës kurrizore. Po ashtu, shërbimet e qendrës janë të orientuara drejt rehabilitimit të personave që kanë bërë amputim, si edhe trajtim psikologjik për ta. Qendra e rehabilitimit ofron shërbimet e saj me kushte moderne dhe konform standardeve të Bashkimit Evropian.

Shtrirja gjeografike e shërbimit është në gjithë Shqipërinë, me përparësi në zonën e Pogradecit. Stafi i QDSH përbëhet nga 11 persona, të cilët janë të kualifikuar për fushat përkatëse. Pranë qendrës është ngritur dhe funksionon një ekip multidisciplinar. Të gjitha shërbimet që ofrohen në qendër, plotësojnë njëra – tjetrën, me synim final përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Numri i përfituesve nga shërbimet e qendrës është rreth 600 persona çdo vit.

Shtëpi familje rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike

Opera della Divina Provvidenza Madonnina del Grappa ofron shërbimin në Bashkinë Shkodër. Ky shërbim është ngritur si pjesë e procesit të deinstitutionalizimit në Shqipëri, si koncept i ri i mikpritjes për personat e braktisur dhe pa mbështetje, të ardhur nga institucionet

publike, duke i'u siguruar atyre një ambient të ngrohtë familjar. 18 personat, që përfitojnë nga shërbimi, janë përkatësisht të moshave 33-63 vjeç, ata kanë gjini, kushte personale, patologji të ndryshme, për të cilat është e nevojshme një vendosje ekstra familjare e ndryshme nga ajo e origjinës. Shërbimi ofron: plotësim të nevojave bazë (shtëpi-familje rezidenciale, në të cilën ofrohet akomodim, ushqim, kujdes shëndetësor, etj.) e mbështetje psiko – emocionale (terapi individuale dhe në grup, terapi konjitive dhe të sjelljes); garantim të sigurisë dhe mirëqënies - socializim dhe terapi profesionale; aktivitet në kohën e lirë, nëpërmjet programeve të përcaktuara nga grupi multidisiplinar në bashkëpunim me kujdestarët socialë; programim dhe realizim i pushimeve verore; mbajtja e kontaktit me familjet biologjike të përfituesve, për ata të cilët i kanë.

18 persona të rritur me aftësi të kufizuara jetojnë në mënyrë të pavarur në shtëpitë familje, të mbikqyrura nga staf i specializuar. Jeta në brendësi të strukturës është e organizuar si në çdo familje normale, duke plotësuar nevojat e gjithësecilit. Realizohen momente loje, argëtimi, aktivitete të ndryshme animacioni, pushime në mal dhe në det, shëtitje, përfshirje në jetën komunitare, kultivimin e interesave sipas kapacitetit dhe maturimit të gjithësecilit. Përfituesit nëpërmjet ergoterapisë, logopedisë dhe aktiviteteve të ndryshme të organizuara në strukturë, zhvillojnë kapacitetet specifike, instrumenta të cilat rrisin vlerësimin për veten.

Shërbim lëvizës në familje për fëmijët me aftësi të kufizuara

World Vision Albania ofron shërbimin “Tungjatjeta... Jetë”, një shërbim i specializuar lëvizës, i dizenuar që të arrijë fëmijën me aftësi të kufizuara në shtëpi, në zonat e thella rurale të Shqipërisë. Një Njësi Lëvizëse që ka në përbërjen e saj një ekip profesionistësh, i pajisur me aftësitë dhe infrastrukturën e nevojshme, ofron shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara në vendin ku ata jetojnë (shtëpi).

Shërbimi ofrohet bazuar në një Plan Zhvillimi Individual (PZHI). Paralelisht, prindi përfiton një herë në muaj një seancë këshillimi, duke synuar fuqizimin e mekanizmave në përballimin e situatës në të cilën gjendet. Zgjatja e shërbimit për fëmijën në familje është në varësi të minimizimit të barrierave që pengojnë zhvillimin e potencialit të fëmijës. Në vitin e fundit shërbimi në shtëpi është duke u integruar me shërbime në qendra ditore si në Librazhd dhe Lezhë dhe në Hapësirat Zhvillimore si në Prreras. Në kushtet e pandemisë Covid 19 shërbimi solli risi në ofrimin e ushtrimeve dhe këshillave online, bazuar në Planin e Zhvillimit Individual, dhe ndërkohë që Shqipëria po përshtatej me normalitetin e ri, ekipet lëvizëse praktikuan

modelin e “vizitës në oborr” për të vijuar me ofrimin e shërbimit në familje. Si rezultat i ofrimit të këtij shërbimi, 267 fëmijë me aftësi të kufizuara përfitojnë çdo vit.

Terapi zhvillimi për persona me aftësi të kufizuara

Qendra Jonathan ofron shërbime të fokusuara në terapitë e zhvillimit për persona me aftësi të kufizuara, shërbime të cilat filluan të aplikohen në vitin 2000. Numri i përfituesve ka ardhur duke u rritur vit pas viti, për të arritur në rreth 350 përfitues përgjatë vitit 2023.

Terapitë e ofruara nga Qendra Jonathan, i ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara përgjatë tërë jetës për të marrë pjesë në gjërat që ata duan dhe që ata të bëjnë çfarë duhet, përmes përdorimit terapeutik të aktiviteteve të përditshme (profesioneve). Ndërhyrjet e përbashkëta në terapi profesionale përfshijnë ndihmë dhe orientim për fëmijët me aftësi të kufizuara e familjarë të tyre, për të marrë pjesë plotësisht në shkolla dhe situata sociale.

Qendra Jonathan aplikon e përfshin në terapi sa më shumë aspekte të zhvillimit, si në aspektin mendor, ashtu edhe fizik. Specialistët e qendrës, aplikojnë artin, punën e dorës, kurse pavarësie etj., si komponentë të këshilluar dhe të provuar për t’u aplikuar me personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara.

Rezultati

Organizatat e shoqërisë civile të fushës së aftësisë së kufizuar kanë kontributin e tyre në ofrimin e një game të gjerë modelesh të shërbimeve për fëmijë e të rritur me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Shërbimet e ofruara prej tyre kanë mbushur hendekun e krijuar nga mungesa e zinxhirit të shërbimeve për këtë komunitet të ofruara nga pushteti qëndror dhe ai vendor. Ato kanë mundur përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe të familjarëve të tyre, duke synuar në rritjen e përfshirjes sociale dhe nxitjen e jetesës së pavarur.

2738 fëmijë e të rritur me aftësi të kufizuara përfitojnë çdo vit shërbime të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile të sipër cituara.

SHËRBIME REZIDENCIALE NË NDIHMË KOMUNITETIT LGBTI+

Në Shqipëri, të drejtat e njerëzve LGBTI+ janë sjellë në vëmendjen e publikut vetëm gjatë dekadës së fundit. Megjithëse kuadri ligjor ndalon diskriminimin ndaj personave lezbike, homoseksuale, biseksuale, transgjimore dhe ndër-seksuale (LGBTI+), paragjykimi dhe diskriminimi ndaj atyre me një seksualitet dhe / ose identitet gjinor të pakicave mbetet i përhapur në Shqipëri. Në përgjithësi, shërbimet sociale shqiptare në dispozicion për grupet në nevojë janë shumë të fragmentuara dhe të pastandardizuara, ka mungesë stafi të specializuar dhe institucionet kanë kapacitete të cunguara për të trajtuar nevojat e njerëzve LGBTI+.

Praktikat e mira të Qendrës “Streha”

“Streha” është qendra e parë rezidenciale në Shqipëri dhe në rajon që i vjen në ndihmë komunitetit LGBTI+ në raste emergjencash për sa i përket strehimit, por gjithashtu ofron shërbime të tjera për fuqizimin dhe integrimin e individëve LGBTI+. Ajo kontribuon në fuqizimin e individëve LGBTI+, kryesisht të rinj, përmes shërbimeve multidisiplinare dhe rezidenciale, ngritjes së kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve, ndërgjegjësimit dhe advokimit në mënyrë që të kapërcehen barrierat dhe vështirësitë e hasura në familje dhe shoqëri nga komuniteti LGBTI+. Grupi i synuar i qendrës janë anëtarët e komunitetit LGBTI+, kryesisht të rinj.

Fokusi kryesor i “Strehës” është fuqizimi dhe riintegrimi në shoqëri i të rinjve në rrezik brenda komunitetit LGBTI+ (mosha nga 18 në 29 vjeç). Shërbimi ofrohet në kryeqytetin e Shqipërisë, në Tiranë. Sidoqoftë, nuk është i kufizuar vetëm në vend dhe shpesh ofron shërbime strehimi për të rinjtë nga vendet e rajonit që flasin shqip si Kosova ose Maqedonia.

Puna dhe arritjet e “Streha” janë përqendruar si në ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta tek individët LGBTI+, ashtu edhe në kontributin në përmirësimin e sistemeve më të mëdha të mbrojtjes dhe avancimin e të drejtave të njerëzve LGBTI+ përmes advokimit dhe rritjes së aftësive të profesionistëve në kontakt me personat LGBTI+.

“Streha” ofron mbështetje përmes ofrimit të: Strehimit të sigurt dhe plotësimit të nevojave themelore; Këshillimit psiko-social individual dhe në grup; Ndihmës juridike; Shërbimeve shëndetësore (sesione edukative, analiza shëndetësore dhe shërbime dentare, ndërmjetësim për marrjen e kujdesit shëndetësor, mbështetje me ilaçe, etj.); Ndërmjetësimin në dobi të trajnimit

profesional; Trajnimit të aftësive për jetën; Ndërmjetësimit për punësim (vlerësimi i nevojave profesionale, hartimi i planit të punësimit, informacioni i tregut të punës, stimulimi për të qenë punëkërkuar aktiv, ndërmjetësimi i drejtpërdrejtë); Aktiviteteve socio-kulturore dhe argëtuese; Trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve; Fushatave të advokimit; Aktiviteteve ndërgjegjësuere. Këto shërbime ofrohen 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, nga 10 anëtarë të stafit.

“Streha” ka kontribuar gjithashtu në rishikimin dhe hartimin e kornizave kryesore politike dhe legjislativë në Shqipëri, të tilla si Plani Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të individëve LGBTI+ në Shqipëri (2016-2020).

Rezultati

Që prej ngritjes së saj, “Streha” ka mbështetur mbi 800 përfitues përmes shërbimit rezidencial LGBTI+ të moshës 18-29 vjeç dhe jashtë shërbimit rezidencial të gjithë anëtarët e komunitetit LGBTI+ në nevojë. Shumica e rasteve që kërkojnë ndihmë për të qenë pjesë e shërbimeve, janë viktime të formave të ndryshme të dhunës, kryesisht viktime të dhunës në familje, të dëbuar nga shtëpia, të shfrytëzuar, të diskriminuar, viktime të mundshme të trafikimit, të abuzuar, azilkërkuar e rikthyer LGBTI+, etj.

“Streha” është i vetmi shërbim emergjent afatgjatë rezidencial i bazuar në standardet e kujdesit shoqëror në Shqipëri. Gjatë viteve “Streha” ka ofruar 87 kurse profesionale për komunitetin LGBTI+. “Streha” gjithashtu ka kontribuar në ndërtimin e një sistemi mbrojtjeje për njerëzit LGBTI+ në Shqipëri, duke forcuar kapacitetet e profesionistëve të përfshirë në sistemin e mbrojtjes përmes trajnimit. Në dy vitet e fundit, më shumë se 200 psikologë profesionistë, punonjës socialë, oficerë policie, mësues, etj. janë trajnuar dhe mentoruar nga stafi i “Strehës”.

ZHVILLIMI I VULLNETARIZMIT NË SHQIPËRI

Vullnetarizmi ekziston në të gjitha shoqëritë dhe është një mekanizëm i rëndësishëm i cili nxit kohezionin social dhe ndikon pozitivisht në komunitete duke forcuar lidhjet dhe solidaritetin

midis anëtarëve të saj. Përmes vullnetarizmit, qytetarët marrin rol aktiv në zhvillimin dhe përmirësimin e mjedisit ku jetojnë, duke e bërë këtë mjedis më të qëndrueshëm, të bashkuar dhe të përgjegjshëm. Vullnetarizmi si pjesë e strukturës së shoqërisë shqiptare, është njëkohësisht një aktivitet, filozofia e të cilit është ende në zhvillim.

Organizatat e shoqërisë civile kanë kontribuar gjerësisht për të promovuar rëndësinë dhe vlerat e vullnetarizmit në shoqëri, sidomos tek brezi i ri. Gjatë dekadave të fundit, janë vënë re ndryshime pozitive në perceptimin e shoqërisë shqiptare përsa i perket vullnetarizmit. Gjithashtu, infrastruktura e vullnetarizmit në Shqipëri është përmirësuar dhe zgjeruar ndjeshëm përmes kontributit dhe punës së vazhdueshme të organizatave të shoqërisë civile. Organizata Përtej Barrierave (PB) ka luajtur një rol kyç në këtë proces, duke përfshirë këtu punën në përmirësimin e infrastrukturës së vullnetarizmit, kontributin për zhvillimin dhe njohjen e punës vullnetare, rritjen dhe njohjen e vullnetarizmit, prezantimin e skemave të reja vullnetare në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe Evropian, sjelljen e koncepteve novatore mbi vullnetarizmin për diversifikimin e mundësive vullnetare dhe ndryshimet lidhur me zhvillimin e teknologjisë.

Krijimi i “Shërbimit Vullnetar Lokal (SHVL)” (2010-2016) nga Përtej Barrierave mbështeti zhvillimin e infrastrukturës së vullnetarizmit në nivel lokal dhe kombëtar duke ofruar ekspertizë mbi konceptin e vullnetarizmit dhe politikave përkatëse, rritje të kapaciteteve të ofruesve të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, ngritjen e programeve vullnetare me standarde dhe cilësi, rrjetëzim me organizata të shoqërisë civile dhe institucione, dhe fushata ndërgjegjësuese për vullnetarizmin me fokus të veçantë tek rinia. Gjatë funksionimit të SHVL (2011-2016), janë organizuar me qindra sesione informimi në shkollat e mesme dhe universitete të Tiranës dhe vendit ku janë përfshirë pothuajse 30.000 të rinj. 40 organizata të shoqërisë civile dhe institucione kanë marrë pjesë në programin e ngritjes së kapaciteteve për të përdorur modelin e vullnetarizmit të qëndrueshëm, organizimin e tryezave të rrumbullakta me politikë-bërësit dhe grupet e interesuara, mbi 3000 të rinj të angazhuar në aktivitete vullnetare lokale me impakt të gjerë tek grupet e marginalizuara si të rinjtë romë, të rinjtë me aftësi të kufizuara, grupe me disavantazhe sociale dhe ekonomike etj. Si rezultat i këtij suksesi, në 2011 PB u vlerësua me çmimin e mirënjohjes “Programi më i Mirë Vullnetar i Vitit”, dhe një vit më vonë si “Organizata me Standarde të Larta në Punën Vullnetare”, çmime të dhëna nga MTKRS, Këshilli Rinor Kombëtar dhe UN Shqipëri.

Në 2011, Përtej Barrierave përzgjidhet nga Qendra Burimore SALTO SEE si Pikë Kontakti për të promovuar Programin më të madh të Bashkimit Evropian për rininë “Rinia në Veprim” më vonë

i quajtur Erasmus+. Ky program është një instrument kyç i cili synon të nxisë qytetarinë aktive Evropiane, vullnetarizmin, solidaritetin dhe tolerancën midis të rinjve Evropianë dhe t'i përfshijë ata në ndërtimin e së ardhmes së përbashkët me Bashkimin Evropian. Tashmë, për më shumë se 13 vjet, Organizata Përtej Barrierave në rolin e Pikës së Kontaktit për Programet Rinore vazhdon me sukses punën e saj duke dhënë informacion të përditësuar mbi këto programe, si dhe duke ngritur kapacitetet e organizatave dhe bashkive për tu bërë pjesë e Erasmus+ dhe European Solidarity Corps.

Nisma advokuese për përmirësimin e kuadrit ligjor

Në prill të vitit 2016 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin 45 "Për Vullnetarizmin", Ligji u miratua pa konsultimin me grupet e interesit dhe krijoi barriera të cilat kanë ndikuar negativisht për vite me radhë në zhvillimin e vullnetarizmit në vend. Për të adresuar këtë terren jo mundësues dhe barrierë tashmë dhe ligjore, në vitin 2019, organizata Përtej Barrierave dhe Partnerët Shqipëri përmes Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, në bashkëpunim me shumë organizata të tjera të interesuara të fushës, dizenuan aktivitete të cilat synonin mbledhjen e opinioneve të aktorëve të interesuar dhe iniciuan një fushatë advokimi për të ndryshuar dhe përmirësuar terrenin ligjor të vullnetarizmit në Shqipëri.

Në përgjigje të nismës advokuese dhe kërkesave të OShC-ve, në fund të vitit 2022, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, krijuan një grup pune të përbashkët me përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve vendim-marrëse dhe atyre përgjegjëse për zbatimin e ligjit, për diskutimin e problematikave të ligjit, si dhe konsultimin e mëtejshëm për hartimin e rekomandimeve konkrete për ndryshimin e ligjit.

Rezultati

Angazhimi i Organizatës Përtej Barrierave dhe OSHC-ve të tjera ka rritur ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi vlerat e vullnetarizmit. Ndërgjegjësimi i të rinjve kryesisht mbi vlerat dhe praktikat e vullnetarizmit ka treguar rritje të ndjeshme, parë kjo dhe nga interesi i vazhdueshëm i tyre për të qenë aktiv dhe marrë pjesë në programet vullnetare kombëtar e ndërkombëtarë. Mbi 500 të rinj shqiptarë kanë marrë pjesë në programe të ndryshme vullnetarizmi në Evropë dhe rreth 400 të rinj nga Evropa kanë kryer vullnetarizëm në Shqipëri. Mbi 40 organizata të shoqërisë civile janë angazhuar ndër vite dhe kanë përdorur programin e vullnetarizmit European Solidarity Corps (EVS). Për më tepër është mundësuar ngritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile mbi vullnetarizmin, ciklin e menaxhimit të vullnetarëve dhe përdorimin e platformës digjitale, si dhe janë ofruar modeleve të qëndrueshme të vullnetarizmit të strukturuar për organizatat e shoqërisë civile. Hartimi i një Protokolli të Standardeve të Menaxhimit Vullnetar për ofruesit e vullnetarizmit, ka kontribuar në rritjen e standardeve të punës vullnetare në vend.

Një rezultat tjetër i rëndësishëm në këtë fushë është edhe ngritja e dialogut midis organizatave të shoqërisë civile, aktorëve të interesuar për vullnetarizmin dhe vendimmarrësve, ku si rezultat ka ardhur dhe ngritja e një grupi të përbashkët pune për rishikimin dhe përmirësimin e ligjit të vullnetarizmit në vend.



III.

*KONTRIBUTI I
SHOQËRISË CIVILE PËR
BARAZINË GJINORE*

TË DREJTAT RIPODHUESE TË VAJZAVE DHE GRAVE DHE LIGJI “PËR NDËRPRERJEN E SHTATËZANISË”

Ndryshimi i sistemeve në Shqipëri në vitin 1990 i gjeti gratë e vajzat shqiptare në pamundësi për të vendosur për të drejtat e tyre riprodhuese. Shumë gra e vajza rrezikonin jetën duke përdorur forma ilegale të abortit. Shoqëria shqiptare ishte e pandërgjegjësuar për pasojat e aborteve të paligjshme në shëndetin riprodhues dhe në jetën e grave e vajzave shqiptare. Ndryshimi i sistemeve krijoi mundësi për themelimin e organizatave të para në mbrojtje të të drejtave të grave. Këto organizata ishin aktive edhe në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare në atë kohë, të cilat nxitën dhe mbështetën me forcë nevojën që aborti ligjor të ishte i sigurt dhe i arritshëm.

Nisma për Ligjin “Për ndërprerjen e shtatzanisë”

Nisma për hartimin e Ligjit “Për ndërprerjen e shtatzanisë” u ndërmorr nga Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe organizata të tjera të grave që e mbështetën si Qendra e Gruas, Refleksione, Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare, Qendra Në Dobi të Gruas Shqiptare etj. Si pjesë e përpjekjes së tyre advokuese, për të realizuar ndryshimet ligjore, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave siguruan mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, organizuan fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për grupet e interesit dhe mbarë opinion publik, si dhe ndërmorrën një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve, partive politike në vend, deputetë, ekspertë, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, individë me influencë në opinionin publik si gazetarë, ekspertë nga fusha të shëndetit, shkencave shoqërore etj., për të diskutuar dhe lobuar për nismën.

Organizatat pjesë e nismës, ndërkohë u përfshinë edhe në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare si Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ICPD), e mbajtur në Kajro në vitin 1994, ku u mbështet me forcë nevoja që aborti ligjor të jetë i sigurt dhe i arritshëm. Shtete të ndryshme e njohën abortin e pasigurt si një shqetësim kryesor për shëndetin publik dhe u zotuan për angazhimin e tyre për të reduktuar nevojën për abort duke shtuar shërbime të zgjeruara dhe të përmirësuara të planifikimit familjar dhe në të njëjtën kohë duke pranuar se, në rrethana që nuk janë kundër ligjit, aborti duhet të jetë i sigurt.¹

¹ Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Programi i Veprimit (1994), para. 8.25.

Çështja e abortit u diskutua gjithashtu në atë kohë, nga shtetet në Platformën për Veprim të Pekinit gjatë Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, që u mbajt në Pekin në vitin 1995.² Në këtë kuadër ndërkombëtar dhe me punën dhe advokimin e organizave në mbrojtje të të drejtave të grave e vajzave, aborti në Shqipëri u legalizua plotësisht më 7 dhjetor 1995.

Rezultati

Rezultati i nismës së ndërmarrë nga organizatat e shoqërisë civile ishte miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë në 07.12.1995 i ligjit “Për ndërprerjen e shtatzanisë”. Ky ligj garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës. Parimet mbi të cilat bazohet ligji janë: shërbimi shëndetësor, e drejta e informimit, këshillimi dhe shërbimi i planifikimit familjar, si dhe sanksionet në rastet e abuzimit.

KONTRIBUTI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR KODIN E FAMILJES

Organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol thelbësor në hartimin, ndryshimin dhe zbatimin e Kodit të Familjes. Organizatat kanë bërë presion për ndryshime dhe përmirësime në Kodin e Familjes, duke u fokusuar në të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi. Kjo ka ndihmuar në përmirësimin e dispozitave të ligjit dhe në krijimin e një kodi më të drejtë dhe të balancuar. Organizatat kanë ndërmarrë fushata edukimi dhe ndërgjegjësimi për të informuar publikun mbi të drejtat e tyre sipas Kodit të Familjes dhe mbi ndryshimet e reja që mund të kenë ndikim në jetën e tyre.

Nismat e OShC-ve për Kodin e Familjes

Gjatë periudhës 2002 dhe 2003, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (ish Studio Avokatore e Grave), grupi Ligjor i Grave si dhe Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (Ish Qendra e Gruas)

² Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, Platforma për Veprim (1995), para. 106 (k). Shih gjithashtu Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, A/RES/S-21/2 (1999) mbi veprimet kyçe për zbatimin e mëtejshëm të Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, para. 63 (iii).

vërejtën që Kodi i Familjes në fuqi nuk përputhej me ndryshimet e ndodhura në shoqërinë shqiptare pas vendosjes së demokracisë dhe ndryshimeve social ekonomike dhe të pronës private. Problematikat që dilnin sidomos kur shitej prona dhe vajzat e gratë mbeteshin pa asnjë përfitim nxitën një angazhim të fuqishëm nga ana e Lëvizjes së Gruas për të mbledhur idetë e komunitetit të grave e vajzave në lidhje me sfidat e tyre si dhe për të organizuar ekspertët ligjorë e socialë të kohës për të përcaktuar se çfarë duhej përfshirë në Kodin e ri të Familjes.

Një proces i gjatë advokacie dhe lobimi filloi për hartimin e Kodit të Ri të Familjes nga tre organizatat e sipërpërmendura. Si rezultat, në datën 8.05.2003, me ligjin Nr. 9062 u miratua Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë.

Kodi i Familjes, i punuar me shumë kujdes nga gratë juriste përfaqësuese të lëvizjes feministe shqiptare solli një sërë ndryshimesh të qenësishme si:

- Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve rregullohen sipas një regjimi të parashikuar në kodin e familjes si dhe kontraktor në rastet kur këto marrëdhënie zgjidhen me marrëveshje midis bashkëshortëve. Në Kodin e Familjes u përcaktua që marrëdhëniet pasurore që krijohen gjatë martesës të rregullohen mbi bazën e parimit të barazisë së të drejtave të bashkëshortëve, duke u përcaktuar një regjim pasuror i njëllojtë për të dy bashkëshortët.
- Fitimi i të drejtave të pronësisë por edhe fitimi i posedimit qoftë ky edhe me keqbesim, mbi një send i cili do të shfaqet si një bashkësi faktike, do të përfshihen dhe do të bëjnë pjesë në kategorinë e sendeve që bëjnë pjesë në bashkësi.
- Të drejtat e kreditit që kanë lindur përpara martesës por që përmbushen gjatë martesës, nuk janë pjesë përbërëse e bashkësisë. Ndërkohë që ato të drejta krediti që kanë lindur gjatë martesës por ekzekutimi i të cilave bëhet pas mbarimit martesës bëjnë pjesë në bashkësi.
- Pasuritë e fituara si ndërtime të cilat në kohën e martesës nuk ishin të rregullta ligjërisht, por të legalizuara, pas mbarimit të saj, duhet që të konsiderohen si pjesë e bashkësisë të paktën përsa i përket vlerës së materialeve pasi për ndërtimin e këtyre objekteve janë shpenzuar pasuri nga bashkësia gjatë kohës së martesës (nëse nuk provohet si send i fituar nga pasuri vetjake).
- Kontrata martesore (ose bashkësia me Kontratë), njohja e të cilës rregullonte mbrojtjen e të drejtave pasurore të secilit bashkëshort pasi pasioni mes tyre të kishte mbaruar dhe lidhja e

tyre martesore të kishte përfunduar në gjykatë. Kontrata martesore, që për herë të parë zë vend në Kodin e Familjes, është një akt juridik me anë të të cilit bashkëshortët e ardhshëm përcaktojnë regjimin e tyre martesor, në parim për të gjithë kohëzgjatjen e martesës. Njëkohësisht, në Kontratën Martesore bashkëshortët mund të rregullojnë marrëdhëniet e tyre të pasurisë sipas dispozitave rregulluese të Kodit të Familjes.

Rezultati

Kodi i ri i Familjes përfaqësoi një zhvillim shumë pozitiv për shoqërinë shqiptare, duke qenë se u pasuria me nene që mbrojnë të drejtat e grave në familje, duke i konsideruar ato si qenie njerëzore të barabarta me burrat. Kodi i Familjes përfshiu dispozita të vlefshme me karakter social. Ai parashikoi masa mbrojtëse për sigurimin material të familjes për rastet kur bashkëshorti largohet pa shkak nga vendbanimi dhe refuzon të kthehet. Gjithashtu ndaloj disponimin e banesës bashkëshortore dhe pajisjeve të saj nga njëri bashkëshort pa pëlqimin e tjetrit. Kodi sanksionoi të drejtën e marrjes së një kontributi kompensues nga bashkëshorti që pëson ndryshim dhe pabarazi në jetesë, për shkak të ndarjes së pasurisë pas zgjidhjes së martesës. Shumë të rëndësishme ishin masat kundër dhunës në familje duke qenë se në atë kohë ende nuk ishte hartuar Ligji "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", që i lejon bashkëshortit/es së dhunuar të kërkojë në rrugë gjyqësore largimin urgjent të dhunuesit nga banesa.

PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR PËR DHUNËN NË MARRËDHËNIE FAMILJARE

Organizatat e shoqërisë civile janë një forcë udhëheqëse në promovimin e barazisë gjinore dhe në luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Ato luajnë një rol kyç në ndërgjegjësimin e shoqërisë, ndikimin në politikat dhe në ofrimin e shërbimeve për viktimat. Organizatat ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi çështjet e barazisë gjinore dhe rreziqet e dhunës në marrëdhëniet familjare përmes fushatave ndërgjegjëse, seminareve, trajnimeve, publikimeve dhe aktiviteteve të tjera. Organizatat e shoqërisë civile ndikojnë në formimin e politikave publike, duke bërë presion për hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e ligjeve që mbrojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve dhe penalizojnë dhunën në marrëdhëniet familjare.

Shumë shtete kanë miratuar legjislacion mbi dhunën në marrëdhëniet familjare me ndikimin dhe lobimin e organizatave të shoqërisë civile. Organizatat e shoqërisë civile ofrojnë gjithashtu shërbime të drejtpërdrejta për viktimat e dhunës, përfshirë strehimin, këshillimin, ndihmën ligjore dhe mbështetjen psikologjike. Këto shërbime janë jetike për të ndihmuar viktimat të rimarrin kontrollin mbi jetët e tyre dhe të ndërtojnë një të ardhme pa dhunë.

Nisma për Ligjin “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”

Në vitin 2006, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve (CAO), në partneritet me 9 organizata të tjera të shoqërisë civile: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza të Dhunuara, Shoqata Në Dobi të Gruas Shqiptare, Shoqata Refleksione, Klinika Ligjore e të Miturve, Strehëza për Gra dhe Vajza të Dhunuara, përgatitën dhe prezantuan në Kuvend projektligjin “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”. Këto organizata përfaqësuan 20 mijë zgjedhës, të cilët ushtruan nismën ligjvënëse. Ligji synonte parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes të cilët janë viktimat e dhunës në familje. Me nismën e organizatave në mbrojtje të të drejtave të grave apo iniciative të grave përfaqësuese në Parlament, ky ligj ka pësuar një sërë ndryshimesh që nga fillimi i zbatimit të tij.

Ndër përditësimet më të rëndësishme janë vendimi për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare; udhëzuesi për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje; udhëzimi për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme; udhëzimi për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre. I gjithë kuadri ligjor i ndërtuar pas miratimit të ligjit si dhe ndërtimi i mekanizmave në zbatim të tij siguroi një bashkëpunim ndërinstitutional të koordinuar. Një element qendror i këtij mekanizmi është siguri i ndihmës social - ekonomike për viktimat, shumë prej të cilave e gjejnë veten pa asnjë mjet financiar pas raportimit të dhunës dhe largimit nga partneri i dhunshëm.

Rezultati

Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare ishte thelbësor për një përgjigje efektive dhe të koordinuar ndaj dhunës ndaj grave e vajzave në Shqipëri. Miratimi dhe zbatimi i ligjeve kombëtare për të adresuar dhe ndëshkuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, është një nga rezultatet kryesore të punës së organizatave të grave në Shqipëri. Në kuadër të qindra projekteve të realizuara me mbështetjen e donatorëve në vend dhe jashtë tij, janë trajnuar dhjetra qindra punonjës publik, praktikantë kundër dhunës me bazë gjinore, si punonjës të bashkive, të policisë, gjyqtarë, mësues, punonjës të qendrave shëndetësore etj. Si rrjedhojë e punës së madhe ndërgjegjësuere të organizatave por edhe të ofrimit të shërbimeve, vitet e fundit është rritur ndjeshëm numri i grave që raportojnë dhunën në familje.

RITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE

Shoqëria civile ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe procesin e vendimmarrjes në Shqipëri. Organizatat e shoqërisë civile kanë organizuar fushata për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në procesin e vendimmarrjes si dhe kanë bërë presion të vazhdueshëm për hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit që garanton pjesëmarrjen e barabartë të grave në politikë, përfshirë kërkesën për kuota për gratë në listat e partive politike. Shoqëria civile gjithashtu ka ndihmuar në krijimin e rrjeteve të grave në politikë, të cilat ofrojnë një platformë për të ndarë përvojat, sfidat dhe mësimet, dhe për të punuar së bashku për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikëbërje. Organizatat kanë monitoruar zgjedhjet dhe proceset e tjera të vendimmarrjes për të vlerësuar pjesëmarrjen e grave dhe kanë dhënë mbështetje të drejtpërdrejtë për kandidatet gra dhe vajza në fushatat zgjedhore, pa dallime politike.

Nismat për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë

Nën ndikimin e madh të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësive të organizatave ndërkombëtare si Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP), UN Women, Institutit Demokratik Amerikan (NDI), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, në vitin 2008 u miratua Ligji për Barazinë Gjinore në Shqipëri, i cili përfshiu nenin 15 për pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes. Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri prezantoi kuotën për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivelin 30% dhe më shumë. Në muajin nëntor të vitit 2008, sistemi zgjedhor i Shqipërisë u reformua duke futur sistemin e përfaqësimit proporcional të listave. Kodi Zgjedhor i ndryshuar në vitin 2009 përcaktoi kuotat gjinore për listat e kandidatëve dhe anëtarësimin në Komisionet e Zonave Administrative Zgjedhore (KZAZ) për herë të parë.

Organizatat e shoqërisë civile, si Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, dhe Rrjeti i Grave në Vendimmarrje, luajtën një rol të rëndësishëm në lobimin dhe ndikimin për miratimin e ligjit të Barazisë Gjinore dhe ndryshimin e sistemit zgjedhor. Përveç kësaj, këto organizata ndihmuan në zbatimin e ligjit dhe në promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje. Si rezultat, pjesëmarrja e grave në vendimmarrje u rrit konsiderueshëm, duke kontribuar në promovimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e shoqërisë në Shqipëri.

Rezultati

Zbatimi i ligjit për barazinë gjinore ka çuar në përmirësimin e bilancit gjinor në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht në Parlament. Përqindja e grave në Parlament është rritur konsiderueshëm pas miratimit të ligjit për barazinë gjinore dhe përfshirjes së kuotave gjinore. Kuota gjinore ka shërbyer si një mekanizëm që jo vetëm rrit përgjegjësinë e partive politike për të përfshirë më shumë gra në vendimmarrje, por gjithashtu siguron hapësirën për zbatimin e kornizës ligjore për barazinë gjinore. Shoqëria civile ka ndihmuar në krijimin e një kulture të re politike në Shqipëri, ku pjesëmarrja e grave është vlerësuar dhe inkurajuar. Përpjekjet e vazhdueshme janë të domosdoshme për të garantuar zbatimin e legjislacionit dhe ndërgjegjësimin mbi rolin e rëndësishëm të grave dhe vajzave në çdo fushë të zhvillimit politik-social-ekonomik të vendit.

OFRIMI I SHËRBIMEVE NË NDIHMË TË GRAVE E VAJZAVE TË MBIJETUARA NGA DHUNA

Shoqatat e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave në Shqipëri, të cilat u themeluan në fillim të viteve 1990 fillimisht u fokusuan në adresimin e dhunës ndaj grave, temë tabu kjo gjatë sistemit diktatorial në Shqipëri. Në këtë drejtim, shoqatat u angazhuan në edukimin e grave dhe të publikut në lidhje me të drejtat e grave, duke filluar me dhunën ndaj grave si një formë ekstreme dhe me shtrirje të gjerë e shkeljes së të drejtave të tyre. Paralelisht me këtë, shoqatat filluan punën për krijimin e shërbimeve për gratë dhe vajzat e mbijetuara të dhunës seksuale, dhunës në familje dhe trafikimit për qëllim shfrytëzimi, si dhe për parandalimin e dhunës mbi baza gjinore. Kjo përfshinte krijimin e një baze ligjore për adresimin e kësaj dhune, si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme si këshillimi, mbështetja juridike dhe psikologjike.

Ky angazhim i shoqatave të mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave në Shqipëri ishte shumë i rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes së shoqërisë dhe në promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave si pjesë integrale e shoqërisë. Gjithashtu, ky përkushtim dhe angazhim ka kontribuar në ndryshimin e kulturës së dhunës ndaj grave dhe në rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë e respektimit të të drejtave të grave dhe vajzave në shoqërinë shqiptare.

Nismat kryesore për luftën ndaj dhunës me bazë gjinore dhe shërbimet për vajzat dhe gratë

Disa nga momentet kyçe të krijimit të shërbimeve për gra dhe vajza të mbijetuara nga dhuna me bazë gjinore janë paraqitur në vijim.

Në vitin 1996, nisi veprimtarinë Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat ('Linja') në Tiranë, e para qendër këshillimi dhe ndihme për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore në Shqipëri. Që nga fillimi e deri më sot, Linja ofron: këshillim telefonik, këshillim ballë për ballë, ndihmë ligjore falas dhe shërbime të tjera referimi (për siguri e mbrojtje, shërbim shëndetësor, ndihmë sociale dhe punësim) për gra e vajza nga e gjithë Shqipëria. Sot Linja operon me linjën telefonike kombëtare 116 117 për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, dhe ofron shërbime këshillimi 24 orë në 7 ditë të javës (24/7).

Në vitin 1997, u krijua Qendra e Ndhmës Ligjore për Gra dhe Vajza (sot Qendra për Nisma Ligjore Qytetare), një nismë e Qendrës së Gruas (sot Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim). Kjo qendër ofronte ndihmë ligjore falas për gra dhe vajza viktime të dhunës me baza gjimore, shërbim që është ende pjesë e misionit dhe veprimtarisë së Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.

Në vitin 1998, nisi veprimtarinë Strehëza për Gra dhe Vajza të Abuzuara ('Strehëza') në Tiranë, një nismë e shoqatës së grave "Refleksione". Strehëza ofronte dhe ofron strehim, shërbime referuese dhe shërbime riintegrimi për gra e vajza të mbijetuara të dhunës, si dhe për fëmijët e tyre.

Në vitin 1999, u krijua Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në Vlorë, e para qendër shërbimesh për gratë dhe vajzat viktime të trafikimit të qenieve njerëzore.

Rezultati

Organizatat e grave kanë luajtur rol udhëheqës në parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, sepse ato: (i) ngritën shërbimet e para të ndihmës për gratë dhe vajzat të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore dhe të trafikimit, siç përshkruhet më lart; (ii) krijuan modelet dhe standardet për këto shërbime, të cilat u përvetësuan më pas nga qendra të tjera të shërbimeve për gratë dhe vajzat të mbijetuara të dhunës mbi bazë gjinore dhe të trafikimit, të ngritura nga organizata të tjera jofitimprurëse dhe nga institucionet publike në Shqipëri; (iii) ndërmorrën nisma advokimi dhe dhanë kontribute të rëndësishme në krijimin e bazës ligjore për adresimin e dhunës me bazë gjinore; dhe (iv) mblodhën të dhëna e kryen studimet e para lidhur me dhunën me bazë gjinore në vend.

Si pasojë e advokimit nga lëvizja e grave, si pjesë e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji “Mbi dhunën në marrëdhëniet në familje”, dhe falë përkrahjes nga partnerët ndërkombëtarë, në vitin 2014 u hap Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, ndërsa në vitin 2018 u hap Qendra “Lilium” për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale, dy institucionet e para publike të këtij lloji.

Si rrjedhojë e kësaj pune intensive për tri dekada nga organizatat e grave, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe me fonde publike, sot në Shqipëri ofrohen shërbime të plota për gratë dhe vajzat të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë: strehim të sigurtë, mbështetje të menjëhershme mjekësore, grumbullim të dëshmimeve nga mjekësia ligjore në rastet e përdhunimeve dhe sulmeve seksuale, këshillim psikologjik afatshkurtër e afatgjatë, kujdes për traumat, këshillim ligjor, shërbime avokatie dhe kontakti, shërbime trajnimi profesional dhe punësimi.



IV.

*MBROJTJA
E MJEDISIT*

MUSHKËRI TË GJELBRA PËR QYTETET TONA

Burime të ndryshme rajonale dhe evropiane e rendisin Shqipërinë ndër vendet ku nivelet e larta të përqëndrimit të ndotësve në ajër dhe ekspozimit të popullatës shkaktojnë rreth 5350 vdekje të parakohshme si dhe një reduktim me rreth 184 ditë nga jeta e personave të shëndetshëm por të ekspozuar sistematikisht ndaj ndotjes. Këto si pasojë e mungesës së monitorimit nga institucionet, moszbatimi i legjisllacionit në fuqi, situata me trafikun e rënduar, cilësia e lëndës djegëse, mungesa e hapësirave të gjelbëruara, densifikimi dhe koracimi i qytetit etj.

Nisma “Mushkëri të Gjelbra për Qytetet tona”

Nisma “Mushkëri të Gjelbra për Qytetet tona” [Green Lungs] është ideuar dhe materializuar nga Co-PLAN - Instituti për Zhvillimin e Habitatit, si një platformë alternative e cila synon të informojë dhe ndërgjegjësojë me fakte, aktorët në nivel vendor dhe kombëtar, lidhur me rëndësinë e monitorimit të mjedisit urban për të reduktuar ekspozimin e popullatës ndaj një mjedisi të dëmshëm për shëndetin publik.

Në mungesë të referimeve shtetërore lidhur me cilësinë e mjedisit urban, Green Lungs përbën sot platformën më interaktive, transparente dhe me shtrirjen më të gjerë në vend sa i takon pasqyrimin të analizave nga proceset e monitorimit alternativ të cilësisë së ajrit, ndotjes së zhurmës dhe vlerësimit të shërbimeve të ofruara nga ekosistemi urban i gjelbërimit.

Procesi i monitorimit vijon të aplikohet tanimë prej 5 vitesh në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë e Durrës ku rregullisht publikohen: a. Buletini vjetor i ndotjes; b. Artikuj kërkimorë lidhur me ekspozimin e popullatës ndaj ndotjes; c. Fushata të dedikuara monitorimi ndaj sektorëve (ndërtim, transport, banim etj.). Praktikisht në këtë platformë janë të përfshirë: 8 Organizata Mjedisore; 2 Universitete; 14 pajisje monitoruese të akredituara; mbi 110 vullnetarë në procese monitoruese dhe më shumë se 10 kërkues në fushën e mjedisit urban.

Rezultati

Deri në dhjetor 2022, Green Lungs realizoi në të gjithë bashkitë ku operon: *Census të plotë mbi elementët e gjelbërimit urban (15100 pemë); *Informacion mbi mesataren sezonale të përqendrimit të ndotësve PM2.5, PM10, NO2, CO, CO2, VOC, SO2 dhe O3 në mbi 366 pika monitorimi; *Informacion në kohë reale mbi indeksin e ndotjes dhe pluhurat nga 10 stacione të dedikuara; *Informacion mbi mesataren sezonale të nivelit të zhurmave në mbi 730 pika monitorimi.

Green Lungs arriti të faktorizojë në agjendat e pushtetit lokal dhe qendror si edhe gjerësisht në median kombëtare, shqetësimet lidhur me situatën e cilësisë së ajrit dhe zhurmave në zonat urbane. Nisma prezantoi një koncept të ri për llogaritjen e shërbimeve nga ekosistemi i gjelbërimit urban i cili shërben për ta projektuar gjelbërimin jo më në funksion të estetikës, por të nevojave që ka një qytet për të trajtuar ndotjen dhe fenomenet klimatike.

KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri ka qenë një problematikë e shprehur e pas viteve 1990. Mungesa e vendeve të përshtatshme për depozitimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe rrymave të ndryshme, infrastruktura e dobët për grumbullimin dhe transportimin e tyre nga pikat e grumbullimit në qytete deri në vend-depozitimin përfundimtar ka shkaktuar probleme mjedisore lidhur me ndotjen e tokës dhe të lumenjve deri në det. Mungesa e infrastrukturës për ndarjen e mbetjeve në burim dhe për të rikuperuar rryma të ndryshme të mbetjeve të ngurta që mund të përdoren si lëndë e parë në industrinë ricikluese, ka rritur sasinë e mbetjeve duke krijuar shqetësime në vend-depozitimet si zjarrvënie dhe ndotje të ajrit, hedhje përgjatë brigjeve të lumenjve, etj. Në periudhën 2010-2011, vendi nuk kishte asnjë vend-depozitim sanitar dhe shumica e vend-depozitimeve nuk përmbushnin kushtet higjieno-sanitare për menaxhimin e mbetjeve urbane. Ndërkohë, periudha pas vitit 2010 u shoqërua me një numër nismash të biznesit për riciklimin. Qeveria miratoi lejet për kompanitë ricikluese kryesisht të plastikës, letrës dhe metaleve, por pa përcaktuar detyrimin e tyre për të mbledhur një pjesë të lëndës së parë për riciklim prej mbetjeve të ngurta të gjeneruara në vend.

Ligji për importin e mbetjeve dhe reagimi i shoqërisë civile

Në këto kushte qeveria shqiptare hartoi ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve (2011), në të cilin parashikohej lejimi i importit të mbetjeve. Ndonëse argumentimi i qeverisë ishte lejimi i importit të lëndëve të para për industrinë ricikluese në vend, shoqatat mjedisore së bashku me aktivistë të tjerë të shoqërisë civile vlerësuan se një masë e tillë do të lejonte edhe futjen e mbetjeve të pakontrolluara dhe të rrezikshme, nga vendet fqinje, të cilat do të shpërndareshin ilegalisht në territor.

Nismës së Shoqatës së Bujqësisë Organike iu bashkuan edhe shumë shoqata dhe aktivistë të tjerë. Ndër zërat më të shprehur ishin Lavdosh Feruni, Kozara Kati, Adrian Klosi etj. "Aleanca kundër Importit të Plehrave" (AKIP) ndërmorri një sërë veprimesh për të shprehur qëndrimin kundër kësaj nisme ligjore si komunikimet në media, protestat dhe demonstrimet në Tiranë. Nisma kulmoi me grumbullimin e 60 mijë firmave në të gjithë Shqipërinë dhe thirrjen e një referendumi për rrëzimin e një pjese të ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Dokumentacioni iu dorëzua për verifikim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky rast do të krijonte precedentin e parë në vend lidhur me ushtrimin e të drejtës kushtetuese për të thirrur një referendum prej popullit.

Nën moton "Për Shqipërinë e pastër" një numër organizatash kanë ndërmarrë nisma për zvogëlimin e ndotjes nga mbetjet, ku ndër më të spikaturat ka qenë ajo kundër përdorimit të qeseve plastike. Shumë organizata janë bashkuar për të nxitur sjellje të përgjegjshme që zvogëlojnë sasinë e mbetjeve dhe nxisin riciklimin përmes fushatave të pastrimit dhe ndërgjegjësimin në shkolla dhe komunitete në mbarë vendin.

Rezultati

Aleanca Kundër Importit të Plehrave u bë një kauzë me mbështetje mjaft të gjerë publike. E filluar si nismë e shoqatave mjedisore, ajo përfshiu në vorbullën e saj një numër të madh aktivistësh dhe figurash publike të cilët e përkrahën dhe u bënë zëri i saj. Menaxhimi i mbetjeve mbetet ende sfidë e pushtetit vendor dhe atij qendror. Gjatë viteve të fundit ka pasur një sërë nismash ligjore dhe projekte pilot për zvogëlimin e përdorimit të plastikës dhe ndalimin e qeseve plastike njëpërdorimëshe. Ndonëse zbatueshmëria mbetet ende në nivele të pakënaqshme, falë kontributit të shoqërisë civile mjedisore, mbështetja e publikut të gjerë ndaj këtyre nismave dhe riciklimit ka ardhur në rritje.

NXITJA E Pjesëmarrjes së Publikut në Vendimmarrjen mjedisore

Ushtrimi i të drejtës për të marrë informacion rreth gjendjes së mjedisit apo ndërhyrjeve në të, si edhe i pjesëmarrjes në vendimmarrjen për mjedisin ka qenë një proces që ka evoluar së bashku me zhvillimin e demokracisë në Shqipëri. Ndonëse e drejta për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm është e sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në fillesat e demokracisë kjo e drejtë shihej si një atribut që duhet të sigurohej nga shteti dhe njerëzit e përfitonin pa qenë e nevojshme pjesëmarrja e tyre. Nënshkrimi i Konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin (1998)” legjitimoi këto të drejta duke i dhënë mundësi për të vepruar jo vetëm personave të prekur, por edhe organizatave të shoqërisë civile si publik i interesuar në çështjet mjedisore.

Praktikat e mira të shoqërisë civile për pjesëmarrje në vendimmarrjen mjedisore

Në periudhën 2000-2005, Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Shqipëri) ndërmorri një program të gjerë kualifikues për njohjen e të drejtave që i takonin individëve dhe OJF-ve në kuadër të kësaj konvente. Kualifikimi përfshiu përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, së bashku me OJF-të, mbi kërkimin dhe dhënien e informacionit mjedisor dhe organizimin e pjesëmarrjes së publikut në procese të vendimmarrjes për mjedisin.

Në vitin 2003, Grupimi për mbrojtjen e Gjirit të Vlorës, i përbërë nga aktivistë dhe anëtarë të shoqatave lokale mjedisore pas një sërë protestash kundër ndërtimit të një termocentrali në zonën e Gjirit të Vlorës, iu drejtuan Komitetit të Zbatueshmërisë së Konventës së Aarhusit në Gjenevë, duke paditur qeverinë shqiptare për moszbatimin e detyrimit të saj për të organizuar pjesëmarrjen e duhur publike me individët dhe organizatat e interesuara për këtë çështje. Pas shqyrtimit të çështjes, Komiteti e vlerësoi të drejtë padinë dhe i kërkoi qeverisë shqiptare marrjen e masave për organizimin e duhur të proceseve të pjesëmarrjes publike. Ndonëse ai u ndërtua, ende nuk është vënë në funksionim, që konfirmon qendrimin e atëhershëm të shoqërisë civile lidhur me problematika në planifikimin dhe vlerësimin ekonomik dhe mjedisor të këtij investimi.

Në periudhën 2005-2015, pati një hov cilësor të ndërveprimit të OJF-ve me institucionet shtetërore në mënyrën se si u adresuan kërkesat për informacion. Këtu vërehen edhe fillimet e pjesëmarrjes publike me impakt në çështje të caktuara me ndikim në mjedis. OJF-të ndesheshin me refuzimin apo zvarritjen në dhënien e informacionit të kërkuar si për shembull lidhur me kërkesat për vënien në dispozicion të Raporteve të Vlerësimit në Mjedis për investime infrastrukturore të rëndësishme. Presioni i shtuar publik dhe plotësimi i kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, mundësuan ndikimin pozitiv në pezullimin e një sërë aktiviteteve me ndikime negative në mjedis.

Planifikimi për ndërtimin e TEC në Porto Romano (2007-2008) dhe ndërtimi i Unazës së Madhe në Tiranë (2011) ishin dy raste ku Qendra EDEN me mbështetjen e organizatave mjedisore dhe atyre komunitare kërkuar procese të plota të pjesëmarrjes së publikut. Koalicione të paformalizuara siç ishte mbështetja e 33 organizatave për kauzën e përfshirjes së komuniteteve vendore në konsultimin publik për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës, mundësuan një vendimmarrje më të drejtë për komunitetet e prekura dhe minimizimin e dëmeve sociale dhe mjedisore.

Pas vitit 2010, filloi konsultimi më i gjerë publik i akteve dhe dokumentave strategjikë mjedisorë, ku përfshirja e OJF-ve ishte më e plotë. Në shumë procese, organizatat mjedisore kanë kritikuar mangësitë në proceset e diskutimit publik. Monitorimi i organizimit të proceseve të konsultimit publik me komunitetet vendore të prekura prej ndërtimit të veprave energjetike forcoi lidhjen e OJF-ve mjedisore me këto komunitete. Në vitin 2017, EcoAlbania raportoi probleme në konsultimin publik për hidrocentralet mbi Lumin Vjosa. Shoqata Toka kundërshtoi ndërtimin e HEC-ve mbi Valbonë duke faktuar se ndërtimi cënonte zonën e mbrojtur, proceset e konsultimit publik ishin fabrikuar dhe nuk ishin përmbushur detyrimet e vëna sipas ligjit.

Vlerësimet mbi ecurinë në zbatimin e kërkesave të Konventës së Aarhusit, kryer prej organizmave ndërkombëtarë, tregojnë se deri në vitin 2015, kishte një progres të mirë lidhur me dy shtyllat e para të kësaj konvente: të drejtën për të marrë informacion dhe pjesëmarrjen publike. Në rastet kur kërkesat ishin refuzuar ose vonuar, OJF-të i janë drejtuar Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Por mungesa e besimit ndaj sistemit gjyqësor dhe vështirësitë e ndryshme për ta ushtruar të drejtën për t'ju drejtuar këtij sistemi kur ishte cënuar e drejta për informim dhe pjesëmarrje, kishin pamundësuar vënien në veprim të shtyllës së tretë të Konventës së Aarhusit.

Në vitin 2015-2017, REC Shqipëri kreu një sërë kualifikimesh për përfaqësuesit e OJF-ve dhe të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë Shkollën e Magjistraturës. Interpretimet ligjore të Gjykatës së Lartë mbi legjitimitetin e organizatave të shoqërisë civile në çështjet gjyqësore për mjedisin hapën rrugën e fillimit të paraqitjes dhe shqyrtimit të rasteve të para të këtyre çështjeve në Gjykatat e Shkallës së Parë.

Në tetor 2017, Gjykata Administrative Tiranë zhvilloi seancat gjyqësore lidhur me padinë që Shoqata Toka dhe 27 banorë të Margegaj në Tropojë ngritën kundër Ministrisë së Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Këshillit Kombëtar të Territorit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Këshillit të Basenit Ujëmbledhës. Ata i kërkuan gjykatës të shpallë pavlefshmërinë absolute të kontratës së koncensionit për ndërtimin e dy hidrocentraleve “Dragobia” të lidhur në vitin 2009 dhe një grup urdhërash, vendimet, shtesash dhe lejesh që janë dhënë deri atëherë. Organizata të shoqërisë civile, aktivistë dhe banorë, kanë zhvilluar një sërë protestash në Bajram Curri dhe Tiranë me thirrjen “Mos ma prek Valbonën”.

Procese të ngjashme gjyqësore vijuan kundër HEC-ve në Vjosë, Zall Gjocaj, etj. Rastet e paraqitura në gjykatat e vendit shërbyen për të fituar përvojën në adresimin e mangësive në proceset pjesëmarrëse të kërkuara me ligj dhe argumentimit të ndikimit negativ të tyre mbi mjedisin. Zëri i banorëve vendas filloi të ndihej më i fortë dhe i përfaqësuar bindshëm prej juristëve të rinj që shihnin me interes të shtuar kauzat mjedisore.

Në 2018, Qendra EDEN hodhi në gjyq Bashkinë Fier për keqmenaxhimin e vend-depozitimit të mbetjeve në Sheq, duke përfaqësuar shqetësimin e komunitetit të banorëve të zonës mbi ndotjen e ajrit dhe pasojat në shëndet. Ndër rastet më të fundit, është padia e ngritur nga Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe Shoqata Ornitologjike Shqiptare (AOS) në vitin 2022 kundër ndërtimit të aeroportit të Vlorës në zonën e mbrojtur të Lagunës së Nartës.

Rezultati

Konventa e Aarhusit mbetet një ndër marrëveshjet ndërkombëtare më të njohura dhe më të përdorura prej OJF-ve mjedisore në vendin tonë. Ngritja e kapaciteteve në sektorin e OJF-ve për të përdorur mekanizmat e saj kanë rritur shkallën e presionit dhe fuqizuar argumentin për të kërkuar dhe marrë informacionin mjedisor dhe për të qenë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, duke mbrojtur interesat e komuniteteve vendore dhe mjedisin natyror.

Përdorimi i mekanizmave të Konventës së Aarhusit prej OJF-ve mjedisore ka maturuar dhe fuqizuar zërin e individëve dhe të grupeve të cënuara në mbrojtje të mjedisit përballë interesave të institucioneve shtetërore dhe biznesit. Pas më shumë se 20 vitesh prej nënshkrimit dhe ratifikimit të kësaj konvente janë standardizuar procedurat e kërimit dhe të marrjes së informacionit mjedisor; është siguruar e drejta e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen me ndikim në mjedis. Ndonëse këto procese janë larg të qënurit në standardin e duhur, ato kanë mundësuar ndikimin pozitiv të OJF-ve për të penguar ose minimizuar dëmin mjedisor.

Vendimet e disa proceseve gjyqësore në krah të komuniteteve dhe OJF-ve si për rastin e HEC-ve në Vjosë, Valbonë dhe Zall Gjoçaj, ndonëse nuk kanë përfunduar përballjen dhe zgjidhjen e konfliktit, kanë krijuar përvojën e duhur për t'u organizuar dhe për të vënë në veprim këtë mekanizëm ende të brishtë të funksionimit të demokracisë.

MBROJTJA E FAUNËS SË EGËR DHE ZONAVE ME RËNDËSI NATYRORE

Peizazhi i larmishëm, pozicioni gjeografik, relievi i pasur, klima e favorshme në çdo stinë të vitit, i kanë dhuruar Shqipërisë kushtet e përshtatshme për një florë dhe faunë shumë të pasur. Në një peizazh të tillë merr jetë një shumëllojshmëri kafshësh dhe bimësh, të cilat janë pasuri me vlera të mëdha dhe të pazëvendësueshme për vendin tonë. Me rreth 3000 bimë, 58 gjitarë dhe rreth 370 lloje shpendësh, vendi ynë është vend qendrimi dhe riprodhimi për shumë lloje me rëndësi ndërkombëtare, shumë prej tyre autoktone. Falë habitateve natyrore dhe ekosistemeve të rëndësishme pyjore, lagunore dhe ligatinore, ai ofron strehë edhe për rreth 80 lloje migratore

shpendësh. Gjatë periudhave të dimrit, numri i shpendëve në lagunat tona arrin deri në 200 mijë individë. Për vlerat natyrore unike të zonave të caktuara dhe shumëllojshmërinë biologjike që mbartin, rreth 20% e territorit shqiptar është shpallur zonë e mbrojtur.

Zhvillimet e pakontrolluara dhe moszbatimi i ligjit në mbrojtjen e këtyre vlerave natyrore gjatë periudhës së tranzicionit kanë çuar në dëmtimin e tyre, deri në zhdukjen apo zvogëlimin e tejskajshëm të llojeve dhe habitateve të caktuara. Deri në vitin 2015, ndërtimet pa leje, gjuetia e pakontrolluar dhe me mjete të paligjshme, shpyllëzimi dhe zjarret në pyje, krahas presioneve të tjera si ndotja dhe zhurmat, zvogëluan ndjeshëm faunën e egër. Në këtë periudhë, qeveria morri masën drastike të ndalimit të plotë të gjuetisë me anë të moratoriumit pesë vjeçar. Ndonëse u përkrah për të frenuar barbarizmin mbi natyrën, shoqëria civile mjedisore e interpretoi si një masë të përkohshme që duhej shoqëruar edhe me masa konkrete për kontrollin dhe menaxhimin e këtyre aktiviteteve.

Praktikat e mira të shoqërisë civile për zonat e mbrojtura dhe faunën e egër

Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) ndërmorri monitorimin e gjitarëve të mëdhenj si ariu i murrmë, rriqebulli, ujku, etj. në zona të ndryshme të mbrojtura duke ndihmuar në vlerësimin e pranisë dhe të gjendjes së popullatave të tyre. Përmes programeve shumë vjeçare të monitorimit duke përdorur mjetet e teknologjisë digjitale si kamerat me rreze infra të kuqe, u evidentuan të dhëna të rëndësishme për mbrojtjen e tyre. Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Llojit për disa prej llojeve më të kërcënuara për zhdukje, mundësoi veprime konkrete në terren, në bashkëpunim me administratën e zonave të mbrojtura.

Shoqata Ornitologjike Shqiptare (AOS), me përvojën shumë vjeçare në kryerjen e censusit të shpendëve në të gjithë vendin, ka qenë burimi i vetëm i të dhënave për inventarin e shpendëve dhe dinamikën e popullatave të tyre. Këto të dhëna janë tepër të dobishme për zonat e rëndësishme për shpendët siç janë lagunat. Falë punës së tyre, vendi ynë ka tre zona të njohura ndërkombëtarisht për shpendët (njohur si IBA – Important Bird Areas) dhe një zonë Ramsar (zonë ligatinore e përcaktuar si e një rëndësie ndërkombëtare sipas Konventës së Ramsarit, e njohur gjithashtu si "Konventa për Ligatinat") që është Laguna e Karavastasë.

Në vitin 2017-2018, me nismën e AOS dhe mbështetjen e 23 organizatave të shoqërisë civile mjedisore u organizua një fushatë kundër planeve të investitorëve privatë, për ndërtimin e "një

qyteti” turistik në zemër të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Nën moton “Mbroni Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastasë”, debati mbi alternativat e qëndrueshme të zhvillimit në këtë zonë, kundërshtoi planet e qeverisë për zhvillime turistike.

Prej vitit 2020 e në vijim, një koalicion i gjerë organizatash dhe ekspertësh mjedisorë ka kundërshtuar studimin për rishikimin e kufijve të zonave të mbrojtura të kryer nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Ky studim shërbeu si vlerësimi teknik për një sërë vendimmarrjesh të qeverisë shqiptare (2021-2022) për të ndryshuar kufijtë e rrjetit të zonave të mbrojtura në vendin tonë. Ndonëse në fund të këtij procesi (janar 2021), qeveria shqiptare reklamoi rritjen e sipërfaqes së mbrojtur nga 18.25% në 20.9% të territorit, ai rezultoi me uljen e sipërfaqes së mbrojtur përgjatë bregdetit Adriatik në masën prej 11%. Sipërfaqet e cënuara, kryesisht zonat lagunore, vlerësohen si zonat më të rëndësishme për faunën e egër të vendit tonë me habitate natyrore të veçanta në të gjithë rajonin e Mesdheut.

Zvogëlimi i zonave të mbrojtura në Velipojë, Patok, Karavasta dhe Nartë u kundërshtua prej OJF-ve mjedisore dhe ekspertëve nga institucionet akademike si një veprim në kundërshtim me ligjin e zonave të mbrojtura (2017) dhe i pabazuar në studime të thelluara me pjesëmarrjen e komunitetit shkencor. Debati në takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protestat dhe komunikimet mediatike, e popullarizuan çështjen jo vetëm në opinionin publik shqiptar, por edhe në organizmat ndërkombëtarë për mbrojtjen e natyrës si Konventa e Bernës. Koalicioni i OJF-ve mjedisore ka depozituar çështjen në gjykatë duke kërkuar revokimin e këtyre vendimeve. Një hap i tillë vlerësohet tepër i rëndësishëm për të shmangur precedentë të ngjashëm në të ardhmen ku presioni për zhvillimin ekonomik dhe turistik në zonën bregdetare do të çenojë në mënyrë të parikthyeshme këto vlera të vendit tonë.

Programe të veçanta për mbrojtjen e llojeve të rralla nga helmimi apo vrasja kanë qenë nisma të OJF-ve mjedisore, me rëndësi për mbrojtjen kryesisht të shpendëve dhe gjitarëve. Organizata të tjera si Katër Putrat (Four Paws) kanë mbështetur nisma të mbrojtjes së kafshëve të egra duke çliruar nga mbajtja në skllavëri gjitarë të mëdhenj si ariu i murrmë. Fushatat mediatike dhe veprimet në terren kanë rritur ndërgjegjësimin për trafikun e paligjshëm të këtyre llojeve. Disa prej organizatave më aktive në këtë fushë kanë shprehur interesin për të marrë pjesë si

anëtarë në Këshillin e Faunës, të ngritur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ndonëse ky forum është në fazat e para të organizimit dhe veprimit, pjesëmarrja e shoqërisë civile në të mundëson ngritjen e zërit për çështje të rëndësishme të mbrojtjes dhe menaxhimit të llojeve të faunës së egër në vendin tonë.

Rezultati

Kontributi i organizatave të shoqërisë civile në këtë fushë ka synuar forcimin e njohjes dhe të kapaciteteve teknike për llojet e kërcënuara dhe me rëndësi ndërkombëtare. Grumbullimi i të dhënave konkrete për praninë e tyre dhe tendencat e popullatave të tyre ndihmojnë drejtpërsëdrejti institucionet përgjegjëse, siç është administrata e zonave të mbrojtura, e cila ka burime dhe kapacitete mjaft të kufizuara. Falë këtij kontributi dhe ndihme me ekspertizë dhe burime njerëzore, është realizuar hartimi i metodikave të monitorimit dhe i Planeve të Menaxhimit të Llojit për disa lloje me rëndësi ndërkombëtare.

Veprimet konkrete në mbrojtje të llojeve nga vrasja apo dëmtimi, shqetësimi prej aktivitetit njerëzor, dhe çlirimi nga mbajtja në skllavëri ka ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik për vlerat e faunës së egër dhe mbrojtjen e saj. Ndërmarrja e kauzave të tilla si moszvogëlimi i sipërfaqes së Rrjetit të Zonave të Mbrojtura, ka fuqizuar kapacitetet e OJF-ve mjedisore për të advokuar për çështje specifike që kërkojnë ekspertizë teknike të plotë për tu përballur me presionin në rritje prej zhvillimit të turizmit në zonat bregdetare të vendit tonë.

MBROJTJA E LUGINËS SË LUMIT VJOSA - VJOSA PARK KOMBËTAR

Lumi Vjosa është një ndër lumenjtë e fundit në gjendje natyrore në Evropë. Lumi është i karakterizuar nga kanione të bukur, në rrjedhën e sipërme dhe ka një shtrat të gjerë e madhështor në rrjedhën e mesme e të poshtme. Së bashku me degët e saj, Vjosa krijon një ekosistem dinamik, një trashëgimi të vërtetë të natyrës evropiane. Periudha pas 2010 u karakterizua nga zhvillime kaotike dhe të orientuara drejt shfrytëzimit të lumenjve në të gjithë vendin dhe më gjerë në Ballkanin Perëndimor, kryesisht për prodhim energjie. Ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël nëpër rrjedhat ujore dëmtoi rëndë këto ekosisteme me vlera natyrore

dhe krijoi problematika sociale lidhur me përdorimn e ujit nga banorët vendas. Përgjatë rrjedhës në Shqipëri, ishin parashikuar të ndërtoheshin rreth 8 diga hidrocentralesh, ndër të cilët dy planifikoheshin në rrjedhën e mesme të këtij lumi. Koncesionet për ngritjen e hidrocentraleve në Kalivaç dhe Bënçë ishin dhënë që rreth viteve 2000 dhe një pjesë e punimeve kishin filluar.

Nisma e organizatave të shoqërisë civile “Vjosa Park Kombëtar”

Një grup i gjerë organizatash të shoqërisë civile, të grupuar në rrjetin për mbrojtjen e lumenjve, ngritën zërin e tyre kundër këtyre zhvillimeve. Krahas shumë lumenjve të tjerë në Shqipëri si Valbona, lumi Vjosa u bë simboli i reagimit qytetar dhe të shoqërisë civile. EcoAlbania si organizata flamurtare në këtë nismë organizoi një sërë veprimtarish në nivele të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin për vlerat e këtij lumit, ndaluar planet për ngritjen e veprave energjetike që do të ndërprisnin rrjetën natyrore të tij dhe shpalljen zonë të mbrojtur.

Gjatë periudhës 2014-2021, në mbështetje të organizatave shqiptare u vendos edhe një koalicion i gjerë ndërkombëtar mbështetur nga Riverwatch dhe Euronature, të cilët rritën presionin ndërkombëtar mbi qeverinë shqiptare për mbrojtjen e këtij lumi. Çështja e Lumit Vjosa u ndërkombëtarizua përmes pronocimeve të figurave të njohura publike të artit dhe polikës ndërkombëtare. Deklarata dhe prononcime mediatike të institucioneve ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Evropës dhe institucione të Bashkimit Evropian fuqizuan kauzën për mbrojtjen e këtij lumi. Vjosa përmes fushatës “Të ruajmë zemrën e kaltër të Evropës” u bë simbol për të gjithë lëvizjen për mbrojtjen e lumenjve në Ballkan.

Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet akademike brenda vendit dhe në Evropë mundësoi një numër ekspeditash të kërkuesve shkencorë shqiptarë dhe të huaj që evidentuan pasurinë llojore të këtij lumi, përcaktuan lloje endemike apo me rëndësi ndërkombëtare (2016-2022). Këto veprimtari listuan 1,175 specie kafshësh dhe bimësh regjistruar përgjatë Vjosës, duke përfshirë 119 specie të mbrojtura sipas ligjit shqiptar dhe 39 specie që janë të listuara në Listën e Kuqe Ndërkombëtare të Specieve të Kërcënuara të Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN).

EcoAlbania, duke përfaqësuar edhe zërin e banorëve të komuniteteve vendase, filloi edhe procese gjyqësore kundër investitorëve për parregullësi në konsultimin publik për veprat

energjetike dhe mospërfshirjen e komuniteteve vendore në këto procese vendimmarrëse. Veprimtaritë ndërgjegjësuere që u organizuan për çështjen përfshinë koncerte në Tiranë ("Mos ma prek Vjosën", 2017) dhe Tepelenë ("Vjosa Forever", 2022), konferenca shkencore ndërkombëtare, ekspedita përgjatë rrjedhjes së Vjosës nga burimi në derdhjen në Detin Adriatik për gazetarë, politikë-bërës dhe të rinj e aktivistë të apasionuar për natyrën, ekspozita dhe shfaqje dokumentarësh.

Projekte që promovonin prodhimin e energjive të rinovueshme, në vend të ndërtimit të digave si "Solar në Kutë" gjatë periudhës 2019-2021, ballafaquan alternativa të qëndrueshme zhvillimi për këtë zonë, përkundrajt investimeve që cënonin habitatet dhe ekosistemet natyrore në Vjosë.

Ndërkohë, presioni për zhvillimin ekonomik me skema jo të balancuara me natyrën në zonat përgjatë lumit dhe në zonat kufitare me të, nuk është frenuar. Planet e qeverisë shqiptare për ndërtimin e aeroportit të Vlorës në zonën e Nartës, kanë rritur shqetësimin e organizatave mjedisore për ndikimin që kjo vepër infrastrukturore mund të ketë mbi ekosistemet natyrore dhe faunën në grykëderdhjen e lumit Vjosa. Laguna e Nartës dhe zona përreth saj shihet e lidhur ngushtë me Vjosën. Ajo është Zonë me Rëndësi Ndërkombëtare për Shpendët (Important Bird Area) meqë është vendfolenizimi i shumëve lloje shpendësh dhe ndodhet në rrugën e migrimit të shpendëve nga veriu i Evropës drejt Afrikës dhe anasjelltas. Zona e Nartës dhe grykëderdhja e Vjosës, shihen si dy zona ndërvepruese të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën duke krijuar një biokorridor të rëndësishëm në jug të vendit tonë.

Fillimi i punimeve dhe nënshkrimi i kontratës koncesionare në nëntor 2022 janë kundërshtuar fuqishëm prej këtij komuniteti duke kërkuar respektimin e kërkesave ligjore për ndalimin e punimeve brenda zonës së mbrojtur dhe kryerjen e një Vlerësimi të Thelluar të Ndikimit në Mjedis. Gjatë vitit 2022, PPNEA ka filluar procesin gjyqësor kundër këtij investimi.

Në shtator 2020, Kryeministri i Shqipërisë, njoftoi publikisht synimin për shpalljen e Vjosës një zonë të mbrojtur. Ndonëse kjo u vlerësua një fitore e grupimit të organizatave të shoqërisë civile, arritja u vlerësua vetëm mbrojtje minimale për Vjosën, e cila nuk e përjashtonte dëmtimin e rrjedhës së prej veprave energjetike. EcoAlbania dhe grupimi i shoqatave mjedisore vijoi të kërkojë mbrojtjen e saj si Park Kombëtar duke i ofruar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (institucioni përgjegjëse pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) ndihmë në hartimin e dokumentacionit përkatës.

Në janar 2022, qeveria shqiptare shpalli Lumin Vjosa zonë të mbrojtur të kategorisë Park Natyror.

Për vlerat natyrore dhe ekologjike të këtij lumi, grupimi i organizatave mjedisore që ndërmorri nismën ka vijuar proceset advokuese për rritjen e statusit të mbrojtjes në kategorinë Park Kombëtar. Gjatë vitit 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shprehu qëndrim pozitiv për këtë çështje dhe ngriti grupin teknik të punës për hartimin e dokumentacionit dhe studimeve të nevojshme për një vendimarrje të tillë. Pjesë e grupit teknik ishin edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Rrjetëzimi brenda dhe jashtë vendit mundësoi një zë më të fortë të organizatave mjedisore dhe aktorëve të tjerë për mbrojtjen e natyrës, maturoi dhe zhvilloi cilësisht organizimin e fushatave advokuese për çështjet mjedisore në Shqipëri. Ajo arriti efektivisht të ndikojë vendimarrjen politike dhe të sigurojë mbështetjen e gjerë të komunitetit vendas përgjatë luginës së Vjosës dhe publikut të gjerë. Në një vlerësim të opinionit publik për çështjen mjedisore në kuadër të fushatës “Unë dhe ti për mjedisin (IDRA, 2022), 45% e të anketuarve renditën Vjosën, si fushatën mjedisore për të cilën kishin dijeni se ishte duke ndodhur.

Rezultati

Organizatave mjedisore mundësuan kombinimin e mjeteve dhe instrumentave të ndryshëm të ndërgjegjësimit dhe presionit, përfshirë ato kërkimore shkencore, mediatike dhe të diplomacisë mjedisore dhe politike brenda dhe jashtë vendit.

Falë këtij kontributi, pa dyshim Vjosa renditet si gur i çmuar në gjerdanin e vlerave natyrore të vendit tonë dhe një atraksion turistik unik për rajonin. Më 13 mars 2023, Qeveria e Shqipërisë e shpalli lumin Vjosa - lumin e fundit të egër në Evropë, Park Kombëtar.

